

**NEWS
BOMB**

.al

BUJQËSIA RIKTHIM NË TRADITË

**Në
brand'ëst**

GJERGJ LUCA
KRYEOLIGARKU I SHRIMSIT, REBELI QË
GRISI DIPLOMËN PËR T'U BËRË BIZNESMEN

**NONGRATA-t
E SHBA-së**
DËSHTIM APO SUKSES
NË SHQIPËRI?!

**POLICËT E
LËNË RRUGËVE**
PA BUKË DHE
SIGURIM JETE





Investo me zgjuarsi NË KOMPLEKSIN MË TË LAKMUAR NË TIRANË!



DON BOSKO, **TIRANË**

+355 69 20 73 531

SHITJET@MATRIXKONSTRUKSION.COM

WWW.MATRIXKONSTRUKSION.COM



Shaping life!



ZOTI “NON GRATA” I MPOSHTUR NGA IKJA E KOHËS

Departamenti Amerikan i Shtetit përmes vendimit publik të Sekretarit të Shtetit Antony Blinken, më 19 maj të vitit 2021, shpalli ish kryeministrin e Shqipërisë Sali Berisha dhe pjesëtarët e familjes së tij, “të padëshirueshëm për të hyrë” në SHBA. Ky urdhër tronditi opinionin publik dhe “ndali” frymëmarrjen në Partinë Demokratike të cilën e kishte drejtuar, kontrolluar dhe i kish gjetur pasardhës të vetvetes në krye të saj që nga viti 2013.

Të gjithë kundërshtarët, kritikët, adhuruesit dhe qytetarët e shumtë të lodhur nga tranzicioni postkomunist i vendit në të cilin ai është kryepersonazhi protagonist i përcaktues, paskëtaç e ngrinë imazhin e të pamposhturit “Non grata”.

Kur askush nuk e mendonte, pasardhësi i zotit “Non grata”, kryetari-bir i PD-së Lulëzim Basha, mes dilemës për të qenë me “atin politik” apo me aleatin e madh të kombit, pra SHBA, zgjodhi të dytin. Jashtë selisë së partisë, ish Shtëpi Qendrore e Ushtrisë u zgjua lëvdimi për shkak të befasisë dhe brenda selisë, nisi tërmeti apo tërbimi luaneak i “të pamposhturit” Berisha.

I tërhequr lëvdueshëm, por disi mërguar tinëzisht, në shtëpinë dhe zyrën private, shumë pranë selisë së partisë, pas aktit at-mohues të zotit Basha, ish kryeplaku i PD-së, turfullueshëm braktisi tërheqjen pleqërore dhe shpalli rikthimin e domosdoshëm. Nevojën vetiake e formuloi si domosdoshmëri pluralizmi, si domosdoshmëri rithemelimi, si ringjallje dhe shpëtim opozitarizmi. Dhe në mënyrën e tij tradicionale braktisi sjelljen formale dhe tashmë po kryen një akt kokëfortë partimarrjeje, pamvarësisht se partia është shpërbërë.

I pamposhturi nga kundërshtarët Berisha, nuk mund të heqë nga profili dhe shenja vetiake publike, urdhërin amerikan si Non grata.

Në dhe me politikën e tij, përgjatë tridhjetë viteve, ia ka dalë të mposhtë të vërtetat me versionin e së vërtetës së tij, të imponojë kundërshtarët me radikalitetin dhe idhujt e vet dialektorë si dhe të rikthejë vetveten e të ringrihet politikisht si i pamposhtur për të cilin historia rezervon kapitull shtesë, pas cdo largimi apo dorëheqjeje.

Të gjitha mposhtjet i stivosi me rikthim, falë meritës rebele të politikëbërjes, por më së shumti për meritë të nevojës së demokracisë për rotacion dhe pluralitet. E bëri këtë në një Shqipëri që zvarritet vetë e ndihmohet shumë nga aleatët, vecanërisht nga SHBA.

Rikthimi i beftë, për arsye të fundit ekzistenciale i Sali Berishës në Partinë Demokratike është imitim minor i rikthimit të tij në ringritjen e pas vitit 1998. Tek e para, iu desh një vrasje tronditëse e me kosto të madhe si ajo e Azem Hajdarit, ndërsa tek e dyta, mësymja me imazh tribal mbi selinë e partisë, brenda së cilës gjendej me pak njerëz dhe me disa ushtarë, biri-plangprishës politik i tij Lulëzim Basha.

Në këtë mënyrë shenjoj nisjen rikthyese, por me imazh të përdhosur të partisë dhe vetvetes, si dhe një vepër të padëshirueshme të përbashkët me ata që mbledhi jashtë dhe ata që u blinduan nga brenda.

Zoti Non grata i pamposhtur në mjedisin provincial shqiptar, rihyri në seli, por tashmë i është shkërmoqur partia.

Ringritja e tij është përballë mundësive të pamundshme që nisin nga koha e paktë për moshën e sidomos tek panegociueshmëria me SHBA. Kundërshtarët e zotit Non grata i kanë të shumta mundësitë penguese, sikundër kanë edhe aleanca që nuk i meritojnë përballë tij.

Por Zoti Non grata vijon të këmbëngulë si eposiak, se pasi të rikonstitujë partinë e rithemeluar, me ortakëri të vjetër dhe shërbestari të re opozitare, do të dëbojë socialistët nga pushteti dhe do të “shpëtojë” demokracinë “shqiptare nga soroizmi.”

Me patetizmin dhe energjinë evidente ditore ia del të tejkalojë moshën fizike. Mirëpo përreth tij, (matanë shtresës së pakësuar të fanatikëve apo idhujtarëve politikë të vetes), është masa e madhe e të heshturave të partisë dhe qytetarëve oponentë; janë aleatët e vegjël të cilët presin të mbyllet drama e partisë së madhe të opozitës dhe është fluksi në shtim i ikanakëve të atdheut nëpër botë (kryesisht të rinjtë dhe forca aktive punëtore).

Në sytë e 79 vjecarit Sali Berisha, trishimi dhe lodhja, ankthi dhe dëshpërimi përditshmërisht po shtojnë rrathët e syve dhe evidentojnë pauzën e njerëzve të afërt që psikologjikisht i thërrasin “zoti Non grata” dhe vokalisht i drejtohen “Berisha i palodhur”. Sidoqoftë, ky kontrast mes Vetmevetes (Berisha) dhe të tjerëve përreth tij, nuk mjafton të ndryshojë fatin e pakthyeshëm të ikjes së afërt të tij. Kësaj here, si ikje e fundit nga politika, ka për të qenë pakthyeshmërisht më shumë se një ikje, jo prej mposhtjes, por prej ikjes së kohës.



Nga ALEKSANDËR ÇIPA



**“NON GRATA” / TRONDITJA
AMERIKANE PËR SHQIPËRINË E
SUKSESSHME APO DËSHTIM**

08

16 PD, NJË BASHKIM
I PA MUNDUR

24 INXHINIERI NAKO PETRO:
KONCESIONI I POMPAVE
TË NAFTËS, TREGU
NUK MONITOROHET

Nga **FATOS ÇOÇOLI**

44 POLICËT E LËNË RRUGËVE
PA BUKË, TË PASIGURUAR E PA
SHITESË PAGE JASHTË ORARIT

Nga **NIKOLETA KOVAÇI**



50

SHKODRA E 1850-ës

**MJEKU ITALIAN QË
NDIKOI TË PASHKO VASA**

Nga **DR. DORIAN KOÇI**



ENVER HOXHA, DEKLASIFIKOHEN DITARET

RINIA E NJË DIKTATORI QË S'E DONTË ARTIN

Nga LUELA MYFTARI

56 HISTORIA E GRUAS SHQIPTARE, NGA PERÇJA TE TEATRI, NGA MALET TEK VOTA

Nga ERGYS ALUSHI /VLORE

64 MARJETA LJARJA: RIKARDI QË JU NUK NJIHNI!

Nga SUADA DACI

70 SHKËLQIMI DHE RËNIA E DINAMOS

Nga RETIN TOKA

76 LULE, LULE, (jo të Flor Mumajesit) TË PRILL

Nga SUADA DACI

80 QUIZ BOMB

Nga KADRI VOKOPOLA



NEWSBOMB.al

PRILL
2022



ABONOHU!

POSTA SHQIPTARE:

+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbombal:

+355 69 67 32 020

abonime@newsbomb.al

ADRESA:

Rruga: "Emin Duraku",
Hyrja 1, Apartamenti 14, Tiranë

Mobile: +355 69 922 2201 | +355 69 922 2202

E-mail: info@newsbomb.al

NEWSBOMB SHPK
NIPT: L42417011Q



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ANILA BASHA

BASHKËPUNUAN

ALEKSANDËR ÇIPA

FATOS ÇOÇOLI

ANTA MUÇAKU

LUELA MYFTARI

NIKOLETA KOVAÇI

DORIAN KOÇI

ERGYS ALUSHI

RETIN TOKA

SUADA DACI

KADRI VOKOPOLA

GRAPHIC DESIGN

ALTIN ALIAJ

Kur je besnik, shpërblehesh si mik!

Më shumë pikë, më shumë përfitime
me kartat e kreditit VISA, të Tirana Bank



Histori me “non grata”. Si Shqipëria u bë objekt i sanksioneve amerikane për politikanët dhe zyrtarët e “paprekshëm”. Lista dhe historia e saj, emrat e panjohur nën urdhëresat e qeverisë së SHBA-së dhe ndikimet e listës së zezë në politikën shqiptare



POLITIKË

Më 2008 Kongresi Amerikan synoi të identifikojë dhe të shpallë të papërshtatshëm për të hyrë në Amerikë zyrtarë të huaj të përfshirë në afëra korruptive për të shfrytëzuar burimet natyrore të vendeve të tyre. Kongresi parashikon që zyrtarët e qeverive të huaja dhe anëtarët e tyre të ngushtë të familjes nuk kanë të drejtë të hyjnë në Shtetet e Bashkuara kur Sekretari i Shtetit ka informacion të besueshëm që zyrtari i huaj është përfshirë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me korrupsion të konsiderueshëm dhe/ose shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Variacionet e seksionit 7031(c) janë përfshirë në legjislacionin vjetor për ndarjet buxhetore të shtetit dhe të operacioneve të huaja që nga viti fiskal 2008. Seksioni 7031(c) kërkon që Sekretari i Shtetit të caktojë publikisht ose privatisht ata persona që gjenden të papërshtatshëm për hyrje në Shtetet e Bashkuara dhe “raportoni ato emërtime në Kongres në baza tremujore”. Për ata individë të caktuar publikisht, Departamenti mund të lëshojë një deklaratë publike duke emëruar të emëruarit që nuk janë të përshtatshëm për hyrje në Shtetet e Bashkuara sipas seksionit 7031(c).

Në vitin 2012, Kongresi e zgjeroi hapësirën e shtrirjes së këtij ndalimi, duke përfshirë në të termin “raste të mëdha korupsioni” dhe sqaroi se njoftimi për individët përkatës mund të bëhet publik ose të mbetet privat. Më 2018 SHBA vendosi të aplikojë edhe në Shqipëri aktin 7031(c). Në total midis viteve 2008-2022 Departamenti i Shtetit ka caktuar publikisht mbi 149 individë, duke përfshirë zyrtarë të huaj dhe anëtarët e tyre të ngushtë të familjes, sipas nenit 7031(c).

Shpallja “non grata” e Departamentit të

“NON GRATA” TRONDITJA AMERIKANE PËR SHQIPËRINË E SUKSESSHME APO DËSHTIM

Shtetit ka pak dalime me vendimin i sanksioneve ekonomike i marrë nga Departamenti i SHBA. Në kategorinë e pjesë politikanë dhe zyrtarë të

ndër-
Thesarit
parë bëjnë
lartë që kryejnë
edhe krime kundër demokracisë dhe shtetit të së drejtës, kurse në listën e dytë përfshihen kryesisht individë që përfshihen edhe në akte kriminale. Në dy rastet personat dhe familjet e tyre penalizohen për ndalimin e hyrjes në SHBA, asetet dhe operacionet financiare drejt SHBA bllokohen, si dhe vetë personat vihen nën shënjestër edhe të vendeve të tjera, kryesisht të vendeve kryesore në Bashkimin Evropian dhe Britania e Madhe.

PERSONA NON GRATA

LISTA POLITIKE E PERSONAVE “NON GRATA” NGA SHQIPËRIA

ADRIATIK LLALLA	ish-Prokuror i Përgjithshëm
VANGJUSH DAKO	ish-kryetar bashkie
TOM DOSHI	ish-deputet, kryetar i PSD
SALI BERISHA	ish-President, ish kryeministër, deputet
AQIF RAKIPI	ish-deputet
YLLI NDRUQI	botues e pronar në media

Lista është shpallur nga tre sekretarë të ndryshëm të shtetit, Rex Tillerson (R), Mike Pompeo (R) dhe Antony Blinken (D), pra sekretarë nga republikanët dhe nga demokratët, gjë që tregon se nuk bëhet fjalë për preferenca politike por për qëndrim të SHBA ndaj personave / vendit përkatës.

LISTA E FUNDIT E POLITIKANËVE “NON GRATA” SHPALLUR NGA QEVERIA AMERIKANE

NIKOLA GRUEVSKI	(North Macedonia)
SASHO MIJALKOV	(North Macedonia)
GORDANA TADIĆ	(Bosnia and Herzegovina)
ASIM SARAJLIC (Sarajlic)	(Bosnia and Herzegovina)
SVETOZAR MAROVIC (Marovic)	(Montenegro)

“NON GRATA”: I PARI NË LISTË, ISH PROKURORI ADRIATIK LLALLA

Më 14 shkurt 2018 sekretari i Shtetit Rex Tillerson deklaroi ndalimin e hyrjes në SHBA të ish Prokurorit të Përgjithshëm Adriatik Llalla dhe familjes së tij duke e akuzuar për korrupsion. Sipas vendimit, Llalla akuzohej për përfshirje në mënyrë ‘domethënëse’ në korrupsion ose shkeljeve të mëdha të të drejtave të njeriut. Llalla ishte drejtues i ILDKPKI përpara viteve 2012-2017 kur u zgjodh Prokuror i Përgjithshëm. Llalla kishte bërë “headline” në media për shkak të jetës luksozë të fëmijëve të tij dhe më vonë edhe për shkak të një numri të madh dosjesh e skandalesh që nuk u hetuan. Ai ishte akuzuar disa herë nga zyrtarët amerikanë në Tiranë për mbyllje të dosjeve korruptive dhe

për pengim të reformës në drejtësi. Përpara përfundimit të mandatit, ai u përfshi në replika publike me ambasadorin amerikan në Tiranë Doland Lu dhe akuzoi SHBA e BE se i kanë bërë presion për të hetuar e arrestuar zyrtarë të lartë, përfshirë ish kryeministrin Berisha.

Llalla është i vetmi person “non grata”, ndaj të cilit nisën hetime nga Prokuroria dhe në mesin e vitit 2021 ai u dënua përfundimisht nga Gjykata e Posaçme me 2 vite burg për “fshehje dhe mosdeklarim të pasurisë”. GJKKO, përveç dënimit me burg vendosi që t’i hiqet për 5 vite e drejta për të ushtruar funksione publike, si dhe u konfirmua konfiskimi mbi pasuritë e pjesshme përfshirë, 22 mijë metra katror truall dhe një apartament në Durrës. Pas dënimit në dy nivelet ai u shpall person nën kërkim dhe aktualisht është në Itali në pritje të vendim-marrjes nga autoritetet për ekstradim.

“NON GRATA”: I PARI POLITIKAN, DEPUTETI TOM DOSHI

Në prill 2018 deputeti Tom Doshi, i cili sapo kishte marrë edhe drejtimin e Partisë Socialdemokrate u shpall person i padëshirueshëm bashkë me familjen e tij nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Doshi ishte biznesmen dhe politikan me eksperiencë të gjatë si deputet në disa legjislatura dhe me dy parti politike të ndryshme (PS dhe PSD) përpara se ai të shpallej i padëshirueshëm për shkak të “angazhimit të tij në korrupsion domethënës”. Doshi kishte qenë disa herë headline në media për akuza dhe skandale, përfshirë edhe procesi i bujshëm i vitit 2015 kur ai akuzoi kryetarin e Kuvendit Ilir Meta për komplot vrasjeje ndaj tij. Me këtë rast ai u përjashtua zyrtarisht nga grupi parlamentar i PS, por megjithatë vijoi të ruajë lidhje të forta me këtë parti dhe në çdo rast është zgjedhur deputet me mbështetjen e saj.

Doshi nuk pati asnjë pasojë juridike në hetimet ndaj tij, përveç faktit se Australia i revokoi atij vizën australiane bazuar në informacione konfidenciale se nuk e kaloi testin e karakterit. Doshi i mohoi akuzat dhe i mbijetoi një procesi hetimi nga Prokuroria për pastrim parash iniciuar nga ILDKPKI. Ai vijoi të jetë në politikë edhe pas vitit 2018, duke u rizgjedhur deputet më 2019 dhe më pas më 2021. Një ditë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021 ai dha dorëheqje nga mandati parlam-

entar i legjislaturës së kaluar dhe legjislaturës së re, por mbeti kryetar i PSD. Prej vitesh Doshi ka ndikim të madh sidomos në zonën e Shkodrës, ku “de facto” ai ruan kontrollin edhe mbi strukturat e Partisë Socialiste. Të gjithë kundërshtarët e tij në PS, përfshirë ish ministrin e jashtëm Ditmir Bushati apo ish zv/kryeministren Senida Mesi janë larguar nga parlamenti dhe politika, kryesisht për shkak të preferencave të Doshit dhe ndikimit të tij në hartimin e listës së kandidatëve të PS-së në zgjedhjet parlamentare 2017 dhe 2021. Ai emëroi edhe kandidatin e PS për kryetar bashkie në Shkodër 2019, Valdrin Pjetri, i cili dha dorëheqje për shkak të dekriminalizimit vetëm një ditë pas zgjedhjes.

“NON GRATA”: I PARI KRYETAR BASHKIE, VANGJUSH DAKO

Më 30 korrik 2019 Departamenti Amerikan i Shtetit shpalli “non grata” ish kryetarin e Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako dhe familjen e tij. Në njoftim theksohet se arsyeja e kësaj mase është përfshirja e tij në raste të mëdha korrupsioni. Dako kishte drejtuar bashkinë Durrës me dorë të fortë, duke kontrolluar të gjitha burimet ekonomike dhe duke krijuar një sistem klientëve që prodhoi pafund vota për Partinë Socialiste. Kur u shpall “non grata” ai ishte zyrtarisht anëtar i kryesisë së PS dhe drejtues i qarkut Durrës, pozitë që e vijoi edhe gjatë vitit 2020. Edhe në fushatën elektorale të vitit 2021 dhe 2022 media solli dëshmi dhe pati akuza masive se Dako vijonte të ishte drejtues real i bashkisë Durrës. Në mosmarrëveshje me të, një kryetare bashkie pasuese e tij, u detyrua të japë dorëheqje, ndërkohë që Dako gëzoi mbështetjen personale të kryetarit të PS, Rama.

Pavarësisht akuzave të shumta dhe përfshirjes në skandale, ku më i njohuri është ai i vitit 2017, lidhjet me grupin kriminal të Avdyllajve dhe përgjimet për blerje votash që dolën në mediet gjermane dhe shqiptare, nuk pati asnjëherë hetime serioz ndaj tij, apo ndonjë pasojë, as masa ligjore ndaj tij.



“NON GRATA”: I PARI VIP, ISH KRYEMINISTRI DHE ISH PRESIDENTI SALI BERISHA

Kur në maj 2021 Sekretari i Shtetit, Antony Blinken, shpalli “non grata” ish kryeministrin dhe ish Presidentin Sali Berisha dhe familjen e tij, lajmi ishte i papritur dhe me ndikim të madh në jetën politike të vendit.

Berisha kishte qënë një prej dy figurave kryesore dominuese

të tranzicionit dhe pas 30 vitesh ai akuzohej për korrupsion, pengim të drejtësisë dhe minim të demokracisë. Berisha reagoi duke refuzuar akuzat dhe duke kërkuar nisjen e një çështje penale në Paris kundër sekretarit amerikan të shtetit. Ai akuzoi

qeverinë e kryeministrit

Rama dhe rrjetin e SOROS për akuzat e lobimin ndaj tij. Në shtator 2021 presioni amerikan detyroi kryetarin e PD Lulzim Basha ta pezullojë z.Berisha nga grupi parlamentar i PD. Reagimi i tij dhe mbështetësve të tij besnikë ishte i ashpër dhe pas 3 muajve fushatë në degët lokale të PD kundër Bashës, ai arriti në mars 2022 të sjellë dorëheqjen e Bashës dhe marrjen prej tij nën kontroll të PD-së.

Ndaj Berishës nuk ka pasur asnjëherë hetime serioze nga Prokuroria megjithëse djali i tij Shkelzen Berisha ka qënë i përfshirë direkt në ngjarjet tragjike që lidhen me Gërdecin dhe vetë Berisha ka qënë vazhdimisht i akuzuar për akte të ndryshme të abuzimit me pushtetin kryesisht gjatë viteve 1996-1997 dhe 2008-2013. Berisha ka përdorur mungesën e hetimeve serioze nga prokuroria si pretekst për të deklaruar se është i pafajshëm dhe viktimë politike. Ai vijon të jetë figurë me ndikim të madh publik, ndonëse rikthimi i tij në PD nuk ka ndryshuar raportet e tij personale me qeverinë e SHBA-ve.

“NON GRATA”: I PARI BIZNESMEN AQIF RAKIPI

Aqif Rakipi ishte deputet i PDIU në legjislaturën e vitit 2017 kur u detyrua të japë dorëheqje nga mandati për shkak të ligjit të dekriminalizimit. Ai u provua se kishte qënë i hetuar dhe dënuar nën një emër tjetër për akuzën e marrjes së mallrave të vjedhura, gjë që solli humbjen e mandatit parlamentar. Në zgjedhjet e vitit

2021 Rakipi nuk rikandidoi për deputet, por imponoi dy anëtarë të familjes së tij në listën shumëemërore të Partisë Socialiste. Djali i tij, Orlando Rakipi, i panjohur në publik dhe pa CV politike doli një nga tre personat më të votuar në Partinë Socialiste, dhëndrri i tij gjithashtu pa CV politike u zgjodh kryebashkaik dhe më pas deputet i PS në qarkun Elbasan, duke qënë gjithashtu shumë i votuar.

Më 11 prill 2022 Rakipi u penalizua me akuzën se ka ndikim të dëmshëm dhe destabilizues në proceset politike në Shqipëri. Grupe të shumta të krimit të organizuar (GKO) në Shqipëri kanë ofruar para, dhurata ose premtime për vende pune apo lëshime në këmbim të votave për partinë e tyre të preferuar politike. Sipas akuzës amerikane, Rakipi ka qënë prej kohësh i përfshirë në krimin e organizuar dhe është i lidhur ngushtë me një Grup Krimi të Organizuar, brenda të cilit ai ka ushtruar ndikim politik, përfshirë edhe përmes korrupsionit. Për shembull, Rakipi ka përdorur ndikimin e tij politik për të emëruar miqtë e tij në pozicione kyçe publike në Elbasan dhe Tiranë.

Duke qënë pjesë e familjes së Aqif Rakipit atij gjithashtu i ndalohej hyrja përgjithmonë në SHBA si dhe i ngrijnë asetet apo pasuritë që ai mund të ketë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

“NON GRATA”: I PARI PRONAR MEDIASH, YLLI NDROQI

Pronari i Ora News, një prej stacioneve më të rëndësishme informative dhe televizive në Shqipëri u përfshi në listën “non grata” në prill 2022, duke qënë i pari pronar mediash nga Shqipëria në këtë listë. Sipas deklaratës amerikane, Ndroqi akuzohej se ka shfrytëzuar mediat që më parë kanë qënë nën kontrollin e tij për të zhvatur dhe shantazhuar qytetarë shqiptarë nëpërmjet kërkesave për para dhe blerjeve të reklamave në këmbim të mospublikimit të artikujve negativë në media. Gjithashtu, ai ka ndërmjetësuar rryshfete për llogari të një subjekti që kërkonte të bënte biznes në Shqipëri. Ndroqi përcaktohet në bazë të E.O. 14033 sepse ka qënë përgjegjës ose bashkëpunëtor në ose për përfshirje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në korrupsion. Ndroqi kishte qënë më parë shënjestër e organeve hetimore duke kulmuar me vendimin e autoriteteve për



sekuetsrimin e pasurisë së tij më 2020 dhe 2021, me akuzën se janë ndërtuar mbi aktivitete kriminale. Ai kishte qenë më parë konsull i Meksikës në Shqipëri, kryetar i shoqatës së konsujve dhe bashkëshortja e tij pasoi pozicionin e konsullës së Kosovës në Shqipëri, pozita protokollare që siguronin akses diplomatik dhe imunitet.

REFUZIMI I VIZAVE AMERIKANE? MBI 200 ZYRTARË DHE INDIVIDË

SHBA nuk ka ndjekur praktikë publike distancimi dhe deklarimi për të gjitha rastet e vendimmarrjes për refuzimin e vizave dhe lejes për të udhëtuar për në SHBA, megjithatë ajo ka aplikuar prej vitesh praktikën e presionit përmes kufizimeve të tilla. Në çdo rast akuza ka qenë e njëjtë, të dhënat për përfshirje në korrupsion. SHBA dhe as ambasada amerikane në Tiranë nuk kanë bërë publike listë të tillë, por psh, në një deklaram në mars 2016 ish ambasadori Donald Lu pati konfirmuar se *“qeveria e SHBA u ka ndaluar hyrjen disa gjykatësve të korruptuar duke iu refuzuar apo anuluar vizën. Ky është vetëm fillimi! Kemi më shumë më tepër punë për të bërë për të luftuar korrupsionin”*. Në media dolën emra të ndryshëm gjyqtarësh e prokurorësh, në 10 raste të dhënat e refuzimit u përdorën edhe për subjekte të rivlerësimit gjatë seancave në KPK, duke u konsideruar fakte për shkarkimin e tyre.

Më 2017 një prej këtyre subjekteve, ish gjyqtari Artan Lazaj, i cili më parë kishte qenë edhe anëtar në KQZ i zgjedhur nga Partia Socialiste, pati pranuar publikisht se u telefonua nga ambasada amerikane për takim me konsullin, ku iu komunikua se anulimi i vizës amerikane. Ai konfirmoi se pjesë e listës për refuzimin ishin së paku 70 persona nga sistemi gjyqësor.

Refuzimi i vizave apo anulimi i tyre përfshiu edhe persona politikë, përfshirë politikanë drejtues në PS, PD dhe LSI. Media ka spekuluar emra të ndryshëm, por listat kanë ndryshuar në varësi nga situatat politike në vend dhe pozitës së individëve. Në listë gjithashtu kanë qenë e janë edhe përfaqësues të njohur nga bota e biznesit dhe medias, përfshirë një prej botuesve më të njohur në vend, pronar në medianë e shkruar dhe elektronike. Një tjetër pronar mediash është cituar me emër nga ambasadorët amerikane si rast i suksesshëm i luftës ndaj krimit.

“NON GRATA” TË TJERË? LISTA DO TË ZGJEROHET

Kur SHBA javën e kaluar dha njoftimin për dy emrat e rinj në listën e zezë amerikane pritshmëritë

ishin të tjera. As Ndroqi dhe as Rakipi nuk janë VIP në kuptimin e pushtetit politik dhe vendimmarrës në vend. Ata janë biznesmenë me lidhje politike, por vendimmarrjet dallojnë nga lidhjet dhe ndikimet politike. Pritshmëritë se në listë mund të ndodhej një ose dy prej zyrtarëve më të rëndësishëm drejtues në qeveri dhe në PS, si një masë kompensimi për shpalljen “non grata” të Berishës në PD, - nuk u përmbushën. Kjo duhet të ketë qenë arsyeja që ambasada amerikane deklaroi dy ditë më pas se procesi do të vijojë dhe se SHBA është e vendosur të penalizojë rastet flagrante të krimit dhe të korrupsionit në Shqipëri. Qeveria e SHBA përmes programeve të ndryshme vijon të mbështesë projekte dhe nisma kundër lidhjes së krimit me politikën përfshirë edhe jetësimin e ligjit të dekriminalizimit. Një prej tyre, database e krijuar nga Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e NED <https://dekriminalizimi.isp.com.al/> jep më shumë informacione mbi këtë temë.

“NON GRATA” NË SHBA DHE POPULLOR NË SHQIPËRI?

Tre politikanët e shpallur “non grata”, Berisha, Doshi dhe Dako, jo vetëm nuk humbën ndikimet e tyre politike në forcat politike që drejtojnë dhe në zonat e tyre të influencës, por shumëfishuan votat dhe ndikimin. Doshi arriti që nga një deputet pas shpalles “non grata” të fitonte tre deputetë, Dako ia arriti të shumëfishojë votat pro PS në Durrës dhe Berisha ia arriti të rimarrë drejtimin e PD duke detyruar të japë dorëheqje kryetarin Basha. Pyetja është: si është e mundur që individët non grata në SHBA bëhen kaq popullorë në Shqipëri dhe nëse strategjia amerikane ka pasur ose jo sukses. Në fakt, asnjë prej deklaratave amerikane kundër personave “non grata” nuk dha efekt elektoral. Ndaj tyre reagues pjesa intelektuale, elitat publike, shoqëria civile, etj, por militantët në bazë dhe strukturat klienteliste jo vetëm që refuzuan apelet amerikane, por edhe u bënë kritikë ndaj tyre.

Për shembull, pas vendimit amerikan ndaj Berishës mbështetësit e tij të shumë nisën fushata kritike ndaj SHBA dhe sidomos ambasadores amerikane. Nuk ka nevojë për sondazh për të kuptuar se për shumicën absolute të tyre vendimi është politik dhe ambasadorja amerikane është e njëanshme, duke mbështetur qartësisht qeverinë kundër opozitës. Kjo alibi u përdor vazhdimisht nga Berisha dhe i funksionoi. Nga ana tjetër edhe relativizimi i shpalljes “non grata” edhe nga PS (kryeministri Rama mori gjithnjë në mbrojtje Vangjush Dakon dhe Tom Doshin ashtu edhe të gjithë individët politikane të shkarkuar për shkak





Embassy of the United States of America
Tirana, Albania



të dekriminalizimit), të njëjtën gjë dhe në formë më arrogante bëri edhe Presidenti Meta, duke krijuar një koalicion të gjerë dhe të heshtur kundër palës amerikane. Mbështetës të këtij koalicioni u bënë edhe mediat kryesore, secila për shkak të agjendës së vet politike.

PASOJAT “NON GRATA”? HETIMET E MUNGUARA DHE BOSNJA SI MODEL

Pas rastit Rakipi ende nuk është e qartë nëse djali i tij dhe dhëndri i tij do të japin dorëheqje nga mandati i deputetit. Berisha nuk ka dhënë dorëheqje nga mandate dhe as politika, Doshi nuk ka dhënë dorëheqje nga PSD, Dako nuk ka dhënë dorëheqje nga PS. Pra, de facto asnjë nuk ka dhënë dorëheqje. Përvoja të kundërta gjejmë në disa vende të tjera, përfshirë Bosnjën. Asim Sarajliq, deputet, kryetar bashkie dhe zyrtar i lartë i Partisë udhëheqëse boshnjake të Veprimit Demokratik (SDA), deklaroi dorëheqje nga të gjitha funksionet politike pasi ai u përfshi në

listën amerikane të 11 prillit 2022. Sipas tij, “pavarësisht se nuk jam i dënuar për asnjë krim në shkallë të parë apo të fundit, besoj se – për shkak të vendimit të autoriteteve amerikane për të më futur në listën e personave të sanksionuar – është detyrimi im të jap dorëheqje nga pozicionet. Si person përgjegjës, për të cilin interesi i shtetit është mbi të gjitha, nuk dua të jem, në asnjë mënyrë, pengesë në zbatimin e planeve të përbashkëta strategjike dhe të partneriteteve midis Bosnjës dhe Shteteve të Bashkuara. SHBA është një mik i vërtetë afatgjatë dhe partner strategjik i Bosnjës dhe asnjë individ nuk duhet të jetë pengesë për bashkëpunimin e vazhdueshëm”. Ai shtoi se do të jetë në dispozicion të institucioneve gjyqësore të Bosnjës në çdo kohë, “plotësisht i bindur” se “do të provojë pafajësinë”.

Një deklaratë të tillë nuk e ka bërë asnjë nga politikanë, zyrtarët dhe biznesmenët shqiptarë të përfshirë në listën e penalizimeve amerikane. Bosnja nuk është model për një demokraci më



POLITIKË

funkionale sesa Shqipëria, por rasti “Sarajliq” tregon se ka diferenca mbi perceptimin mbi politikën dhe listën e zezë amerikane.

Nga ana tjetër asnjë prej personave politikë të përfshirë në listën e zezë amerikane nuk është hetuar ende nga Prokuroria / SPAK, çfarë e ka dobësuar fuqinë e aktit dhe ka lejuar të ketë spekulime politike. Duke mos pasur hetime nuk ka as masa ligjore kundër korrupsionit, gjë që iu jep të drejtë individëve të përdorin si alibi pafajësinë e tyre dhe mungesën e një akti të kundërt nga sistemi gjyqësor shqiptar. Një nga gjetjet e studimeve nga Institutit të Studimeve Politike është se për sa kohë nuk ka hetime serioze nga SPAK mbi politikanët e rëndësishëm, partitë nuk kanë rregulla të brendshme që parandalojnë karrierën e individëve me rekorde kriminale, nuk përjashtojnë realisht nga radhët e tyre individëve me rekorde kriminale, nuk respektojnë kodet etike dhe pranojnë burime financimi kriminale në fushata elektorale, do të jetë e pamundur të jetësohet dekriminalizimi dhe projekti amerikan për politikë e politikanë të pastër.

SANKSIONE EKONOMIKE? NJË LISTË E GJATË SHQIPTARE

Në listën e individëve dhe organizatave që janë penalizuar me sanksione ekonomike nga departamenti i thesarit të SHBA nuk bëjnë pjesë vetëm Rakipi dhe Ndroqi, por një numër i madh shqiptarësh. Në listë bën pjesë edhe një politikan tjetër, Idajet Beqiri, kryetar i PUK. Më 11 prill nga lista e sanksioneve amerikane u hoqën disa shqiptarë, kryesisht nga Kosova e Maqedonia. Ndër emrat më të njohur janë Sabit Gashi, Xhemajl Hyseni, Haradin Bala, Jonuz Musliu (pas vdekjes), Sait Rushiti, etj. Në një dëshmi të tij

ORGANIZATA NACIONALISTE SHQIPTARE TË SANKSIONUARA NGA SHBA

- | | |
|----|--|
| 1. | ALBANIAN NATIONAL ARMY (a.k.a. AKSH; a.k.a. ANA) |
| 2. | ARMY OF THE REPUBLIC OF ILIRIDA (a.k.a. ARI) |
| 3. | FRONT FOR ALBANIAN NATIONAL UNITY (a.k.a. FBKSH) |
| 4. | POLITICAL COUNCIL OF PRESEVO, MEDVEDJA, AND BUJANOVAC (a.k.a. PCPMB) |
| 5. | POPULAR MOVEMENT OF KOSOVO (a.k.a. LPK) |

ish pjesëtari i LKÇ në Kosovë Sabit Gashi, pjesë e listës së sanksioneve amerikane për rreth dy dekada tregoi mbi pasojat që ka pasur. Sipas tij, “kemi bartur mbi dy dekada probleme mjaft të larta, sanksione të mos lëvizim jashtë vendit, nuk kishim mundësi transferimi të parave e shumë sanksione të tjera. Në njëfarë mënyre, kemi qenë mjaft të sanksionuar”.

LISTA E SHQIPTARËVE TË SANKSIONUAR NGA SHBA (REFERUAR VITEVE 2001-2013)

1.	ADEMI, Rahim;	DOB 30 Jan 1954; POB Karac, Serbia and Montenegro; ICTY indictee (individual)
2.	ADEMI, Xhevat;	DOB 8 Dec 1962; POB Tetovo, Macedonia (individual)
3.	ADILI, Gafur;	DOB 5 Jan 1959; POB Kicevo, Macedonia (individual)
4.	BALA, Haradin;	DOB 10 Jun 1957; POB Gornja Koretica, Serbia and Montenegro; ICTY indictee (individual)
5.	BEQIRI, Idajet (a.k.a. BEQIRI, Hidajet);	DOB 20 Feb 1951; POB Mallakaster Fier, Albania (individual)
6.	BEXHETI, Nuri;	DOB 1962; POB Tetovo, Macedonia (individual)
7.	BUTKA, Spiro;	DOB 29 May 1949 (individual)
8.	DALIPI, Tahir;	DOB 1958; POB Ilince, Serbia and Montenegro (individual)
9.	ELSHANI, Gafur;	DOB 29 Mar 1958; POB Suva Reka, Serbia and Montenegro (individual)
10.	GASHI, Sabit;	DOB 30 Dec 1967; POB Suva Reka, Serbia and Montenegro (individual)
11.	HABIBI, Skender;	DOB 13 Jul 1968; POB Vitina, Serbia and Montenegro (individual)
12.	HALILI, Nevzat;	DOB 15 Sep 1946; POB Poroj, Macedonia (individual)
13.	HARADINAJ, Daut;	DOB 6 Apr 1978; POB Glodjane, Serbia and Montenegro (individual)
14.	HASANI, Zhavit;	DOB 5 May 1957; POB Tanusevci, Macedonia (individual)
15.	HAXHIREXHA, Kastriot;	DOB 9 May 1961; POB Debar, Macedonia (individual)
16.	HYSENI, Xhemajl;	DOB 15 Aug 1958; POB Lojane, Macedonia (individual)
17.	KRYEZIU, Izmet;	DOB 3 Oct 1954; POB Pagarusha-Malishev, Serbia and Montenegro (individual)
18.	LIBERATION ARMY OF PRESEVO,	MEDVEDJA, AND BUJANOVAC (a.k.a. UCPMB)
19.	LIMAJ, Fatmir;	DOB 4 Feb 1971; POB Banja, Serbia and Montenegro; ICTY indictee (individual)
20.	LLADROVICI, Ramiz;	DOB 3 Jan 1966 (individual)
21.	LUSHTAKU, Sami;	DOB 20 Feb 1961; POB Srbica, Serbia and Montenegro (individual)
22.	MARKU, Ton;	DOB 13 Jun 1964 (individual)
23.	MORINA, Xhavit;	DOB 13 Sep 1963; POB Drenovc (individual)
24.	MUSLIU, Isak;	DOB 31 Oct 1970; POB Racak, Serbia and Montenegro (individual)
25.	MUSLIU, Jonuz;	DOB 5 Jan 1959; POB Konculj, Serbia and Montenegro (individual)
26.	MUSLIU, Shefqet;	DOB 12 Feb 1963; POB Konculj, Serbia and Montenegro (individual)
27.	MUSTAFA, Rrustem;	DOB 27 Feb 1971; POB Podujevo, Serbia and Montenegro (individual)
28.	NDRECAJ, Maliq;	DOB 22 Apr 1969; POB Maciteve, Serbia and Montenegro (individual)
29.	REXHEPI, Daut;	DOB 1962; POB Poroj, Macedonia (individual)
30.	RUSHITI, Sait (a.k.a. RUXHETI, Sait);	DOB 7 Nov 1966 (individual)
31.	SELIMI, Rexhep;	DOB 15 Mar 1971; POB Iglarevo, Serbia and Montenegro (individual)
32.	SHAQIRI, Shaqir;	DOB 1 Sep 1964; POB Serbia and Montenegro (individual)
33.	SUMA, Emrush;	DOB 27 May 1974; POB Dimce, Serbia and Montenegro (individual)
34.	SYLA, Azem;	DOB 5 Apr 1951; POB Serbia and Montenegro (individual)
35.	XHAFFERI, Shefit;	DOB 1960 (individual)
36.	XHEMAJLI, Emrush;	DOB 5 May 1959; POB Uroševac, Serbia and Montenegro (individual)
37.	XHEMAJLI, Muhamet;	DOB 8 Feb 1958; POB Muhovac, Serbia and Montenegro (individual)



100%
Natural BIO



PD NJË BASHKIM I PA MUNDUR

Një vëzhgim i detajuar i revistës Newsbomb mbi zhvillimet e fundit në PD, ku pas largimit të Bashës, duket se ngërçi ka ngelur, dhe afrimi i palëve ngjan përditë e më i pamundur. Megjithatë të gjithë flasin për bashkim, të gjithë nga ana tjetër akuzojnë për nxitje të përçarjes

Largimi i Lulzim Bashës nga posti i kryetarit, pas zgjedhjeve të 6 marsit ku forca politike me logon dhe siglën e PD mori rezultat dëshpërues, u mendua se do ta bënte të lehtë sheshimin e konfliktit mes demokratëve dhe do të sillte rënien e rezistencës ndaj Sali Berishës.

Mirëpo, çdo ditë pas kësaj u provua se fronti anti-Berishë në PD nuk u shemb, madje po tregon shenja që është sfidues dhe i palodhur.

E gjitha ka ngecur tek Grupi Parlamentar. Një strukturë, një forum të cilin lideri historik, i përjashtuar prej Bashës nga aty me 9 shtator të vitit të kaluar, pasi u shpall non-grata prej Departamentit të Shtetit, nuk po e fut dot nën kontroll.

Dhe kemi të bëjmë me një trupë, më të rëndësishmen në PD sot, pasi që është legjitime dhe e votuar nga populli.

Nuk e morën seriozisht as Enkelejd Alibeaj kur pasoi Bashën, si i komanduar në krye të PD. Por, debatet e shpeshta dhe qëndrimi i palëkundur i tij në prani dhe faqe Berishës nëpër mbledhje, po e shfaqin këtë shtresë në parti, drejtuar prej tij, e cila nuk e dëshiron kthimin e doktorit, si një kockë të fortë dhe jo lehtësisht të kapërdishme.

Nga ana tjetër, jo pak deputetë që dolën haptazi kundër Lulzim Bashës dhe kërkuar largimin e tij, sot janë të pakënaqur me mënyrën

se si Komisioni i Rithemelimit, është duke organizuar zgjedhjet nëpër degët e Shqipërisë, për krerët, dhe për nivele më të ulëta si për grup seksionet.

Ata janë shprehur në debatet e mbledhjeve të grupit, që zgjasin me orë, se ky proces duhet ndalur pasi nuk po sjell bashkim.

Berisha kërkon ti ngrejë sa më shpejt ato struktura, pasi që në Kuvendin e parashikuar në fund të prillit, ka vendosur të mbyllë gjithë ciklin, duke zgjedhur Këshillin e ri Drejtues, Kryesinë e re të partisë, dhe drejtuesit e rinj të lartë.

Do të ngelet më tej vetëm një vakancë. Ajo për Kryetarin e Partisë Demokratike, që me gjasë, do të jetë një garë që do të ndodhë pasi të jenë konstituuar e gjithë forca politike, dhe nëse do të vendosë vetë Berisha të kandidojë, siç edhe deklaroi publikisht, ngelet shumë pak për të pasur befasi.

MBLEDHJET NERVOZE TË GRUPIT

Sali Berisha nuk është mësuar të ketë kundërshti, rezistencë, aq më shumë sfidë të hapur nëpër mbledhjet e Grupit Parlamentar. Edhe më herët, prania e tij në këto takime ishte imponuese. Dhe kur ato drejtoheshin nga Basha e raportet me liderin historik ishin normale, qe sërish Berisha që vinte pikat mbi “i”. Pakkush kishte kurajon të kontestonte, apo të kishte një mendim të ndryshëm.

Ngjan surreale situata sot.

Deputetë si Alibeaj, apo Bardhi, siç ka ndodhur në mbledhjen e fundit të grupit, shkojnë deri aty sa ta trajtojnë liderin historik me një lehtësi të papërballueshme, sikur të ishte një koleg i zakonshëm, siç e pati cilësuar mote më parë një ish drejtuese pranë Bashës, për të cilën, ajo u anatemia e u mallkua gjatë dhe në media, portale e rrjete sociale.



“Je i marrë fund” – i hakërrehet nervoz Berisha, Alibeajt, i cili ulet në karrigen e kreut të grupit dhe drejtuesit të mbledhjes. “Ti doktor, mua nuk më komplekson dot, as nuk më urdhëron dot. Pikë”, i kthehet me qetësi Alibeajt. Madje ai heq dorashkën. U thotë, hajde më hidhni në votëbesim

“Je i marrë fund” – i hakërrehet nervoz Berisha, Alibeajt, i cili ulet në karrigen e kreut të grupit dhe drejtuesit të mbledhjes.

“Ti doktor, mua nuk më komplekson dot, as nuk më urdhëron dot. Pikë”, i kthehet me qetësi Alibeajt.

Madje ai heq dorashkën. U thotë, hajde më hidhni në votëbesim.

Bardhi i kërkon llogari pse nuk flet për non-grata-t e reja të shpallura nga Departamenti i Shtetit, duke e akuzuar Berishën se po komplekson partinë duke mos mbajtur një qëndrim.

Më tej ngrihet Helidon Bushati i cili kërkon ndalimin dhe shtyrjen e zgjedhjeve nëpër strukturë.

Dhe në këtë e sipër, kur përmendet dhe etike-

tohet Lulzim Basha, del Dhurata Çupi dhe ngre tonet duke thënë se nuk është e moralshme të lëshohen komente apo fyerje për ish kryetarin i cili as nuk është në sallë.

Sigurisht se mbështetës të Berishës nuk rrinë në heshtje. Ata janë aty, kanë argumente dhe janë energjikë. Por çka vihet re është se lideri historik po merr goditje në pikën e tij më të fortë, tek miti që ka krijuar se është i plotfuqishëm dhe i pakontestueshëm. Më parë, deputetët kishin droje t'i përmendnin emrin. Kurse sot, edhe më të rinjtë prej tyre, kanë guximin të debatojnë, të kundërshtojnë, të kritikojnë.

Por lideri historik, di se si ta menaxhojë në publik këtë moment krize, pasi që kur shfaqet pas mbledhjeve në kamerat që presin poshtë, deklaron se qe një takim i frytshëm, dhe se ky forum u pasurua me mendim dhe ide.

Këto zhvillime po tregojnë se bashkimi i predikuar dhe i kërkuar shumë, është i pamundur në PD. Nuk ka asnjë dyshim se Berisha ka shumicën në atë parti. Problemi është, sfida ngelet, se si të integrojnë, të mbajë aty të lidhur edhe ata që nuk e duan më liderin historik, dhe që jo domosdoshmërisht janë njerëz, apo pasues të Bashës.

CILA DO TË JETË PD E DREJTUAR NGA BERISHA

Pas Kuvendit të 30 prillit, do të mund të shohim se cila do të jetë Partia Demokratike, tashmë e drejtuar nga Sali Berisha, 9 vite pasi



POLITIKË

dha dorëheqjen prej saj. I rikthyer në skenë, pas fushatave të forta në degë e në rrethe, me foltoren dhe me zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit, Sali Berisha premtonte se do ta sjellë PD-në edhe në pushtet, shumë shpejt. Ai thotë se është i vetmi që e mund Edi Ramën.

Kuvendi i 30 prillit do të zgjedhë Këshillin e ri Drejtues, që do të përbëhet me shumë më pak anëtarë, mendohet se mund të ketë deri në 150 vetë.

Ky Këshill më pas do të zgjedhë kryesinë e re të PD, që besohet se do të përbëhet nga 20 anëtarë.

E po ashtu, funksionarët e tjerë të lartë, si dy nënkryetarë, jo 4 sa kishte caktuar Basha. Dhe sekretariatit klasik, siç PD e ka patur më parë, me atë të Përgjithshëm, me Organizimin, Burimet Njerëzore, dhe Ligjorin e Elektoralin.

Është e qartë se tek rithemeluesit, tek, aktorët kryesorë, ka një garë mes tyre se cilët do të jenë në postet më të larta drejtuese. Një konkurrencë e fortë dhe e ethshme, që do të ishte ndoshta edhe më e ashpër, poqese nuk do ta mbante nën fre Doktorin me autoritetin e tij.

TË PREFERUARIT PËR NË KRYE

Ende nuk dihet me saktësi se cila do të jetë kupola e re drejtuese e PD, pas Kuvendit të 30 prillit. Sigurisht, aktorët kyç do të vijnë nga Komisioni i Rithemelimit. E besueshme është megjithatë, se Berisha do të promovojë ndonjë figurë që nuk njihet si besnik i verbër i tij, dhe që gëzon simpati në publik. Kjo edhe për të dhënë mesazhin e hapjes dhe bashkimit.

Një prej tyre përfillet se do të jetë Agron Shehaj, të cilit mund t'i besohet posti i njërit prej nënkryetarëve. Luciano Boçi më anë tjetër, shihet si favorit për të qënë edhe ai numri dy në PD. Boçi spikati në zgjedhjet e fundit parlamentare, ku arriti të thyejë herësin e të marrë mandatin e deputetit, pasi që prej Bashës nuk ishte lënë në pozicion fitues.

Ndërsa pothuajse bihet dakort se detyrën më të rëndësishme, atë të Sekretarit të Përgjithshëm, do ta marrë Belind Këlliçi, një i ri që është rritur shumë politikisht muajt e fundit, duke spikatur e krijuar një profil të tijin.

Këlliçi njihet mirë se nuk ka qënë në preferencat e Bashës, e megjithatë, pranohej se nuk do të jetë një levë në duart e Berishës, pasi ka

Është e qartë se tek rithemeluesit, tek, aktorët kryesorë, ka një garë mes tyre se cilët do të jenë në postet më të larta drejtuese. Një konkurrencë e fortë dhe e ethshme, që do të ishte ndoshta edhe më e ashpër, poqese nuk do ta mbante nën fre Doktorin me autoritetin e tij

fituar kurajon për të mos rënë dakort, kur nuk është dakort.

KONFLIKTI NË GJYKATË


Vendimi i Gjykatës së Rrehit të Tiranës, që njohu dhe regjistroi Kuvendin e 11 dhjetorit të mbajtur nga Berisha, rrjedhimisht dhe vendimet që u morën aty, për shkarkimin e Bashës dhe gjithë drejtuesve të tjerë, ishte pika e madhe e kthesës në zhvillimet në PD.

Po atë ditë, Komisioni i Rithemelimit sëbashku me Berishën, u futën në seli, aty ku patën dështuar të hyjnë me 8 janar, në atë përplasje të dhunshme e të palavdishme që ndodhi në mes të ditës, në mes të Tiranës.


Megjithatë, çështja duket se vazhdon. Fronti anti-Berishë në PD, që tani përfaqësohet nga Alibeaj e Bardhi, kanë bërë apelim. Argumenti sipas tyre është se, gjatë procesit të mbajtur në Gjykatën e Rrehit, Gjykatësi nuk ka marrë parasysh parashtrimet e tyre, si palë e interesuar. Ata, i kanë paraqitur në seancë pretendimet kundër njohjes së Kuvendit të 11 Dhjetorit. Mirëpo, burime pranë grupimit kundër Berishës, bëjnë me dije për revistën Newsbomb, se gjykatësi nuk i ka administruar fare argumentat e tyre. Dhe kjo, sipas tyre, është një bazë e mjaftueshme për ta bërë Apelin që ta rrëzojë atë vendim. Shqyrtimi ka nisur. Nëse kjo ndodh, atëherë do të kishim një kthim pas, dhe një furnizim të bollshëm të kaosit të krijuar në PD.

BASHA, NJË HISTORI E MBYLLUR

Edhe mbështetësit kryesorë të Lulzim Bashës, e pranojnë se ai është një kapitull i mbyllur. Disa takime që ka bërë nëpër rrethe, apo edhe në Tiranë, nuk kanë sjellë asnjë produkt. Mohohen po ashtu zërat se ai mund të bëjë një parti të re. Ama, nuk ka asnjë shans që të rikthehet edhe një herë në krye të PD, edhe në skenarin më favorizues për të, që do të ishte që Berisha të mos futej vetë për të marrë drejtimin e partisë.



TOPTANI



NË ZEMËR

TË TIRANËS!



| Nga **FATOS ÇOÇOLI**

Bujqësia na mban në punë 40 përqind të punonjësve dhe jep një të pestën e prodhimit kombëtar prej 13.7 miliardë eurosh. Ajo ishte komardarja e shpëtimit për vitin e mbrapshtë 1997 dhe për vitin e pamundur pandemik 2020. Për 12 vite rrjesht, nga viti 2010 deri në vitin 2021, eksportet e fruta-perimeve u shumëfishuan. Por këtë vit, duket se gjërat nuk po shkojnë si duhet. Çfarë ndodhi?

SERA-BIZNES I DËSHTUAR?

Humbjet nga prodhimi i serrave nisën në 2019-n, kur filloi zbatimin ndryshimi i skemës së TVSH-së të kompensueshme nga 20% që ishte më

Histori jete nga fermerët e “shkatërruar” ekonomikisht. Ardit Llupo nga Lushnja: “Nuk shikoj ndonjë të ardhme në punët e bujqësisë”. Mijëra fermerë të kthyer nga emigracioni po mendojnë të largohen sërish nga Shqipëria. Investimet në sera po u dështojnë. Cili duhet të jetë programi për daljen nga kriza dhe pse kanë rënë eksportet në fillim të vitit. Dështimi i bujqësisë, këmbana e alarmit për një valë të re largimesh



parë, në 6%. Diskutimet për ndryshimin e skemës u shoqëruan në 2018 me protesta nga fermerët, të cilët paralajmëruan se reduktimi i shkallës së kompensimit do t'u rrisë kostot e prodhimit.

Në vitet më pas, humbjet nga prodhimi bujqësor u thelluan, për shkak të rritjes së çmimit të fidanëve për të mbjellat, inputet bujqësore dhe ato të naftës. Në anën tjetër, fermerët shprehen të shqetësuar se nuk arrijnë dot të gjejnë treg shitje për produktet e tyre.

Mbingopja e tregut nga prodhimi i domates, specit, trangullit apo bostanit ka ndikuar në rënien e çmimit të shitjes. Prej disa vitesh, fermerët po shesin produktet e tyre nën kosto, arsyeja kryesore që e ka kthyer investimin e ngritjes së serave në të paleverdisshëm.

PRODHIMET NË KANAL!

Në zonën rurale të Lushnjës, që konsiderohet si zemra e zonës së Myzeqesë takon shumë fermerë të rinj, të cilët kanë braktisur investimet dhe po i rikthehen emigracionit. Arsyet e lënies së serrës janë mungesa e gjetjes së tregut për shitjen e prodhimeve, ndërsa kostot e prodhimit nga viti në vit po bëhen të papërballueshme.

Ardit Llupo është një fermer nga Lushnja, që të ardhurat nga puna e emigracionit i investoi në ngritjen e serrës, por tashmë është i detyruar të braktisë investimin familjar për t'u rikthyer në Itali.



ARDIT LLUPO



Ai zotëron 4,5 dynymë të mbjella me patëllxhan dhe kungull në sera, një investim i ngritur 20 vite më parë nga puna e tij dhe e babait në emigracion.

“Për ngritjen e serave, investuam rreth 3 milionë lekë me të ardhurat e fituara nga puna në Itali. Serra u ngrit në vitin 2000, rreth dy dekada më parë, një investim që sipas logjikës financiare duhet të ishte i konsoliduar.

Vitet e para fitimet kanë qenë të mira, por prej tre vitesh, prodhimi është në krizë. Arsyeja është rritja e koston së prodhimit dhe mungesa e gjetjes së tregut për t'i shitur produktet me fitim.

Në vitin 2019, kostoja për mbjelljen e 1 dynym serë ishte 80,000 lekë, sot llogaritet 130,000 lekë / dynym. Prej 2019-s, kostoja e prodhimit të perimeve është rritur, ndërsa çmimi i shitjes ka rënë. Nga ndryshimi i skemës së TVSh-së së kompensueshme, janë prekur më tepër rritja e çmimit të plehrave kimike dhe fidanëve. Një fidan bime kushton 12 lekë. Shpenzimet për blerjen e 2,400 bimëve fidan për 1 dynym sera janë rreth 30,000 lekë.

Për serën tonë, me sipërfaqe 4,5 dynymë, vetëm shpenzimet për blerjen e fidanit arrijnë 130,000 lekë. Janë edhe shpenzimet e plastmasës dhe të fuqisë punëtore për ta vjelë. Përveç shpenzimeve të larta, nuk gjejmë treg për shitjen e produkteve. Grumbulluesit i kërkojnë produktet me çmime të lira që janë nën koston e prodhuar. Edhe pse punojmë të gjithë familjarisht për serrën, nuk arrijmë dot ta përballojmë financiarisht jetesën. Aktualisht, për të nxjerrë të ardhurat e familjes, po punoj shofer në një kompani. Është turp të kesh investimin tënd dhe të punosh në privat”, thotë Ardit, i hidhëruar. Pastaj shton “Shpresa ime e vetme mbetet rikthimi që të punoj në emigracion. Pres që shumë shpejt të largohem për në Itali, ku do të punoj si bojaxhi. Jam kthyer para 4 vitesh nga emigracioni dhe do të largohem përsëri. Nuk shikoj të ardhme në punët e bujqësisë”.



“Shpresa ime e vetme mbetet rikthimi që të punoj në emigracion. Pres që shumë shpejt të largohem për në Itali, ku do të punoj si bojaxhi. Jam kthyer para 4 vitesh nga emigracioni dhe do të largohem përsëri. Nuk shikoj të ardhme në punët e bujqësisë”.

FERMERËT HODHËN 200 MILIONË EURO NË SERA

Investime të shumta u bënë në ndërtimin e serave. Fermerët tanë të kthyer nga emigracioni në këto vite numërohen me mijëra. Erdhën me shpresë të ndërtonin një të ardhme në tokën e tyre. Investuan paratë dhe njohuritë tek serat.

Në katër vitet e fundit ndihmuan shumë programet e Bashkimit Evropian të IPARD 2. Rreth 90 milionë euro erdhën nga programet e BE-së dhe nga Buxheti i Shtetit. Vetë fermerët investuan disa herë më shumë nga kursimet e tyre. Një pjesë morën edhe borxh, me perspektivën që shpejt do t'i shlyenin, nga rritja e prodhimit për treg dhe eksporteve. Tani nuk kanë më çfarë t'u kthejnë kreditë bankave. Nuk kishin llogaritur pandeminë. Nuk kishin llogaritur paketat fiskale shkatërruese për bujqësinë të viteve 2019 dhe 2022. Çfarë ndodhi?

FATALITETI I PAKETËS FISKALE 2022

Me pandeminë, në më pak se 15 muaj, çmimet e lëndëve të para në nivel botëror u rritën mesatarisht me 40 përqind! Kostot e transportit me 2.5 herë. Të gjitha këto e rënduan eksportin e fruta-perimeve edhe tek ne. Në janar 2022 u eksportua 15 përqind më pak se janari 2021.

Por kjo nuk do të thotë se nuk ka ende kërkesë. Jo. Ajo vijon të jetë e pranishme nga tregjet e huaja. Mirëpo prodhimi vendas i hershëm me dy-tre muaj në sera dhe avantazhi ynë për të cilin erdhën nga emigracioni fermerët është tkurrur. Po përse? Sepse politika për bujqësinë e qeverisë sonë për këtë vit është me kokë poshtë. Buxheti i Shtetit për bujqësinë është tkurrur me 2 përqind nga viti 2019, në

GRAFIK 1.

MBËSHJETJA E BUXHETIT TË SHETIT PËR HA NË SHQIPËRI, RAJON DHE BE

SHQIPËRIA	30 euro/ha
MAQEDONIA E VERIUT	200 euro/ha
KOSOVA	180 euro/ha
SERBI	100 euro/ha
BE si mesatare	400 euro/ha

GRAFIK 2.

BUXHETI 2022: INVESTIMET DHE UJITJA NË BUJQËSI

INVESTIMET E BRENDSHME	-20%
INVESTIMET E HUAJA	-23%
UJITJA DHE KULLIMI	-55%

Asnjë fond nga buxheti i Shtetit për ujitjen dhe kullimin në 2022!

vend që të rritet! Nuk ka fonde nga Buxheti i Shtetit për ujitjen dhe kanalizimet. Për të tilla punë, kaq të rëndësishme për fermerët, nuk ka as projekte të Bankës Botërore.

Dy lëvizje të qeverisë me paketën fiskale (taksat e reja) 2022 erdhën si thika pas shpine. Pikërisht në momentin më të vështirë për bujqësinë tonë, qeveria vendosi një taksë të re, TVSH-në prej 10% për inputet bujqësore, me idenë se eksportet bujqësore po na rriten kaq bukur në këto 12 vitet e fundit dhe duhet kontribuar më shumë për Buxhetin e Shtetit (!?).

Ide "fantastike" nga dritarja e zyrës me kompjuterin përballë. Por eksportet bujqësore po bien. Për fermerin, bie shi në të qullur! Ai e paguan tashmë TVSH-në kur blen hekur dhe materiale të tjera me TVSH për ndërtimin e serës, kur blen plasmasin për serën, kur blen energjinë elektrike, kur blen naftën (dhe është pronar me më pak se 0.4 ha tokë), si dhe kur blen shërbime mirëmbajtje për mekanikën bujqësore. Nga ana tjetër, qeveria heq edhe atë pak mbështetje që kishte mbetur që pas vitit 2019, kur kompensonte TVSH-në prej 6 përqind në blerje për fermerin (fermeri u shiste grumbulluesve për përpunim dhe eksport perime, fruta dhe bulmet).

A KA DRITË NË FUND TË TUNELIT?

Pas 1 janarit 2022, kur u hoq edhe ndihma e paktë me kompensimin e TVSH-së në blerje, zhgënjimi dhe pesimizmi mbizotërojnë



TABELA 1.

PROBLEMATIKA E MPREHTË

- Janar 2022: eksportet bujqësore 15% më pak se janari 2021
- Tkurrije e prodhimit në sera
- 30% e serave në rrezik falimentimi
- Rënie e ndjeshme e shitjeve për plasmas dhe fidanë
- Vendosja e TVSH-së prej 10% për inputet bujqësore në 2022
- Heqja e TVSH në blerje prej 6%
- Borxhet e fermerëve në nivele të larta
- Pesimizëm në të gjitha hallkat e zinxhirit bujqësor

në të gjithë hallkat e zinxhirit bujqësor. Dy protestat e fermerëve të Lushnjës në nëntor 2021, nuk u kuptuan nga qeveria. U kuptuan nga ajo, sikur fermerët ishin nxitur nga grosistët e produkteve bujqësore, që të dilnin në rrugë.

Qeveria në këto kushte emergjente, duhet të ndihmojë fermerin tonë. Fermerët po ikin sërisht në emigracion, pasi investimet po iu



rezultojnë të dështuara. Qeveria, jo vetëm nuk duhet të kontribuojë për këtë gjendje, me një politikë pa kokë në zinxhirin bujqësor, por duhet t'i ndihmojë fermerët me skema të suksesshme. Duhet të dëgjohet "SOS-i" që po e këlthet prej gjashtë muajsh bujqësia jonë, duke filluar që me protestat e fermerëve të Lushnjës në nëntor 2021. Mënyrat e ndihmës janë të gjitha të qarta dhe të mundshme. Duhet:

1. Të krijohet menjëherë bursa e produkteve bujqësore

2. Të rivendoset shërbimi shtetëror i agronomisë, që garanton cilësinë dhe nxjerr përgjegjësitë (farat, fidanet mashtrues), për prodhime jashtë standardit

3. Të kemi subvencion për njësi prodhimi, si e ka Kosova. Subvencion i cili, përveçse ndihmës direkt prodhuesit, ndikon në formalizimin e bujqësisë

4. Të nxisim industrinë përpunuese në përpunim (kompostim) për prodhimet që nuk arrijnë të shiten

5. Të bisedojmë me BE që një pjesë e programeve të IPARD 3 të shkojnë për industrinë përpunuese të lëndëve të para bujqësore të vendit.

Të gjitha këto, po të bëhen shpejt (kuptohet, edhe dy masat absurde të politikës fiskale në bujqësi të hiqen urgjentisht), mund ta mbajnë fermerin të qëndrojë në Shqipëri. Të mos largohet. Ne nuk mund të lejojmë fermerët t'i shtohen vargut të gjatë të ikjes nga vendi të mjekëve, saldatorëve, muratorëve, elektrikistëve e me rradhë të gjithë profesionistëve që kemi. Kryeministri tha në fund të vitit të kaluar që do të fliste me fermerët. Është pikërisht tani koha që t'i takojë!



| Nga **FATOS ÇOÇOLI**

Nako Petro, është ndër të paktët inxhinierë të naftës dhe gazit në Shqipëri, që del publikisht për të vendosur pikat mbi “i”. Në një kohë që qytetarët janë të mbytur në terr informativ, në mungesë ekspertize shumë të nevojshme edhe pse ekspertët janë aty; kur askush nuk kujtohet të marrin ndonjë mendim, inxhinier Nako, është ndër të vetmet zëra që del sa në një ekran në tjetrin, sa në një gazetë në tjetrën për të thënë fjalën e tij.


Gjithë jetën që pas studimeve në Universitetin e Tiranës në kohën e diktaturës ia ka kushtuar nëntokës shqiptare. E një vendin pëllëmbë më pëllëmbë. Ndihet keq kur sheh sesa e sa naftëtarë janë hedhur rrugëve.

Ishte ndër të parët që foli për shkatërrimin e rafinerive të naftës, gjithë atyre pasurive që u deshen vite të tëra punë të ndërtoheshin. Dhe i sheh tek shkatërrohen sa hap e mbyll sytë, pa rënë dielli i pasdites. Orët e gjata të punës në kantieret e naftës dhe gazit, ia kanë shtuar më shumë dashurinë për profesionin. Këtë profesion që për inxhinierin është më i rëndësishmi, sepse Shqipëria, sikurse ai e di, sikurse e dinë dhe pjesa më e madhe e shqiptarëve që jetojnë e punojnë në vend dhe jashtë saj, është një vendburim ndër më të mëdhenjtë të naftës dhe gazit në Shqipëri.

E pikërisht kur ekzistojnë këto kushte dhe rrethana, Shqipëria jo vetëm vuan mungesën e prodhimeve të bollshme të nëntokës së vet, por përballet me një rritje

INXHINIERI NAKO PETRO:

KONCESIONI I POMPAVE TË NAFTËS, TREGU NUK MONITOROHET





“Mungon një ekspert metrolog për të monitoruar zbatimin e kontratës. Nëse fitimet e parashikuara nuk arrihen, shteti do të mbajë rreziqet financiare, ndërsa koncesionari vetëm rrezikun e investimit”

galopante çmimesh ndikuar kjo më së fundi dhe nga zhvillimet botërore.

Në këtë intervistë të shkurtër për revistën NEWSBOMB.AL, inxhinieri flet për koncesionin e pompave. Ekzistojnë sipas tij 25 mijë pompa në karburantet në vend, dhe kontrolli i tyre, tani ka rënë në duart e privatit. Që jo vetëm nuk e kryen këtë siç duhet, por edhe abuzon, madje duke u folur tani edhe për rritjen e çmimit.

Dikur këtë detyrë e kryente shteti. Profesori nuk di të thotë pse një ndërmarrje e tillë iu hoq strukturës shtetërore që kishte gjithë kapacitetet dhe iu dha privatit. E thotë, se asnjëherë nuk është vonë për të marrë vendimet e duhura.

Profesor Petro, përse, sipas jush, koncesionari i koncesionit të kontrollit të pompave të naftës ka kërkuar një rritje të çmimit të shërbimit të tij pranë Ministrisë së Financave?

Kontrolli i pompave të naftës funksionon për të garantuar saktësinë e karburantit që shitet për qytetarët dhe entet shtetërore e private. Ai njihet si proces në të gjithë botën dhe zakonisht kryhet nga struktura të specializuara shtetërore matëse, si dhe inspektuese.

Tek ne, deri në fillim të vitit 2019, ky shërbim kryhej nga shteti dhe përkatësisht nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) dhe pastaj nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Në tetor të vitit 2018, shërbimi iu kalua privatit me një kontratë koncesionare. Në gjykimin tim, kontrata koncesionare mbart probleme. Kompania koncesionare private ka fituar të drejta për të gjobitur bizneset abuzuese, ndërkohë që me ligj këtë kompetencë e kanë organe shtetërore dhe vetë procesi i sanksioneve duhej të kalonte në filtra shtetërorë. Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), ku ndodhet Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, i është hequr e drejta e bllokimit të instrumentit matës, pasi verifikimet dhe kontrollet kryhen vetëm nga koncesionari. Me fjalë të tjera, privati kontrollon punën e tij! Kjo do të thotë



Shërbimi i metrologjisë ligjore për verifikimin e shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, është deleguar tek koncesionari, pa ofruar siguri që të ketë kapacitete të mjaftueshme për të monitoruar, ndërkohë që struktura shtetërore ka pasur një metodologji dhe manual mbi mënyrën e monitorimit

bën praktikisht të pakontrollueshme instrumentet matës dhe cilësinë e shërbimit të verifikimit që ofrohet nga koncesionari.

Ky koncesion u bë me qëllim përmirësimin e shërbimit të mbrojtjes së konsumatorit, por gjykoj se me të tregu mbetet tërësisht i pamonitoruar.

Nga ana tjetër, mungon një ekspert metrolog për të monitoruar zbatimin e kontratës. Nëse fitimet e parashikuara nuk arrihen, shteti do të mbajë rreziqet financiare, ndërsa koncesionari vetëm rrezikun e investimit.

Përse kontrolli i pompave është i rëndësishëm, Profesor?

Shqipëria ka rreth 25 mijë pompa në stacionet e karburanteve. Rritja e tarifës e rëndon drejtpërdrejt barrën mbi qytetarët me të paktën 3.4 milionë euro në vit, duke përfshirë dhe efektin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Do të ishte e pamendueshme rritja e tarifës në këto kohë të çmimeve rekord të naftës dhe të administrimit të tregut të karburanteve me borde, por në një moment tjetër, kjo mund të kryhet dhe do të dëmtonte interesat e qytetarëve.

Kosto e shërbimit të kontrollit të pompave në stacionet e karburanteve aktualisht është 14 mijë lekë për pompë në vit. Duke qenë se kjo tarifë paguhet nga shoqëritë e karburanteve, ajo transferohet si kosto direkte tek konsumatorët përmes çmimit fundor. Nëse, sikurse është përmendur, rrezikohet të dyfishohet tarifa e kontrollit, kjo do të reflektohet menjëherë në çmimin përfundimtar që paguan konsumatori.

se të drejtën e bllokimit për marrjen e masës administrative ndaj instrumentit matës në rast të shkeljeve, kontrata koncesionare ia ka njohur koncesionarit.

Përfashtimi që i bëhet institucionieve shtetërore nga ushtrimi i plotë të funksionit të inspektimit të instrumenteve të verifikuara prej koncesionarit, në gjykimin tim, rrezikon t'i bëjë të pakontrollueshëm instrumentet matëse të karburantit dhe shërbimin e verifikimit metrologjik.

Shërbimi i metrologjisë ligjore për verifikimin e shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, është deleguar tek koncesionari, pa ofruar siguri që të ketë kapacitete të mjaftueshme për të monitoruar, ndërkohë që struktura shtetërore ka pasur një metodologji dhe manual mbi mënyrën e monitorimit. Tani nuk ka as manual, as metodologji. Në rastin e karburanteve dhe gazit të lëngshëm, kjo qasje i



INTERVISTA

 **CREDINS** bank

VISA



Karta Planetit



ÇFARË PROVOKON DIREKT NGRITJEN E ÇMIMIT TË KARBURANTIT PËR QYTETARËT

Skandali i pompave të Pikave të Karburanteve duke krijuar monopol në tregun e hidrokarbureve, ka sjellë një tjetër reagim nga ana e disa kompanive që ofrojnë shërbime të ngjashme për “inspektim” dhe “çertifikim teknik”.

Në letyrën drejtuar disa prej institucioneve shtetërore, të cilat kanë dhënë OK për monopolizimin e këtij shërbimi, këto kompani kërkojnë “revokim të menjëhershëm të akteve të miratimit për shoqërinë NOA Control”.

Sipas përfaqësuesve juridikë të kompanive që kanë nënshkruar këtë letër kërkohet “ndalimi dhe eliminimi i abuzimit me pozitën dominuese në treg të kompanisë NOA Control e cila ka nënshkruar një kontratë 20-vjeçare me qëllim “verifikimin periodik të pompave të karburantit dhe të gazit në Shqipëri.

Këto kompani të njëjtën kërkesë ja kanë adresuar edhe Strukturës Përgjegjëse kundër Korrupsionit (SPAK) ku kërkohet menjëherë marrja e masave për:

1. Pezullimin e Lëshimit të Vërtetimeve Teknike
2. Kryerjen e Inspektimeve në Rezervuarët e Gazit të Lëngshëm dhe Karburanteve
3. Çertifikimin e personave që punojnë me pajisje presioni në pikat e karburanteve.

Pra, vërehet qartë se shoqëria NOA Control ka shkelur në mënyrë flagrante Ligjin 9121/2003, i cili parashtron “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas dispozitave të mëposhtme:

“Abuzim me pozitën dominuese në treg”, pika 1 dhe 2:1. Ndalohet çdo abuzim me pozitën dominuese nga një ose më shumë ndërmarrje, që e zotërojnë këtë pozitë në treg.

Mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese veçanërisht:

a) Kufizimi i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;

b) Zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.

d) Vendosja e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

“Nuk do të donim të përfshiheshim në diskutimin se si iu dha koncesioni një shoqërie që ofronte një sërë shërbimesh të tjera në të njëjtin sektor, sepse tashmë ky është një fakt i kryer. Ajo që praktikisht po na cënon të gjithëve, ka të bëjë me faktin se tashmë jemi në kushtet e dëmtimit të konkurrencës së lirë në ofrimin e shërbimeve të tjera inspektuese dhe çertifikuese në sektorin e karburanteve për të cilat janë miratuar disa Organe të Miratuara (OM).

Është lehtësisht e dukshme, që NOA Control falë pozitës dominuese me 2 shërbimet e sipërpërmendura (ku do të mjaftonte edhe një shërbim monopol i vetëm), i është lënë gjithë hapësira e mundshme për të shfrytëzuar apo abuzuar me pozitën dominuese me shërbimet monopol në sektorin e karburanteve, duke iu imponuar direkt apo indirekt subjekteve të tregtimit të karburanteve edhe në kryerjen e shërbimeve të tjera si paketë, përfshirë ato të inspektimit të depozitës së GLN, lëshimit të Vërtetimit Teknik dhe çertifikimit të punonjësve që përdorin pajisje nën presion”, pjesë nga letra drejtuar institucioneve shtetërore shqiptare të përfshira në këtë skandal të madh që provokon direkt ngritjen e çmimit të karburanteve për shqiptarët.



QAFSHTAMA

UJI I SHËNETIT

SHKARKO APLIKACIONIN
QAFSHTAMA



DHE BËJ POROSI DIREKT



I VETMI UJË I MBUSHUR NË BURIM NË LARTËSINË 1350 METRA

GJERGJ LUCA

KRYEOLIGARKU I SHRIMSIT, REBELI QË GRISI DIPLOMËN PËR T'U BËRË BIZNESMEN

| Nga ANTA MUÇAKU

Evërteta dhe puna, është edhe filozofia e jetës së Gjergj Lucës, njeriut që me gjithë rebelizmin, këmbënguljen e peripecitë e vazhdueshme, ia doli të ndërtojë një qytet të tërë.

Gjergji është djali i Ndreka dhe Mimika Lucës, dy prindër artistë, që kanë lënë në arkivën e dramës shqiptare dhjetëra role e pjesë të jashtëzakonshme. Ndreka ka lënë “Shtatë Shajlanët” apo “Votrën e Huaj” që i shkroi vetë, ndërsa Mimika, interpretimin më të mirë e ka në dramën “Drita” që e ka shkruar po vetë.

Dashurinë për artin, të bukurën, librat, ata janë përpjekur t’ia trashëgojnë edhe Gjergjit, edhe pse natyra e tij rebele që në vogëli, nuk ia ka bërë aspak të lehtë.

I ati nga Dukagjini, e ëma nga Gjirokastra, vetë u rrit në lagjet e Tiranës.

“Fëmijëria ime dhe e djemve e vajzave në “Tiranë të Re”, te “Myslym Shyri”, apo te “1 Maji” ka qenë një fëmijëri me shumë jetë. Ne dilnim nëpër rrugë dhe ballafaqoheshim me

njëri-tjetrin për tema të përditshme si loja, libri, muzika, sporti.

Ky lloj ballafaqimi, jashtë celularit në dorë, si duket, brezin tonë e ka çliruar. Jemi një brez që përshtatet shumë shpejt me ndryshimet dhe përballet me probleme nga më të ndryshmet. Ne jemi rritur në një jetë sociale me njëri-tjetrin dhe ka shumë rëndësi kjo e përbashkëta, socialja, fryma”.

Për Gjergjin, e rëndësishme është që dëshirat, pasionet, apo eksperimentet e moshës të kalohen në kohën e duhur.

Ndoshta koha ishte e duhura, por jo sistemi. Shpesh, gabimet e moshës, i sillnin telashe të tjera.

“Unë në adoleshencën time kam qenë shumë trazovaç. Luanim bixhoz me lekë monedhë, zar. Shihnim të rriturit që luanin fshehtas poker dhe shkonim luanim me shokët nëpër tarraca.

Deheshim klubeve me një lloj fërneti që e quanim mazut. Bënim dhe ndonjë gabim e sherr. Atëhere përfundojte te operativi i lagjes, por dhe në prokurori”.

Natyrë prej rebeli dhe zararet e moshës bënë që në vitin e parë të shkollës së Mesme të Politeknikut, ta përjashtonin.



Një ish-repart ushtarak, i mbetur gërmadhë, sot është shndërruar në një qytet mbresëlënës. “Fish City” në Labinot të Elbasanit është ndalesa që dëshmon të vërtetën e punës. Gjergj Luca në një rrëfim ndryshe për fëmijërinë, nga koha kur luante me zara, tek shkolla e natës dhe lotët e së ëmës... Arti - trashëgimnia që i lanë dy prindërit, Ndreka e Mimika Luca. Baba i pesë fëmijëve, nga dy martesë, e dyta me një ruse. Gjoha 1 milionë dollar që i vendosi Fatos Nano dhe adhurimi për Edi Ramën... Si ia doli të jetë Oligark, dhe respekti që gëzon për kolegët biznesmenë si ai vetë

**NEWS
BOMB**
PROFIL

Ai rrëfen pa kurrfarë droje se, e futën në një shkollë nate. Madje i ati, pas kësaj, i dha një mësim që nuk e harron edhe sot.

MË PËRJASHTUAN NGA SHKOLLA, PUNA E PARË SI MURATOR

“Im atë më mori prej veshi dhe më futi murator me gollobordasit. Isha 16 vjeç. E ka paguar rrogën time katër muaj që unë të kuptoja çfarë është puna. Më mbushi një karrocë dore me tulla dhe mbeturina dhe më detyronin të kaloja mepërmes Tiranës. Mendo pak! Unë gjithë ai djalë, pak i përkëdhelur, se djalë artisti!

Më pyesin: Çajë t’u bo, o Luc?

Punë fizike, u thoja - dhe ikja se më vinte zor (qesh)”.

Por prapësitë e Lucës nuk mbaruan këtu.

“Për pak isha duke humbur dhe vitin e parë në shkollë nate të “Sami Frashëri” se fillova dhe atje problemet me temperamentin tim.

Më kujtohet Mimika (e ëma), ka shkuar i ka rënë në gjunjë një drejtoreshe.

Quhej Emilia dhe nuk e harroj kurrë, siç nuk harroj brigadierin e parë që kam punuar murator, Lefko Bogdanin.

Mimika qante të Emilia: M’a ndihmo djalin se po ma përjashtojnë!”

Përfundimisht u gjet një kompromis që i ati Ndreka, të mund ta merrte në një film, “Flaka e Maleve”, kujtimi më i bukur që Gjergji ka me babain e tij.

“Më merr në Shkodër për të xhiruar filmin dhe aty më çojnë të shkolla e murgeshave për të mbaruar vitin e parë, shkollë nate, industriale. U ktheva prapë të “Sami Frashëri”, mbarova të dytin, mbarova dhe të tretin”.

Ai rrëfen se i ati e linte të lirë por, kishte një pikë ku nuk i hapte rrugë.

“I vetmi moment kur më diktonte e debatoonte me mua, ishte kur vinte ora e leximit. Më thoshte: Rruga është fakulteti më i madh, por nëse rrugën nuk e ballafaqon me librin, me leximin, ti kurrë s’ke për t’u bërë, sepse libri është formimi shpirtëror, intelektual dhe njerëzor. Rruga është ballafaqimi i këtij formimi”.

Dhe Gjergji ulej të lexonte çdo ditë, që të fitonte lirinë e tij.

E motra vazhdoi për mjekësi, ndërsa ai provoi vazhdimisht, derisa kuptoi thelbin e asaj që donte në të vërtetë.

“Tentoi të më fuste në piano nja 2-3 vjet, por nisesha për piano e përfundojta te liqeni. Mbaj mend, u futa notar me “Dinamo”-n. Pastaj pata fatin që nga murator të kaloja elektrikist për frigoriferat dhe ekspresat në një oficinë. Ajo ka qenë nje shkollë shumë e madhe për mua sepse nisa të kuptoja si të komunikoj dhe përshtatesha”.

Gjurmë në adoleshencë i ka lënë komuniteti i tiranasve që siç rrëfen, ia zbusnin “nervin” prej veriori.

“Njerëz të mrekullueshëm, të qetë. Kur ballafaqohesha me qetësinë e tyre s’kishte vend për sherre”.

Familja donte medoemos që Gjergji të ndiqte rrugën e artit.

“Nisa Institutin e Arteve dhe nëse e kam mbaruar sot fakultetin e Arteve ia kam borxh dikujt: Birçe Haskos! Ai burrë ishte aq i madh, sa kuptoi thelbin tim shpirtëror dhe më ka mbrojtur nga prapësitë e rinisë. Nga fillimi që më vinte zor, në vit të 4-t, dola nga studentët më të mirë të atij viti. Më emëruan regjisor në Lushnje në vend të Leka Bungos. Nuk më la im atë që të shkoja, se e dinte që me gojën e tmerrshme që kisha, do më fusnin Brenda (bëhet fjalë për në qeli). Më pas, Mevlan Shanaj, më mori në provë në redaksi të filmit dhe aty nisa asistent regjisor. U futa në atë botën që mua më ishte ushqyer vazhdimisht, shkrova dhe nja dy skenarë...”

“GRISA DIPLOMËN, NUK VAZHDOJA DOT ME PËRRALLA”

Por me të ardhur demokracia, grisi diplomën dhe vrapoi për të ndjekur të vërtetën e tij.

“Erdhi ‘90-ta, ndryshoi regjimi, unë dola i pari në rrugë dhe grisa diplomën se nuk e mbaja dot familjen me përralla. Në atë periudhë të gjithë vraponin për të siguruar bukën e shtëpisë. Nisa me një makinë të vjetër që më ndihmoi ime motër që ishte në Francë, çoja njerëz në Kakavijë. Kthehesha me rroba, i shisja në pazar. Kam fjetur rrugëve, hapja krahun se më këputej koka për gjumë. Kënaqësinë e punës e ndaja me miqtë dhe familjen time dhe... isha i lumtur”.

Pasioni i çmendur për gjuetinë e peshkut,

dalëngadalë e shtyu drejt biznesit.

“Nuk kam lënë rezervuar në Tiranë, Ishëm, Talje, Kep Rodoni, Velipojë; asnjë kënetë e pjesë deti, a derdhje lumi... pa njohur. Kam pasur një pasion në çmenduri për gjuetinë e peshkut. Kur erdhi demokracia, bëra një varkë druri 5 metra e një tjetër 5 metra dhe shkoja 2 herë në ditë në Velipojë dhe peshkun që kapja e shpërndaja në restorantet e Tiranës. Pastaj hapa një dyqan. E kështu, shto ujë, e shto miell...”

Kthesa si biznes i mirëfilltë erdhi në vitin e mbapshtë të ‘97-ës.

“Papritur mua më ngeli në dorë gjithë biznesi i peshkut, sepse ata që furnizohesha, një pjesë u trembën e ikën në Itali, një pjesë u mbyllën. Unë me atë nervin tim, nisa eksportet. Nisa tregtinë me Greqinë, e merrja mall në të gjitha portet kryesore. Ndërtova në Durrës një magazinë, në Shëngjin...”

Vetëm me punë. Nuk ka asnjë çelës tjetër suksesi. Puna për të është thelbi, frymëzimi, dashuria dhe përkushtimi për familjen.

Gjergji thotë se tamam-tamam e ka kuptuar se i përket botës së biznesit, kur politika nisi të merrej me të.



“Ka qenë viti 2001 kur Fatos Nano më mbylli biznesin. Gjoba e parë 1 milion dollarë, më e madhja që i është vënë biznesit shqiptar, “Rozafa Palace”. Një keqkuptim nga administrata e asaj kohe, por e vuajta shumë

“FATOS NANO MË MBYLLI BIZNESIN”

“Ka qenë viti 2001 kur Fatos Nano më mbylli biznesin. Gjoba e parë 1 milion dollarë, më e madhja që i është vënë biznesit shqiptar, “Rozafa Palace”. Një keqkuptim nga administrata e asaj kohe, por e vuajta shumë. Kuptova se këta njerëz kanë në dorë të të lenë në punën tënde, ose të të shkatërrojnë!”

Pavarësisht kësaj, ai thotë se ajo që ndodhi, nuk i çenoi raportin miqësor me Fatos Nanon dhe sot i dëshiron çdo të mirë!

Por nga ky moment, toni i rrëfimit të Gjergj Lucës merr të tjera ngjyime, sepse po flasim për akuzat që i vijnë nga politika.

A ESHTË AI OLIGARKU I PESHKUT?

“Më kanë bërë kryeoligark. Komedia e mendjeve shterpë e politikanëve që s’i ka thënë kush: puna e mbarë! Politikën e kujt bëjnë këta? Se politika mund të bëjmë ne që punojmë ditë e natë, që dimë çfarë është e mira, e keqja,



MIELLI ASSOS



MIELLI I PARË SHQIPTAR BIO





“Ai njeriu që drejton PS-në, i besoi ëndrrave tona, n’a motivoi e ne vrapuam me ec përpara. Unë luftova vetëm në një artikull. Mora Shrimsin (një lloj karkaleci) ku isha i specializuar më mirë dhe i lashë gjithë artikujt e tjerë. Sot Rozafa është oligarku i shrimsit në gjithë veriun e Evropës.

RAMA MË NDEZI DRITËN JESHILE

Për të, drita jeshile u ndez, kur Rama erdhi në pushtet.

“Ai njeriu që drejton PS-në, i besoi ëndrrave tona, n’a motivoi e ne vrapuam me ec përpara. Unë luftova vetëm në një artikull. Mora Shrimsin (një lloj karkaleci) ku isha i specializuar më mirë dhe i lashë gjithë artikujt e tjerë. Sot Rozafa është oligarku i shrimsit në gjithë veriun e Evropës. Ne kemi 75% të kontrollit të Shrimsit në evropë, të një lloj shrimsi që ka qenë i ndarë në dhjetra fabrika të tjera, që nuk mund ta kontrollonte kush. Sot e kontrollon Rozafa. E nëse m’a thonë oligark për këtë, qenkan burra të mençëm (qesh)!”

Por e njëjta politikë që ai e ka kaq shumë inat, e njëjta politikë që e goditi, e njëjta i ndezi edhe dritën jeshile.

Për të, nuk është tamam kështu. Rama thotë se bën përjashtim.

“Edi Rama nuk ka lidhje fare me politikën. Ai ka qenë pjesë e atij rrëfimi fëmijërie, është formuar me ne, i ka prekur gjërat me ne, pjesë e asaj shoqërie në komunitet, pjesë e ëndrrave tona, është qytetar. Ndaj bën dallim Edi Rama se s’ka lidhje me lekun, me hajninë, është idealist, punëtor. Dhe e vërteta që flet, është rrjedhojë e punës së vet. Dhe puna që bën ditë natë, është e vërteta e tij”.

E pyes sesi pas asaj gjobe marramendëse të disa viteve më parë, tani po ia del të mbajë larg politikën gjobvënëse nga biznesi i tij dhe sërish për këtë meritat ia njeh Edi Ramës.

“Në Shqipëri janë disa modele biznesi, relike, që njerëzit e administratës e kanë të vështirë t’i prekin. Këtë promovim ia ka bërë Ed Rama. Kryeministri i këtij vendi më ka respektur, ka ardhur 4-5 herë në fabrikë, gjëra që më duhet shumë punë që t’i meritoj, mbledhjet e qeverive, i ka bërë në një vend pune, në një vend të vërtetë, ku e vërteta është puna që shohim. Dhe këtë që ka bërë me “Rozafën”, e ka bërë me shumë biznese të tjera. Ka vajtur ka promovu ferma, agroturizme, modelet më të mira të Shqipërisë!”

Gjergj Luca e ka ndërtuar qytetin e tij, por nuk ndalet këtu.

“Ka nga ata që thonë: akoma do ky, si s’u ngop?! Kjo është e tmerrshme se s’është çështje ngopësie, por ëndrrash, sfidash. Njeriu pa punë, nuk është i zoti të shijojë asgjë. Ne duam respekt dhe duam të dëgjohemi për politikat e këtij vendi.

çfarë u vlen njerëzve, çfarë nuk u vlen; Por si mundet të bëjnë politika këta që gjithë ditën marrin nëpër gojë, flasin çfarë dëgjojnë nëpër tavolina dhe nuk ndiejnë ritmin, punën e këtij vendi, dëshirat e këtyre njerëzve?!

Këta vetëm komedi mund të pjellin”.

Gjergj Luca thotë se Shqipëria nuk ka oligarkë, sepse asnjë biznesmen në Shqipëri nuk ka fuqi mbi tregun në Evropë.

“A mund të ketë Shqipëria oligarkë me këtë treg të mbaruar? Çfarë tregu bëjmë ne për të pasur oligarkë? Oligarkë ka Amerika me treg të madh, Italia, Gjermania, Kina, Rusia... Po ç’oligark këtu me një treg që nuk imponohet për asgjë?! Oligark do të thotë të kesh fuqi të ndryshosh tregun. Shqipëria nuk ka njerëz që ndryshojnë trendin në Evropë. Cili nga biznesmenët shqiptarë ka forcë në ekonominë globale, cili ka fuqi të ndryshojë bursën e një artikulli? Samir Mane? S’është e vërtetë. Ka me mijëra punëtorë. Duhet me i heq kapelen. Çeti (Kastrati)? Çeti e ka nis nga zero, majë makinës.

Unë po, jam oligark, dhe kryeoligark.

Dhe po ta them pse. Kur më goditën, unë prodhoja në Shëngjin 40 artikuj. Kam kaluar 7 vjet në dëshpërim. Më mbyllën gjithë punën. Kisha kohë të mendoja dhe kuptova që artikujt e mi ballafaqoheshin me 40 firma në Itali dhe krijoheshin shumë probleme se unë nuk i konkuroja dot. Kush isha unë? Atëherë mendoja: duhet të ndryshosh filozofinë e punës, duhet të bëhesh i fortë në një artikull që ti mos jesh referencë siç isha unë në 40 artikuj. Duhet të bëhesh factor, se, po ishte faktor njerëzit do të respektojnë, po ishte referencë, njerëzit do të neglizhojnë”.



PJESË E  KASTRATI GROUP

ALBSIG MED



PËRFITONI:

20% – 35%

ulje në analiza & vizita mjekësore

10%

ulje në ndërhyrje kirurgjikale

Vlefshmëria 1 Vit

MË SKANO



 +355 (0) 42254770 / 764
 info@albsig.al
 www.albsig.al

Këta sillen në mënyrë megallomane, bastarde. Për këtë ka në dorë media që helmon gjakun e njerëzve. Njerëzit duhet të ndjejnë të vërtetën që vjen prej punës dhe jo përrallat e këtyre”.

Puna dhe e vërteta. Ky është togfjalëshi që përsërit vazhdimisht për këdo që si ai, do të mbërrijë larg, por po kërkon një mënyrë të shkurtër”.

“Politika e ka drejtu keq rininë. Ia ka bërë jetën shumë të kollajtë, shumë të lehtë. Me telefona në dorë, në mënyrë virtuale kujtojnë se bëjnë çdo gjë, por në fakt nuk bëjnë asgjë. Sillen nëpër botë, kërkojnë strehim e asistencë. Ndërsa një pjesë tjetër emigrantësh janë shembulli më i mirë në botë për sa të zotë janë, sa punojnë dhe sa ndihmojnë familjet.

Tani kjo rini e mbetur këtu duhet motivuar përmes punës dhe së vërtetës, jo përmes gënjeshtreve e përrallave e inkuzioneve që shkohet shpejt te leku aq më shpejt ikën për lesh, sa më ngadalë aq më larg”.

Gjergj Luca do të ndërtojë një park te madh teknologjik për rininë, me dhjetëra degë të ndryshme, profesionale dhe shkencore. Jo vetëm teorike, por dhe praktike.

“Unë e kam ëndërr, sepse mendoj që kështu i shërbej vendit tim. Dua që rinia të gjejë veten me argëtim e praktika mësimore. Kjo është ëndrra ime më e madhe që dhe kur unë mos jem nesër, kjo të mbetet”.

Në Fish City ka rreth 1500 të punësuar, por thotë se ka vend edhe për 1500 të tjerë.

Si çdo biznes, edhe ai e ka të vështirë të gjejë specialistë. Kapitenët e anijeve, motoristët apo zhytësat, kryesisht janë të huaj; turq, italianë e francezë.

Disiplina është ajo që i dallon në krahasim me punonjësit shqiptarë.

RININË SHQIPTARE E KANË MASHTRUAR

“Kanë një disiplinë të admirueshme për punën. Kjo vjen ngaqë këtyre njerëzve u është thënë e vërteta, jo rrena. Në të gjithë botën vazhdon i njëjti leksion: që duhet me punu se veç puna sjell të vërtetën e jetës, ashtu ecet para. Dhe këto leksione të gjithë që vijnë këtu i kanë parasysht. Në Shqipëri jo sepse politika është kanceri më i madh i këtij vendi, që ka rrejt që në ‘90: po vjen çeku i bardhë nga Amerika e pastaj me firmat piramidale, fshati në festë e tallava... Pastaj kanë vazhduar duke mashtruar me korrupsion.

Unë kam nipat e mi që më thonë: Dajë, s’na gjete ndonjë punë!

I them por çfarë di me bë ti? Po ja të hyjmë të vjedhim ndonjë lekë se janë bërë njerezit rehat, mbarë. JO! Nuk është kjo rruga, është rruga që ka ec daja juaj, me punë.

“Unë e kam ëndërr, sepse mendoj që kështu i shërbej vendit tim. Dua që rinia të gjejë veten me argëtim e praktika mësimore. Kjo është ëndrra ime më e madhe që dhe kur unë mos jem nesër, kjo të mbetet”.

Foto familjare
e Gjergj Lucës





Një nga vajzat
e Gjergj Lucës
duke punuar
në fabrikë

- O zotni, ata bëjnë lekë ti rri t'u fol jo puna jo e vërteta. E vërteta është lekë te xhepi.

Ky është halli më i madh për rininë. Se i kanë mashtuar. Kanë menduar se kapin qiellin".

Në këtë pikë është e pashmangshme që Gjergj Luca të mos rikthehet sërish te politika.

Ai thotë se ka një bërthamë të mirë ku përçohet fryma e Edi Ramës.

E pyes deri ku shkon kjo frymë dhe më përgjigjet fare spontanisht.

"Deri te Sekretari i Përgjithshëm i ministrive. Mbas tij, fillon rrupall dhe fshati në festë. Gjithë administra kaput".

Por a mund të mbahet qeveria me një njeri, apo me dy njerëz, i them...

"Qeverinë nuk e mbajnë ata, e mbajmë ne që prodhojmë, që themi të vërtetën. Ne duam Ed Ramën sepse n'a ka tregu që është si ne, punëtor dhe gërthet përditë të vërtetën që krijon puna. E mbajnë njerëzit e thjeshtë, jo horrat e palaçot. Ed Rama e bën me ne ngritjen ekonomike".

Për Gjergj Lucën, media është një tjetër e keqe e këtij vendi kur në vend që të promovojë modelet e punës, i bën pis.

"Ja ku më ke mua. Mua më thonë një fjalë, dal bërtas, i shaj sa më shajnë. Tani media thotë që unë kam marrë privilegje, ndërkohë që unë kam gjet një vend të shkatërruar, e kam nis nga zero. Dhe shteti im ka ardh ma ka vu metrin dhe ma ka vleresë me çmim si e re, 190 euro metro. 1 miliard e 400 milionë. Ky është privilegji? E kishin para syve përditë. E di sa reparte ushtarake ka ky vend? Pse s'shkojmë me i bë. Unë mendoj se jam shembull i mirë i këtij vendi, jo i keq. Këta duan të bëjnë pis çdo gjë. Këta s'duan të përmendin njeri për mirë. Këta jo vetëm që s'i promovojnë, por i nxijnë. Thonë "ja t'i biem këtij se i Ramës ky". Po ç'a

lidhje ka? Po unë, me e pas për nder me qenë mik i Ramës. Unë e them me plot gojë: këtë vend e ka kriju fryma e tij. Mua më çuan në fund të pusit. Në 2006 - 20013 më mbyllën gjithë biznesin. Model ndërkombëtar kam qenë dhe atëherë. "Rozafa" në Porto Sangiorgio, Serbi, Bullgari, Maqedoni, Greqi, gjithandej... ishte krenari kombëtare. E mbyllën. Prej së vërtetës. Këta nuk e durojnë të vërtetën"!

PO GJERGJ LUCA A KA MODELE? ÇFARË E FRYMËZON?

"Mua më frymëzon një grua që ka hap një pikë grumbullimi, as emrin s'ia di, në mes të fushës së Divjakës. Një grua që e ka ndihmu AZHBR dhe i ka bërë një pikë grumbullimi. Unë kur shoh atë (s'di si e ka emrin dreqi), që del mes katunarëve, merr prodhimet dhe bën me dhjetra eksporte, i them vetes: duhet ta takoj këtë, se kjo është binjakja ime.

Mua më frymëzon Luan Leka, inxhinier, burrë i jashtëzakonshëm, një nga modelet që unë kam parasysh në biznesin shqiptar ditë natë.

Ardeno, Tonini. Një malok si puna ime, punon me gruan. Ato male i ka kthyer në vepra arti".

Për një biznesmen si ai, paraja është thjesht një mjet për të vënë në lëvizje idetë e guximshme.

Sot, Gjergj Luca është 58 vjeç. Është martuar dy herë. Gruaja e dytë është shtetase ruse. Për të, ajo është pika e ftohtë e ujit që e qetëson sa herë ai arrin "temperaturën e vlimit".

Ka 5 fëmijë, më të voglin Ndreken, 3 vjeç. Si baba mundohet të mos ua plotësojë çdo tekë fëmijëve.

"Gocat e mia një muaj, çdo vit gjatë verës punojnë brenda në fabrikë me gratë, pastrojnë peshk, ose merren me magazinim. Është muaji që duhet të punojnë për lekët e pushimeve. Sigurisht që i stimuloj me pagesat, por gjithë këtë e bëj që të kuptojnë se rruga për të realizuar dëshirat e tyre, është puna".

Prindërit e tij lanë një pasuri të tërë kinematografike, po Gjergj Luca çfarë do të lerë pas kur të mos jetë më?

E ARDHMJA E "ROZAFÄ"-S NË BURSË

"Fëmijë që të vazhdojnë të administrojnë punën dhe ëndrrat e babait të tyre. Brezi i parë në biznes është brezi më delikat dhe më i rrezikuar, sepse në rast se nuk do jetë i zoti me vazhdu pjesën e ëndrrave, nuk ka bërë asgjë në këtë jetë. Unë jam shumë i rreptë me fëmijët dhe nëse nuk do bëhen, nuk do e trashëgojnë këtë punë. Dhe mendoj se e ardhmja e Rozafës do të jetë në bursë. Do bëj përpjekje që kur unë mos jem më, Rozafa të jetë një kompani që të ketë shumë interesa brenda për ta mbajtur në ekulibër e për ta çuar përpara. Dëshira ime është ta trashëgojnë fëmijët e mi, por do e marr këtë masë, sepse jetës nuk i dihet. Dhe do luftoj sa jam gjallë që ta fus këtë kompani në bursë dhe ta bëj internacionale".

DEKLASIFIKOHEN DITARET

do ta mbajë atë.
Nga ana tjetër, disa ditë më parë, këndova në gazetë se baleti ynë duke përgatitur shfaqje për popullin, nuk ka gjetur subjekt tjetër veçse valset e Shtrausit, të sajura në një kompozim të veçantë, me një temë gjoja "të moralit proletar", që s'ka të bëjë aspak me epokën e marrëzishme të valseve në fjalë. Po ç'janë valset e Shtrausit? Një excitant, shprehja e një epoke, shenja e transformimit të shoqërisë në fundin e shekullit të 19-të. 'Danubi i kaltër' nuk është i kaltër, po i turbullt, në qoftë se studiojmë gjendjen shoqërore dhe politike të kohës kur ai vals u shkrua. Po muzika është e bukur. Ky është fakt i pamohueshëm dhe unë nuk jam kundër që në radio të vihet ky vals ose edhe të tjera, por që regjisorët tanë, tok me ansamblin e baletit, të rrinë të punojnë muaj të tërë për të sajuar një shfaqje me këto valse, kjo politikisht dhe për edukimin e masave nuk sjell asnjë fitim, pra është punë pa dobi".

Nga LUELA MYFTARI

"Disa ditë më parë, këndova në gazetë se baleti ynë, duke përgatitur shfaqje për popullin, nuk ka gjetur subjekt tjetër veçse valset e Shtrausit, të sajura në një kompozim të veçantë, me një temë gjoja të moralit proletar, që s'ka të bëjë aspak me epokën e marrëzishme të valseve në fjalë. Po ç'janë valset e Shtrausit? Një excitant, shprehja e një epoke, shenja e transformimit të shoqërisë në fundin e shekullit të 19-të. **'Danubi i kaltër' nuk është i kaltër, po i turbullt**, në qoftë se

studiojmë gjendjen shoqërore dhe politike të kohës kur ai vals u shkrua. Po muzika është e bukur. Ky është fakt i pamohueshëm dhe unë nuk jam kundër që në radio të vihet ky vals ose edhe të tjera, por që regjisorët tanë, tok me ansamblin e baletit, të rrinë të punojnë muaj të tërë për të sajuar një shfaqje me këto valse, kjo politikisht dhe për edukimin e masave nuk sjell asnjë fitim, pra është punë pa dobi".

Këto janë fjalët e Enver Hoxhës në pleniumin e XV-të të Komitetit Qendror të PPSH-së i cili iu kushtua artit, kulturës dhe një pjesë e mirë



ENVER HOXHA

www.1

RINIA E NJË DIKTATORI QË S'E DONTE ARTIN

Nga liceu në Korçë me nota sa për të kaluar në klasën tjetër, e deri te studimet në Francë e Belgjikë, Enver Hoxha nuk arriti kurrë të shënonte rezultate të mira apo dashuri për artin e guximshëm. Ndonëse u dërgua të shkollohej në një nga vendet ku gëlonin rrethet artistike, në Francë, Hoxhën e tërhiqte gjithnjë populli i varfër shqiptar dhe gjuha e thjeshtë. Nga arrestimi për shitjen e mishit të prishur e deri te puna si orator në varrime, le të zbulojmë diçka për rininë e shthurur të Enver Hoxhës dhe detaje nga ditarët e tij.

por që regjizorët tonë, tek me ansamblin e baletit, të rrinë të punojnë muaj të tërë për të sajuar një gfaqje me këto valse, kjo politikisht nuk sjell asnjë fitim, pra është punë e gabuar.

Për çfarë i duhet popullit tonë ky balet? Për asgjë kisha për të thënë.

Me këtë rast vihet në dukje, si duhet ta këndojmë, ta studiojmë, ta shikojmë e ta gërvëzojmë eksperiencën e huaj botërore nga literatura, muzika, artet plastike, teatrot e kinematografia?

A duhet të përfitojmë në nga eksperiencat botërore në këto drejtime? Nuk do të ishte markatiste po të theshim jo, por do të ishte gjithashtu antimark-

siste të bëhemi skllavi i tyre, t'i gëlltitnim të gjitha q'kanë prodhuar njerëzit e huaj, pa një ana-

lisë të thellë, pa një klasifikim të drejtë.

e tij edhe letërsisë apo shkrimtarëve të kohës. Ishte viti 1965 dhe menjëherë pas këtij pleniumi të mbajtur nga Ramiz Aliaj, fjala përmbyllëse e diktatorit, jepte komanda të reja. Ishte koha që të dënoheshin disa artistë. I pari balet maestro Skënder Selimi, i cili fillimisht u dërgua për punë në fshatrat e Malësisë së Madhe, ndërsa bashkëshortja e tij e huajurvejohej nga Ish-Sigurimi i Shtetit për çdo hap që hidhte. Valset e Shtrausit nuk u vunë më në skenë dhe Skënder Selimi bashkë me shumë krijues të tjerë në Teatrin e Operas dhe Baletit u shpërblyen me indiferencën e shtetit e publikut dhe për disa edhe me dënimet e sojit socialist të Partisë së Punës.

Teksa e gjej këtë dokument në një nga ditarët sekret të deklasifikuar së fundmi nga Drejtoria e Arkivave në Tiranë, nxitoj t'ia përcjell familjarëve të baletmaestros që sot nuk është më. "Ky është dënimi i diktatorit për tim atë Skënder Selimi, fjalimi i atij dhjetori të vitit 1965. Diskutohej atë kohë për baletin "Jeta e Artistit", i cili pati vetëm provën gjenerale dhe u ndalua të shfaqej. Pas këtij krijimi, im atë u degdis në fshatrat e thellë të Malësisë së Madhe dhe nuk u kthye më në skenën e Teatrit të Operas dhe Baletit. Ishte pengu i madh i babit, pikërisht ky takim me publikun: 'Jeta e Artistit' dhe Valset e Shtrausit në një balet plot fantazi me kostumet e skenografi të Shaban Hysës. Krenare për tim atë dhe mendimin avangard që atë kohë, ndonëse që atëherë gjithçka ndryshoi jetën tonë. Të mendosh se ishte viti 1965", tregon Milena Selimi kur para syve ka një pjesë të aktit të dënimit dhe indoktrinimit të popullsisë përmes rregulla strike që do të duhej të ndiqnin artistët. Sepse nga ky vit, diktatori Hoxha do të indoktrinonte edhe më shumë popullin përmes artit. Kulmi i indoktrinimit do të jetë në vitet '70 dhe këtë e pohojnë thujtë të gjithë artistët e asaj kohe.

Nga ditarët e diktatorit Enver Hoxha do të doja të shkëpusja më shumë. Sepse ironia e fatkeqësive të mëvonshme vijnë pikërisht nga këto rreshta. Nis vërtet me Shtrausin, por në këto shënime të mbajtura mbi artin, gjen edhe akuza mbi luksin e shfrenuar të borgjezisë, siç e quante Hoxha një pjesë të shqiptarëve që më vonë mezi do të mund të siguronin edhe ushqimin e përditshëm përmes tollonave.

"Për çfarë i duhet popullit tonë ky balet? Përse e frymëzon atë ky balet? Për asgjë, kisha për të thënë. Me këtë rast na del përpara çështja se si duhet ta studiojmë dhe ta shfrytëzojmë



Fëmijëria e tij është plot anë të errta. Shumë dokumente janë shkatërruar kur Enver Hoxha u bë diktator. Të gjitha informacionet që nuk ishte e nevojshme t'i njihje populli shqiptar, thuajse shkuar për karton njëloj si veprat që s'duheshin lexuar


eksperiencën e huaj botërore në fushën e letërsisë, të muzikës, të arteve figurative, të teatrit e të kinematografisë. A duhet të përfitojmë ne nga eksperiencia botërore në këto drejtime? Nuk do të ishte marksiste po të thoshim jo, por do të ishte gjithashtu antmarksiste po të bëheshim skllavi i tyre, t'i gëlltitnim të gjitha ç'kanë prodhuar njerëzit e huaj, pa një analizë të thellë kritike, pa një klasifikim të drejtë. Çdo vepër, e çdo gjinie dhe e çdo kohe qoftë, ka anët e mira, ka edhe ato të këqija”.

LETËRSIA

Por, gjithnjë e më shumë diktatori do të gjente anë të këqija në veprat shqiptare. Dhe ajo nuk duronte dot diktatori ishte liria, që në ditarët e tij e gjen shpesh të etiketuar me fjalën “liberale”. Çdo vepër që ishte liberale, ndalohej, madje shkatërroj deri në atë pikë sa me të të prodhohej karton për një tjetër vepër të komunizmit. Gjithnjë e më shumë diktatori filloi të merrej edhe me kritikën letrare, apo atë të arteve figurative. Madje edhe me muzikën që krijohen në vend.

Enver Hoxha do të dënonte më vonë në 26 qershor të vitit 1973 poezinë e 21-vjeçarit Rudolf Marku. U akuzua për një poezi me influenca moderniste dhe të huaja. Vëllimi poetik i këtij autori të ri, atë kohë i sapobotuar me titullin “Shokët e mi” u hoq nga qarkullimi dhe u dërgua për karton, ndërsa autori Rudolf Marku u dërgua mësues, nëpër fshatra. Fatin e këtij vël-

Në listën që botuam në numurin e
pardjeshmë të nxënësve të Lyceut që
filuan definitivisht në provimet me
shkrim e me këndim gabimisht nuk u
shënua Enver Hoxha, i cili mori notën
Mention Passable.



e pajustificueshme nëse thellohesh në fëmijërinë dhe rininë e këtij udhëheqësi që u bë tiranik me artistët e popullit të vet.

FËMIJËRIA

Fëmijëria e tij është plot anë të errta. Shumë dokumente janë shkatërruar kur Enver Hoxha u bë diktator. Të gjitha informacionet që nuk ishte e nevojshme t'i njihje populli shqiptar, thuajse shkruar për karton njëlloj si veprat që s'duheshin lexuar. Duke nisur që nga data e lindjes e deri tek pushkatimi apo internimi i shokëve të klasës që e njihnin deri ku arriti përpjekja për të mësuar, apo talenti të riut Hoxha.

Në Arkivin Qëndror të Shtetit në Tiranë, për Enver Hoxhën, janë shënuar 5 ditëlindje të ndryshme. Regjistri i bashkisë Gjirokastrës, nr. 6, fleta 75 shënon se Enver Hoxha, ka lindur më 12 maj 1908. Në Liceun e Korçës, Hoxhës i janë shënuar dy ditëlindje: 17 qershor dhe 3 tetor (vitet 1929 e 1930). Në Francë, figuron se ka lindur më 3 tetor, ndërsa gazeta Bashkimi në vitin 1946 vendoste si ditëlindje 3 shtatorin. 16 Tetori në fakt është ditëlindja që njohin shqiptarët sepse Hoxha zgjodhi që të festonte në këtë datë dhe këtë e bëri publike po në gazetën "Bashkimi" më 16 tetor të vitit 1947.

Mësimet e para i ka marrë në lice. Por, një gazetë e kohës tregon se ish - diktatori Hoxha mezi kalonte në vitet e para të arsimit. Liceisti i Korçës, Enver Hoxha, ishte ndër nxënësit më të dobët, mesatarja e tij 5+. Kur u bë diktator thuajse dënoi dhe ekzekutoi të gjithë shokët e klasës, sepse mendohet se ata e dinin që Enver Hoxha kishte qenë një nxënës i keq, pa talente të veçanta dhe kush e di se si e kishte përfituar bursën. Në gazetën e Korçës ato ditë kur jepehin rezultatet e nxënësve, u harrua emri i Enver Hoxhës, por një ditë më pas, gazeta shkruan disa rreshta për të.

Por, nota të mira nuk mori dot as jashtë vendit ku u dërgua për studime. Se si fitoi të drejtat për të studiuar në Francë e Belgjikë ende asgjë nuk është në dritë të plotë. Nga liceu me nota thuajse thjesht kaluese, në një vend ku kultura gëlon, me përvoja dhe mundësi fantastike për të punuar në zyrat e kancelarive

limi poetik e ndoqi edhe romani i Petro Markos. Menjëherë për karton. Një ditë më vonë në mbledhjet e Lidhjes së Shkrimtarëve, edhe poezitë e Faslli Halilit u kritikuan. Dy ditë më vonë, në 28 qershor të 1973 edhe poezia "Jetë" e Xhevahir Spahiut u akuzua për të meta ideologjike. Të gjitha këto janë të pohuara nga vetë shkrimtarët. Ishtin vitet '70 kur arti duhet të ndërtohej si donte diktatori Hoxha, ndryshe artisti do të kishte fatin e Visar Zhitit, në burg, apo atë të artistëve të festivalit të 11-të të këngës në Radio-Televizion.

Po si ka mundësi që një udhëheqës shteti të mund të shkruante e fliste kështu për artin në një kohë kur kishte studiuar në një nga kryeqytetet ku kultura dhe ishte zëri kryesor i jetës shoqërore? Dhe nuk është krejt

"SHOKËT E MI"

Enver Hoxha do të dënonte më vonë në 26 qershor të vitit 1973 poezinë e 21-vjeçarit Rudolf Marku. U akuzua për një poezi me influenca moderniste dhe të huaja.

evropiane, Enver Hoxha kthehet në Shqipëri. Ishte gati t'i shiste mish dhe djath të prishur shqiptarëve rrugëve, në vend t'i kushtonte rëndësi mësimëve. Në 7 gusht të 1940-ës Hoxha arrestohet pikërisht me këtë akuzë.

KUR ENVER HOXHA SHISTE DJATH TË PRISHUR ITALIAN

Nuk ndodh shpesh që historianët t'i japin dokumentet, proces-verbalet, letrat apo faktet përpara se t'i publikojnë ato. Por një nga procesverbalet që doli nga një cep i dosjeve të punës për rishkrimin e historisë, ishte ai i vitit 1940, ku një djalë i ri me emrin Enver Hoxha ndalohej nga policia, sepse mashtrohte njerëzit si tregtar ambulant dhe i shiste atyre ushqime të prishura. Në këtë raport të policisë së Tiranës për ndalimin e Enver Hoxhës, faktet që pasqyrohen janë mjaft interesante për të kuptuar të shkuarën rinore të Enver Hoxhës përpara se ai të angazhohej si pjesë e lëvizjes komuniste në Shqipëri, një të shkuar që ai padiskutim me marrjen e pushtetit arriti ta fshihte nga arkivat, sigurisht në mënyrë që edhe historianët ta kishin të vështirë zbrëthimin e së shkuarës së ish diktatorit. Sipas këtij procesverballi të kohës, ngjarja ka ndodhur në 7 gusht 1940 dhe Enver Hoxha është kapur në flagrancë nga policia e asaj kohe duke shitur në rrugë këmbë derri të prishura dhe djath Italian që kutërbon erë të keqe.


PROCESVERBALI ORIGINAL KA KËTË PËRMBAJTJE:

Mbajtur me datë 7-8-940 ditën e Mërkurë ora 17.00 në Tiranë kundra të gojtunit Enver Hoxha i biri i Halitit lindur më 1905, banues në Tiranë. Me profesin Gj. Ushqimore për

shkak se në Rruga H. Toptani, i deklaruar në ketravajtje pse iu gjetën 3 (tre) zampe (kamb derri) të prishura me krymbe që i kishte ekspozue për shitje si dhe 2 (dy) kutije me copë djathi të firmës Bell Paese të prishun me erë të keqe.

I riu Hoxha la edhe punën si kancelar në legatën shqiptare në Bruksel dhe u kthye sërish në Shqipëri, ku do të punonte si kamarier dhe më vonë si folës, apo orator në varrimet e atyre që atë kohë ishin patriotët, apo dëshmorët e vendit.

Autori francez me origjinë hungareze, Thomas Schreiber ka botuar një biografi për jetën e Hoxhë në rini duke vënë në dyshim seksualitetin e tij, jetën e shturrur në Francë e Belgjikë dhe rikthimin në atdhe për t'u bërë diktatori, njëriu i pastër që do të vriste të gjithë shokët e mëhershëm që ia njohnin bëmat dhe temperamentin, që do të falsifikonte gjithçka që nga dita e lindjes e deri te fotografia e kafe Florës ku imazhi retushohet sepse diktatori nuk mund të shihej me cigare në dorë duke shijuar i shfrenuar jetën në Tiranë. Sepse kur u bë diktator, ai, Enver Hoxha mund ta shkruante gjithë jetën e tij si një vepër që të gjithë ta shijonin. Veprat e të tjetërve do të shkonin për karton, por jo ajo e Enver Hoxhës, sepse veprat e tij do të duhet t'i pëlqenin të gjithë. Dhe nëse "Danubi nuk i dukej i kaltër", asnjë prej shqiptarëve nuk do të duhej ta njihte trazinë e jetës së lirë dhe nëse Enver Hoxha donte të festonte më 16 tetor, ashtu do të ishte. Ai e shkroi jetën nga fillimi dhe mes rreshtave gjen ende stoike veprat e tij në vilën e Bllokut. Dhe ndonëse nuk dimë datën e lindjes, saktësisht dimë atë të vdekjes. Ishte prill i vitit 1985.




KOMPANIA e 1-rë E SHERBIMEVE TË TERRENIT.

erdha.

RRETH SHËRBIMEVE TONA

- | | | |
|--------------|-----------------|---------------------|
| ✓ Elektrike | ✓ CCTV | ✓ Menaxhim Mbetjesh |
| ✓ Hidraulike | ✓ Impiantistikë | ✓ Pastrime |
| ✓ Ndërtimi | ✓ Lyerje | ✓ Gjellbërim |

GARANCI
EKSELENCE **100%**



NA KONTAKTONI NË



KOMPLEKSI TIRANA
GOLDEN PARK 2

Tirana, ALBANIA



EMAIL

info@erdha.com



TELEFON

+355 67 70 70333



INSTAGRAM

@erdha.co



POLICËT E LËNË RRUGEVE

PA BUKË, TË PASIGURUAR E PA SHITESË PAGE JASHTË ORARIT



Nga NIKOLETA KOVAÇI

Fëmijët qanin në njërën prej dhomave, ndërsa Elvira vraponte sa andej këndeje për të ndihmuar të shoqin, oficer i policisë që u brof menjëherë nga krevati pa vënë gjumë në sy, pasi celulari tringëlli fort. Zilen e lë të lartë, se ka merak nëse telefoni bie e nuk e dëgjon për shkak të gjumit të thellë. Në anën tjetër të telefonit, shefi i Komisarariatit e urdhëronte të ishte menjëherë në rrugë. Ka ndodhur një ngjarje e rëndë.

Arbeni, prej 23 vitesh me uniformat blu është si urgjenca, me orar e pa orar për familjen. Uniforma e tij e policisë nuk ishte bërë gati ende. Nuk kishin pasur kohë. Ndjashkështojta u detyrua të linte fëmijët duke qarë e të ndihmonte të shoqin të vishej e të vraponte për në punë. Aty e pret errësira e ngjarjes, ashtu siç e ka pritur me qindra herë, në shi, pluhur, vapë përvëluese, kërcënime gjithfarësh, e deri në ankthin e çdominutshëm se ai dhe kolegët e tij mund të kenë të njëjtin fat siç ka viktima e ngjarjes për të cilën vrapon drejt saj.

Por ndërsa del me nxitim, ai e di se e ka mbyllur orarin e punës përgjatë ditës. Po ngjarja nuk pyet për orar pune të policit. Ai duhet të jetë aty, orë e pa orë, paguar e papaguar, sepse e di tashmë se prej më shumë se 8 vitesh paga e tij nuk ndryshon më. Aq, 500 mijë lekë të vjetra do të marrë, edhe sikur të punojë gjithë muajin 24 orë me 24. Po ngjarja nuk pyet për rregulla, grada, orë suplementare të papaguara, apo të rregulluara kundër tyre as për hile hartuesi ligjesh. Arbeni mendon se krimi duhet luftuar pavarësisht diskriminimit që i bëhet në gradë dhe në përditshmërinë e tij të mungesës së madhe për të parë fëmijët duke u rritur. Përvoja i ka rritur përkushtimin dhe nxitimin, por jo favorizimin nga shteti e për pasojë ai tashmë e di se çdo orë shtesë në punë është e papaguar për të përveçse është i bindur në domosdoshmërinë e pranisë së tij në atë ngjarje.

Arbeni konsiderohet polic i rolit bazë. Ai mban gradën inspektor. Atë gradë ka prej vitesh e po aq pagë ka prej vitesh. Po me atë pagë ka edhe djaloshin e turnit që sapo ka dalë nga shkolla, sepse ligji i policisë i ka njëtrajtësuar. Ai nuk pezmatohet për djaloshin e ri, por për vitet që ka mbi kurriz në organizatën e policisë dhe që vijon të trajtohet njësoj pa iu shtuar asnjë qindarkë, pa prituri të rritet në gradë, e aq më pak t'i thuhet se ka ardhur momenti të kesh përfitime nga puna prej më shumë se dy dekadash.

* * *

Po çfarë ka ndodhur vërtet me policinë në vendin tonë? Përse nuk iu rritet paga policëve që kalojnë 10, 20 apo 30 vite punë? “News Bomb” kërkoi përgjigje për këtë kategori efektivësh, që përbëjnë shumicën e policisë sonë në tërësi. U njoh me ligjin e ndryshuar, me mungesën e nxjerrjes

Policë që na mbrojnë nga kriminelët me orë e pa orë. Qeveria nxjerr ligje e vendime, por uniformat blu, janë shtresa më e diskriminuar e shoqërisë: Policët e rolit bazë nuk trajtohen me vakte ushqimore siç përcakton ligji; as nuk janë paisur me polica sigurimi për jetën; kush është vrrarë në krye të detyrës nuk ka marrë një banesë falas siç përcaktohet në vendime e mbi të gjitha, janë me mijëra që janë larguar nga detyra dhe janë derdhur dyerve të gjykatave. Si do vejë halli i policisë?



së akteve prej vitesh dhe me heshtjen e efektivëve të rolit bazë për ta ndryshuar fatin e tyre.

GJENDJA AKTUALE E ROLIT BAZË (INSEKTORËVE)

Për Policinë e Shtetit hartohen ligje nga një herë në vit. Në ndonjë kohë të ngutshme, kur Policia duhet më tepër, si në kohë krizash apo revoltash, qeverive iu ndodh të ndërhyjnë në ligjet e tyre për ta, edhe dy herë në vit. Por rrallë ndodh të merren vendime dhe të nxirren akte. Vendimet merren, hidhen nëpër fletore zyrtare dhe flenë aty. Askush nuk kujtohet për kategorinë bazë. As ata vetë, për veten e tyre. Nuk regaojnë përveçse iu qahen njerëzve të besueshëm, familjarëve të vet e ndoshta flasin me sho-shoqin se pse bëjnë dekada në polici e janë me të njëjtën pagë?

Pse një student, që sapo mbaron Akademinë del me të njëjtën gradë siç e kanë ata?

Pse nuk trajtohen me vaktin e ushqimit siç trajtohen pjesa e skuadrave të përcaktuara si elitë?

Që vazhdojnë të marrin urbanin në orët e vona të kthehen nëpër shtëpitë e tyre pasi e kanë të pamundur me pagën e tyre të kenë edhe një biçikletë e jo më makinë?

Policia e rolit bazë, me gradë thuajse të unifikuar prej shumë e shumë vitesh punë, kap diku shifrën e më shumë se 50 përqind të organizatës së policisë. Janë rreth 6 mijë forca policore që janë me të njëjtën gradë e për pasojë janë me të njëjtën pagë. Ligji për gradat ka ndryshuar që në 2014, është ndërhyrë në të, në 2017, me idenë për të hyrë në fuqi në 2018, por që sot e asaj dite qeveria nuk i ka nxjerrë aktet. "News Bomb" u kthye te ky ligj për të hasur shqetësimin e madh të mbi 4 mijë punonjësve të Policisë të cilët, sipas Shoqatës së Policisë, janë me gradën më të ulët, atë të Inspektorit. Mungesa e akteve, që qeveria me gjasë i ka lënë enkas pa nxjerrë, ka bërë që ky numër efektivësh të trajtohen njësoj me të rinjtë që hyjnë në punë sapo dalin nga bankat e shkollës. Por duke iu referuar këtij ligji, hasen edhe 4 probleme të tjera, madhore, për të cilat, në fakt, jo pak herë qeveritë mburren

se i kanë zgjidhur sa herë iu duhet një imazh për t'ia servirur publikut. Dhe përveç gradave, që i bie pagat, policia e këtij niveli ka të parregulluar sigurimin e jetës, vaktin ushqimor, marrjen e kredisë me kufi të përcaktuar jo më të lartë se 3 përqind dhe shtëpitë falas për familjarët e punonjësve të Policisë që bien në krye të detyrës! Pika e fundit, është gjithëpërfshirëse, pasi fati i keq nuk bie në bazë grade të përcaktuara nga qeveritë dhe hartuesit e ligjeve që më shumë janë sanksione për ta sesa të drejta!

MOS IMPLEMENTIMI I GRADAVE

Që prej 1 janarit të vitit 2018, janë 4 mijë efektivë policie të cilëve shteti iu detyrohet për shtesë page për gradat e paimplementuara. Ky fakt ka dëmtuar buxhetin familjar të tyre, ndonëse ata nuk kanë bërë asnjë reagim, përveç ankesës me bazë ligjore që ka deleguar kreu i Shoqatës, Sadedin Fishta, i cili ka vendosur të ngre padi kundër qeverisë për mosnxjerrjen e akteve që rregullon dy gradat që i përkasin këtij roli. Këtu përjashtohen të rinjtë! Sipas tij, në gradën Inspektor qeveria ka rrumbullakosur rreth 6 mijë efektivë, por 4 mijë prej tyre, me anë të ligjit përfitojnë gradat e përcaktuara; Inspektor i II dhe Inspektor i I. Konkretisht për Inspektor të dytë janë rreth 2200 punonjës dhe për gradën Inspektor i I, janë 1800. Këta nuk kanë përfituar këto grada për shkak të mosnxjerrjes së akteve sipas parashikimit ligjor të vendimit, marrë në marsin e vitit 2017 ku thuhej se do të hynte në fuqi me 1 janar të vitit 2018! Sipas Fishtës

shtesa në këto dy grada është 6 mijë lekë për kategorinë e Inspektorit të II, që presupozohet që e përfitojnë të gjithë ata punonjës që kanë mbi 10 vjet punë dhe diku te 8.7 mijë lekë të kategorisë së Inspektorit të parë që e përfitojnë automatikisht punonjësit që kanë më shumë se 15 vjet punë. Sipas tij, paditë kanë mbërritur deri në Gjykatën e Lartë, por ata për

shkak “stoku” dhe ndërhyrjesh, e kanë lënë aty dosjen të pa marrë në shqyrtim.

“Kam ngritur katër çështje që lidhen me punonjësit e policisë në gjykatë. Shkalla e parë dhe Apeli më nxjerrin bishta duke më konsideruar të paligjshëm sa herë ngre padi, ndërsa në Gjykatën e Lartë ndalohen shqyrtimet. Ata pretendojnë se bëhet fjalë për pamundësi trupe për të gjykuar çështjet e panumërta që kanë, por harrojnë se ato para që ua kanë mbajtur prej katër vitesh 4 mijë punonjësve të policisë do t'i paguajnë një ditë. Për to ka një vendim që e kanë nxjerrë vetë dhe nuk janë pak, po janë katër vite. Paçka se bëhet fjalë për një shifër qesharake parash, nëse do u jepej çdo muaj, kur të mbledhen në fund, apo nga ndonjë gjykatë ndërkombëtare, shifra do të rritet sepse do të rriten edhe elementët e kërkesë-padisë sonë!” Ai shpjegon se në gradën e Inspektorit, përfshihen tashmë edhe ata që kanë më pak se 10 vjet punë, duke bërë kështu unifikimin e gradës për të gjithë atë kategori që janë 15 vjet e poshtë punë në Organizatën e Policisë së Shtetit. Është neni 143 që sipas vendimit, rregullon nxjerrjen e akteve brenda 6 muajve nga botimi në fletoren zyrtare.

SHTËPITË FALAS

Sipas kreut të Shoqatës së Policisë ekziston një vendim qeverie i marrë në vitin 2014 i cili flet konkretisht për këtë përfitim që do të kenë familjarët e punonjësit të policisë që bie në krye të detyrës. Ai thotë se ata përfitojnë banesë falas nga shteti në kohën kur nuk e kanë një të tillë, por nuk ka ndodhur në asnjë rast. Në fakt duke iu referuar atij ligji, shihet qartë neni 75, pika ç, e ndryshuar, ku përcaktohet me emërtim të posaçëm:

Trajtimi i familjarëve të punonjësve të policisë që humbin jetën për shkak të detyrës. Në këtë nen thuhet se:

Kur punonjësi i policisë humb jetën për shkak të detyrës familjarët përfitojnë; ndihmë të menjëhershme financiare deri në 10 paga mujore sipas pagës së muajit të fundit;

Pension familjar suplementar në masën

PUNONJËSIT E POLICISË SË SHQETIT

LIDHIA NR. 1 PAGA BAZË PËR GRADË PËR

Grada	Paga bazë për gradë
Inspektor	50000
Nënkomisar	65500
Komisar	72000
Kryekomisar	87000
Drejtues	99000
Drejtues i parë	103000
Drejtues i lartë	115000
Drejtues madhor	125000

Faksimile
e listave të
pagave për
gradë

GRADAT

Janë 4000 efektivë policie që shteti u detyrohet shtesë page për gradat e paimplementuara. Vendimi që hyri në fuqi në 1 janar 2018 nuk është shoqëruar me aktet përkatëse. Do të përfitonin shtesë page ata policë që kanë mbi 10 vjet punë, si Inspektorët të nivelit të dytë, dhe Inspektorët e parë, ata që kanë mbi 15 vite punë përfitojnë çdo muaj 8,700 lekë. Çështja e gradave endet dyerve të gjykatave dhe ka mbërritur në Gjykatën e Lartë, por aty nuk merret ende në shqyrtim për shkak të volumit të madh të dosjeve

100 për qind të pagës mujore sipas rendit kalendarik të shërbimit pavarësisht nga periudha e sigurimit;

Rimbursim në masën 100 për qind të bursës së studimit për fëmijët në institucionet shtetërore;

Banesë falas për bashkëshorten/in kur janë të pastrehë!

Fishta tregon se asnjë nga familjarët e punonjësve të rënë në krye të detyrës nuk kanë marrë këtë përfitim që bie në vendimin e nxjerrë 8 vjet më parë dhe se nuk dihet nëse do ta marrin ndonjëherë. Ai tregon se qeveritë mjaftohen me homazhet dhe dhënien e 10 pagave mujore për familjen dhe më pas harrohen duke mos u kujtuar kurrë më për familjet e tyre veç se kur iu duhen për të rregulluar imazhet e tyre publike.

SIGURIMI I JETËS

“Qeveria nuk e ka mbajtur fjalën për sigurinë e jetës së policëve dhe për më tepër mungon ligji për të përcaktuar rregullat e përfitimit të siguracionit të jetës”, thotë kryetari i Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit, Sadedin Fishta. Ai ndalet te struktura me rrezikshmërinë më të lartë, te reparti RENE, punonjësit e të cilit, përballen drejtpërdrejtë me krimin. Edhe këta nuk kanë siguracion për jetën. Tenderi për sigurimin e jetës së Policisë së Shtetit duhej bërë që në 1 mars të vitit 2015.

“Edhe pse sigurimi i jetës është i parashikuar në ligjin e ri të Policisë, ende nuk është bërë asgjë. Premtimi i Qeverisë se efektivët e Policisë, por në veçanti forcat speciale RENE do të pajisen me siguracion jete, duket se është mbajtur vetëm në letër”, shprehet Fishta.

Në nenin 71 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, thuhet se punonjësi i Policisë përfiton sigurim jete, sipas rregullave të përcaktuara me vendim

500 + ZINC+ **D3** *DIRECT*

PËRTHITHJE MAKSIMALE

Rrit imunitetin

Lufton viruset

Zn

D3

C

- **funksionimin normal të sistemit imunitar**
- **mbrojtjen e qelizave nga stresi oksidativ**

Bustina të tretshme

Merret pa ujë

Shtesë ushqimore





të Këshillit të Ministrave. Por këtu qëndron edhe problemi. Mungesa e një VKMje për të përcaktuar rregullat e përfitimit të siguracionit të jetës, ka bërë që deri më sot të gjithë punonjësit e Policisë të jenë të pasiguruar.

Kreu i Sindikatës thotë: *“Çdo punonjës Policie që dëmtohet, ose vritet për shkak të detyrës ose në detyrë, duhet të ketë edhe një kontratë sigurimi. Qeveria duhet të parashikojë fondin. Duhet të kishte parashikuar që më 1 mars të para 7 viteve, të bënte tenderin se cila kompani do ta merrte përsipër sigurimin e punonjësve të Policisë. Absolutisht asnjë punonjës Policie nuk ka siguracion jete, pra për ndonjë dëmtim”.*

Fishta është i bindur që ky nen është lënë enkas në duart e një VKM-je që punonjësit e policisë të mos kenë mundësinë ta kërkojnë në sektorin drejtues, pasi lahen duart duke iu thënë se kjo bazohet në vendim qeveria që ende nuk ka dalë dhe as nuk dihet se kur do të dalë.

PËRFITIMI I KREDISË SË BUTË

Janë dy nenet që pretendohet se rregullojnë një moment kyç në jetën e punonjësve të Policisë. Bëhet fjalë për “E drejta për përfitim të kredisë me interes të butë” dhe “Kompensimi për strehim”. Në ligj përcaktohet se Punonjësi i policisë përfiton kredi për strehim me një interes në masën 3 për qind, rimbursimi i interesave ndërpritet kur punonjësi i policisë largohet ose përjashtohet dhe se kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në ligj thuhet se kur punonjësi i policisë, emërohet ose transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm brenda dhe jashtë vendit u paguhet qiraja e banesës kur nuk i sigurohet ajo, kriteret dhe masa e përfitimit të pagesës së qirasë

SIGURIMI I JETËS

Policët janë të parët që vrapojnë drejt kriminelit, por këtë, disa e bëjnë me zemër në dorë, e disa me guximin prej budallai. Dhe pse ligji parashikon se ata duhet të kenë sigurim jete, kjo, gjendet e shkruar vetëm në letër. Pritet të dalë një VKM që kush e di se kush e mban peng dhe situata është e njëjtë që nga marsi i vitit 2015. Askush nuk ka sigurim jete, as policët e rolit bazë, as ato forcat më elitare që na nderojnë në stërvitje edhe në rang ndërkombëtar, si RENEa apo FNSH. Gjithçka varet prej një tenderi të parealizuar, se kush duhet të bëjë sigurimin e jetës së uniformave blu

përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. *“Edhe këtu -thotë Fishta -qeveria nuk ka marrë asnjë masë për ta implementuar ligjin me akte, pasi punonjësit e policisë nuk e kanë përfituar sot e asaj dite këtë kredi për shkak të mosnxjerrjes së akteve nënligjore”.*

VAKTI USHQIMOR

Fishta tregon se e ka paditur Qeverinë që në vitin 2016 për ndarjen selektive që i është bërë policisë për trajtimin me vakt ose tre vakte ushqimi në ditë. Prej 6 vitesh ai thotë që padia e tij rri në gjykata për shkak se nuk merren në shqyrtim. Duke iu referuar të dhënave të tenderimit që daton këtë vit mësohet se Ministra e Brendshme e asaj kohe bëri prokurim vetëm për RENEa-n dhe FNSH-në për vakt ushqimor. Sindikata e Policisë ngriti padi kundër qeverisë për ushqimin e policëve të thjeshtë. Bëhet fjalë për një tender me vlerë rreth 18 miliardë lekë, ku u përfshinë përveç këtyre dy reparteve edhe Akademia dhe punonjësit e policisë së Burgjeve. Në padi sindikata pretendon se të paktën një vakt duhet ta përfitojnë mbi 10 mijë punonjës të kësaj organizate, që në fakt nuk e morën kurrë dhe jo vetëm vaktin po as kompensimin për mungesën e këtij vakti. Që atëherë e deri aktualisht, me përjashtim të Forcave Speciale, atyre të Ndërhyrjes së Shpejtë, si dhe Qendra e Formimit Policor në Sauk, të gjithë punonjësit e policisë në shkallë vendi, që nga viti 2008 nuk janë trajtuar. Sipas përllogaritjeve për një punonjës, shuma për trajtimin ushqimor arrin 7000 (shtatë mijë) lekë në muaj. Numri i punonjësve që nuk trajtohen është mijëra vetë. Aktualisht, sipas kreut të Sindikatës së Policisë, qeveria i detyrohet të paktën 420 mijë lekë çdo punonjësi të policisë që nuk trajtohen sipas VKM-së. Në padinë e dërguar në gjykatë, sindikata shprehet se mosveprimi i palës së paditur, duke mos ekzekutuar VKM-në përkatëse dhe urdhrin e nxjerrë nga ana e tyre, përbën shkelje ligjore të përcaktuara në ligj.

PROBLEMET SHITESË... NË VEND TË PAGAVE SHITESË


Kështu, punonjësit e policisë, kryesisht të

VAKTET USHQIMORE

Policët punojnë orë e pa orë, nuk kanë kohë të shkojnë në shtëpitë e tyre. Qeveria, që nga viti 2008 duhet të kishte zgjidhur problemin e ushqimit të tyre. Përveç reparteve speciale, askush tjetër nuk përfiton trajtim ushqimor. Bëhet fjalë për një tender në vlerën e 18 miliardë lekëve. Sindikata e policisë pretendon se përfitimin e një vakti ushqimor duhet ta marrin të paktën 10.000 policë. Kjo rëndon financat e buxhetit, por VKM që ka dalë, nuk është zbatuar. Dhe kjo do të zgjidhet në gjykatë

KREDITË PËR SHTËPI

Ligji për Policinë e Shtetit, shumë i mirë në letër, por i pazbatuar në realitet. Në ligj përcaktohet qartë se policët duhet të marrin kredi të butë me interes 3 përqind, apo edhe kompensim për strehim. Ndërsa policët që vriten në krye të detyrës duhet të marrin banesë falas nga shteti kur nuk e kanë një të tillë. Kreu i Sindikatës së Policisë thotë se kjo nuk është zbatuar në asnjë rast, qoftë për banesat falas, qoftë për dhënien e kredive me interes 3%. Shkak për moszbatimin e ligjit, është mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore. Por edhe sa vite do të zgjasë një situatë e tillë?



Faksimile e
Nenin për
nxjerrjen
e Akteve
nënligjore

policie shkëmbehet si pagë edhe në pozicione të tjera në administratë, kur lëvizja bëhet si nevojë institucionale, ndërkohë që përcaktohet edhe rikthimi me të njëjtën gradë në polici, por, gjithnjë me një "por", do të jetë një komision rivlerësimi që do të vendos nëse ky punonjës policie vlen të kthehet sërish në pozicionin që ka patur.

Një problem madhor, të cilit qeveria dhe hartuesit e vendimeve i shmangen dhe që do të ketë pasojë për xhepin e shqiptarëve është edhe largimi i punonjësve të policisë nga puna. Janë me dhjetëra gjyqe të fituara nga ana e ish-drejtuësve të sektorëve

të ndryshëm të cilët kanë fituar të drejtën të rikthehen në të njëjtin nivel grade që kanë qenë në momentin që janë larguar. Mirëpo, duke qenë se të drejtën për gjetjen e vendit të punës një të rikthyeri e ka Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, ai e delegon punonjësin që ka fituar gjyqin në sektorin që ka qenë. Por ndodh që drejtuesi aktual i atij sektori është në gradë më të ulët se sa i rikthyeri, ai nuk mund ta marrë në punë këtë punonjës ose i duhet që automatikisht të ulet në gradë ose t'i lëshojë karrigen e tij. Ngërçi nuk dihet se si do të zgjidhet, ndërkohë që janë me dhjetëra drejtues dhe deri me gradën e komisarit që e kanë fituar gjyqin dhe nuk janë stabilizuar ende.

Megjithatë, mbase, pak më vonë, kur qeveria do ta kuptojë se paditë mund të shkojnë edhe në Gjykatën Ndërkombëtare, do të ndërmarrë një VKM tjetër që do të rregullojë pas disa vitesh këtë marrëdhënie, nëse ata nuk dalin në pension, shumë prej të cilave janë në mosha të mesme e lart për shkak edhe të vjetërsisë në punë që kanë patur para shpërbërjes së marrëdhënies.

rolit bazë janë të parregulluar prej më shumë se një dekade për të gjitha të drejtat e tyre. Ata i drejtohen vetëm sindikatës për të mundësuar ngritjen e zërit, por ata nuk kanë mundur të ngrihen si zë shqetësues deri sa ta detyrojnë Qeverinë tua plotësisht kushtet. Sipas Fishtës hartuesit e ligjeve i bëjnë enkas vonesat, duke ndërhyrë herë pas here në ligj duke i çorientuar dhe duke mos i lënë të ngrenë asnjëherë krye përballë eprorëve të tyre.

Por përveç këtyre pikave, që prekin drejt-përdrejt buxhetin dhe sigurinë e efektivëve të policisë janë edhe një mori problematikash të tjera që kanë dalë ndër vite me këtë organizatë.

Janë transferimet dhe largimet me patëdrejtë nga puna. Qeveria ka ndërhyrë në fundin e vitit që lamë pas me një VKM për të rregulluar lëvizjen e punonjësve të policisë për në administratë dhe rikthimin e tyre në detyrë. Në fakt ai vendim më shumë u nxor për të justifikuar emërimin e ish-kryepolicit të vendit, Ardi Veliu për në postin e zëvendësministrit, duke bërë të mundur kështu edhe ekuivalencën e pagës në bazë të gradës që kishte mbajtur drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Në vendim përcaktohet se grada e një punonjësi



AKTUALITET



MJEKU ITALIAN QË NDIKOI TE PASHKO VASA

Edward Lear në 1851 boton skicat e realizuara në Shqipëri. Përmes tyre, kemi të dhëna se kush ishin njerëzit që ndikuan më shumë në kryeqendrën e veriut të Shqipërisë. Si u lidhën mes tyre dhe me fatet e njëri-tjetrit, ndikimet që patën italianët në pjesën e të ashtuajturës Turqi Evropiane

Nga DR DORIAN KOÇI

Udhëtimi drejt së panjohurës në mesin e shekullit të XIX në botën kulturore britanike u kthye dalëngadalë nga një udhëtim për argëtim, në një domosdoshmëri për të mbledhur përvojë e fituar dije. Territori i së ashtuajturës Turqi Evropiane, apo Lindje e Afërt, vazhdoi për një kohë të gjatë të grishte kureshtje dhe interes. Shpeshherë këto territore u panë drejtë për së drejtë si një vazhdim i Orientit që ndodhej shumë afër pothuajse tek pragu i derës, ku pas teksteve të hershme të Bajronit, Leak e Ulhart, nuk mungojnë të gjejnë pasqyrim dhe skicat e tablotë e ndryshme. Mes piktorëve të tjerë që ilustruan veprat voluminoze të udhëtarëve të mëparshëm britanikë që udhëtuan në Shqipëri ishte dhe Edward Lear (1812-1888), peizazhist, piktor dhe poet i periudhës Viktoriane në Britani. Përmes portreteve të pikturuara prej tij në Shkodër, arrijmë të gjurmojmë një seri personazhesh kulturore dhe historikë të kryeqendrës së veriut të Shqipërisë.

Edward Lear në kulturën britanike është i përmendur më shumë për “vargjet e tij origjinale e pa kuptim për fëmijët në letërsinë angleze”, por në fushën e studimeve ballka-

nike përmendet për ditarin e vet “Journal of a Landscape Painter in Albania” i botuar për herë parë më 1851. Ditari është pasqyrim i mbresave dhe shënimeve të udhëtimit që Lear-i ndërmori në Shqipëri më 24 shtator – 4 nëntor 1848. Janë të shumtë udhëtarët dhe piktorët të nxitur dhe të joshur nga ekzotizmi i veprave të Byron dhe veprës së Hobhauzit “A journey through Albania and other European provinces of Turkish Empire” që vizituan dhe skicuan Epirin dhe Greqinë, por asnjëri prej tyre nuk vizitoi veriun e Shqipërisë dhe ish-kryeqendrën e rezistencës shqiptare në shekullin e XV, Krujën. E veçanta e Lear-it krahasuar me udhëtarët e tjerë britanikë nuk është vetëm fakti se ai hyri nga lindja e Ballkanit (porti i Selanikut) por se udhëtoi gjatë e thellë në drejtimin jug-veri. Vetë Lear ndihet krenar për udhëtimin e ndërmarrë pasi thekson në ditarin e vet se është i “vetmi anglez që jep të dhëna për disa vende si pjesa e maleve Akrokerane, Kruja e rrethinat e Ohrit”.

Në 2 tetor të vitit 1848, ai arriti deri në Shkodër, ku u prit nga Zv.konsulli Britanik Spiridon Bonnati. Edward Lear kishte letra rekomandimi për z.Bonati dhe ai e rregulloi të flinte në shtëpinë e një farmacisti venecian të quajtur Marko. Pasioni i Lear-it ishte pik-



Pas vizitave të korteziisë te Pashai i Shkodrës dhe drekës së shtruar për nder të tij, ai nxitoi që të nesërmen të pikturonte pejsazhet e mrekullueshme të Shkodrës. Përveç pejsazheve, Lear skicoi dhe portretet e të njohurve të rrethit miqësor të Spiridon Bonattit që ai takoi në Shkodër

tura dhe gravurat. Një nga karakteristikat e udhëtarit britanik në gjysmën e shekullit të XIX ishte se ai zakonisht e zgjidhte kauzën të cilën dëshironte të përkrahte përpara se të fillonte udhëtimin. Lear bënte pjesë në këtë kategori udhëtarësh, pasi duke qenë para së gjithash një peizazhist dhe ilustrues me një ambicie të madhe, ai vazhdimisht ishte në kërkim të piktoreskes dhe sublimes të inspiruar nga panoramat e Mesdheut. Për këtë arsye pas vizitave të korteziisë te Pashai i Shkodrës dhe drekës së shtruar për nder të tij, ai nxitoi

që të nesërmen të pikturonte pejsazhet e mrekullueshme të Shkodrës. Përveç pejsazheve, Lear skicoi dhe portretet e të njohurve të rrethit miqësor të Spiridon Bonattit që ai takoi në Shkodër.

Ditën e katërt të qëndrimit në Shkodër, Lear-i e kish planifikuar për të pikturuar për miqtë. Që herët në datën 5 tetor 1848 shkoi në shtëpinë e Konsullit për të vizatuar një kapedan gegë, Abdullah Beun, i veshur aq mrekullisht në ato kostume në të kuq e me ar. I mrekulluar nga kostumet popullore shqiptare një ditë më vonë, në 6 tetor, Lear pikturoi Kaliopi Bonatin, vajzën e dytë të zv/konsullit britanik në Shkodër, z. Spiridon Bonatti,

të veshur me kostum tradicional shkodran. Familja Bonati kishte ardhur nga Korfu dhe ishte vendosur në Shkodër. Disa të dhëna interesante rreth familjes Bonati gjenden në një libër të botuar në Itali për jetën e doktor Xhenaro [Gennaro] Simini [1812-1880], *Giacinto Simini, Një atdhetar nga Leçe në Shqipërinë osmane [Un Patriota Leccese Nell'Albania Ottomana]*, nxjerrë nën kujdesin e Mirella Galletti, Parathënia e Franco Cardini, Argo 2011.

Dr. Xhenaro Semini që ka jetuar në Shkodër, në shënime të tij shkruan se origjina e Spiridon



HISTORI

Bonattit, përndryshe italian nga Venediku, “me prejardhje e ndjenja” [f. 17, 99], ishte nga Venediku. Më parë Spiridon Bonati kish shërbyer në Prevezë si konsull britanik. Ai shërbeu për një kohë të gjatë në Shkodër si zv.konsull i Britanisë së Madhe. Tetë vjet më vonë më 1856 një nga vajzat e tij, Elena Bonati u martua me Dr. Gennaro Simini [1812-1880], një mjek Italian nga Leccie që ishte vendosur në Shkodër pas vitit 1848. Ai bënte pjesë në rrethin e emigrantëve politikë që për t’i shpëtuar reaksionit burbon, ... gjetën strehim të përkohshëm në trojet arbërore... përfshirë portet e Tivarit, Durrësit, Prevezës, Vlorës, për t’u ngulur më tej në Gjirokastrë, Shkodër, Tiranë, etj. Shumica vijonin më tutje, në Ishujt Jonianë, Greqi, Dalmaci e Stamboll. Elena Bonati lindi në Shkodër dhe ishte grua e nderuar dhe respektuar nga mbarë populli. Ata lindën pesë fëmijë: Guljelmin, Angjolinën, Gjiaçintin, Atilion dhe Emilion. Vajza vdiq në moshë të re.

Nga viti 1842-1847 pranë konsullatës britanike punoi edhe Pashko Vasa si sekretar i kësaj

nënkonsullate. Gjatë punës së tij në këtë nënkonsullatë, pati rast të njihje atdhetarë italianë, të cilët Burbonët i kishin dëbuar nga Napoli. Shumica e këtyre atdhetarëve italianë pajiseshin me dokumente identiteti të lëshuara prej komisarit britanik të ishujve jonianë, ndaj si emigrantë politikë gjenin si pikë kontakti nënkonsullatën britanike në Shkodër. Këto kontakte dhe shkëmbime idesh me këta revolucionarë të përndjekur krijuan humusin ideor ku Pashko Vasa gjeti solidaritet kulturor dhe njohu idetë politike që mbizotëronin në Evropë. Është e rëndësishme të bëjmë një vlerësim të disa zhvillimeve të përgjithshme, ku përfshihet jo vetëm Ballkani, por edhe pjesa tjetër e Europës, të cilat do të ushtronin një ndikim të rëndësishëm mbi aktivitetet revolucionare ku një vend të rëndësishëm zë formulimi dhe pranimi në shkallë të gjerë të ideologjive liberale dhe kombëtare. Pas kontakteve me këto ide, Pashko Vasa e braktisi punën nënkonsullatën britanike për të vajtur në Itali që të merrte pjesë, bashkë me internacionalistë të tjerë, në çlirimin e këtij vendi nga sundimet e huaja, me qëllim që “të rrokë shpatën italiane dhe të ngadhënjejë ose të vdesë me lavdi bashkë me italianët”.

Mesa duket në këto vite ai është njohur me Katerina Bonatin (Ninën), motra e Elenës me të cilën ai u martua më vonë më 23 maj të vitit 1861, në Stamboll. Katerina Bonati ishte vejushë e një oficeri garabildian Xhovani Montezi i vrarë në ekspeditën e Garibaldit në Itali më 1 tetor 1860. Pashko Vasa kishte qenë më parë i martuar që më 1855 me një grua shqiptare për të cilën nuk ka të dhëna. Ata patën së bashku katër vajza dhe një djalë, ndër të cilët tri vajza dhe djali vdiqën në moshë të njomë, ndërsa vajza e katërt Roza, vdiq më vonë, por edhe ajo e re, në moshën 28-vjeçare. Nga martesë me Katerina Bonattin i lindi vajza Tereza Teodolina Paskalina më 1864. Katerina Bonatti vdiq e sëmurë nga tuberkulozi, në vitin 1884



I mrekulluar nga kostumet popullore shqiptare një ditë më vonë, në 6 tetor, Lear pikturoi Kaliopi Bonatin, vajzën e dytë të zv/konsullit britanik në Shkodër, z.Spiridon Bonatti, të veshur me kostum tradicional shkodran. Familja Bonati kishte ardhur nga Korfuzi dhe ishte vendosur në Shkodër



SFIDO KUFIJTË E KREATIVITETIT BËHU PROFESIONIST

DIPLOMOHU NË PROGRAMET
HAIR ARTIST | MAKE UP ARTIST | ESTETIKË
MENAXHIM | SPA-ve DHE BIZNESIT TË BUKURISË

REGJISTROHU TANI

VITI I RI AKADEMIK 2021 - 2022



TESS

TIRANA ESTHETICS
& STYLE SCHOOL
KOLEGJ PROFESIONAL I LARTË

TESS është frymëzuar nga dëshira për ta bërë estetikën dhe të bukurën pjesë të jetës së përditshme, kudo. TESS është shkolla e parë, e vërtetë, e cila krijon profesionistë me njohuri të plota në programet e estetikës, hair artist, make up dhe menaxhimit në sektorin e bukurisë.

Kolegji Profesional i Lartë TESS është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 483, datë 31.07.2019 dhe është i organizuar në dy departamente:

- Departamenti i Estetikë-Nutricionit
- Departamenti i Kozmetologjisë

Kolegji Profesional i Lartë TESS është akredituar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si një Institucion i Arsimit të Lartë, në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akredimit nr. 04, datë 24/01/2020.

Programet e Kolegjit Profesional të Lartë TESS janë të licensuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si programe studimi profesionale me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike, pas arsimit të mesëm, në përfundim të të cilave do të merrni një Diplomë Profesionale me 60 ose 120 Kredite ECTS.

Adresa : Rr. "Gjeneral Nikols" Pallati Shushica, Kati 1, Tiranë, AL

tess.albania

TiranaEstheticsStyleSchool

Zbuloni më shumë në;
www.tess.al



në Bejrut, ku Pashko Vasa është i emëruar një vit më parë, më 8 maj 1883, si Konsull i Përgjithshëm i Libanit.

Ndërkohë motra e saj, Elena Bonati vdiq më 30 shtator 1873. Sipas dorëshkrimit, humbja e kësaj gruaje të virtytshme shkaktoi pikëllimin e Shkodrës mbarë. I shoqi i saj Dr.Semini

vdiq 7 vjet më vonë në 9 prill 1880. Në funeralin e tij morën pjesë autoritetet qeveritare, konsullore, kleri, qytetarë, malësorë, të krishterë dhe myslimanë, kurse arkivoli shoqërohej nga një trupë ushtarakësh otomanë të kryesuar nga kolonel Hodo Bej. Ky ishte një nga aktivistët më të rëndësishëm të Lidhjes së Prizrenit në Shkodër. Ai ishte i biri i Mahmud beg Sokolit, në një familje me prejardhje nga viset e Sumës të vendosur në lagjen Dërgut në kohën e Pashallëkut të Shkodrës. Më 1876 u gradua kolonel i xhandarmërisë së Shkodrës, atëherë me titullin kullukçibash. Pas ndodhive të Lidhjes së Prizrenit, kur skema e lëshimit të territoreve kaloi nga Plava e Gucia në Hot, Grudë e Kelmend sipas linjës Korti, Hodo begu u zgjodh kryetar i Komitetit të degës vendore të Lidhjes, me zëvendës Preng Bibë Dodën. Komiteti nxorri kushtetimin dhe

Hodo Begu priu kund 8000 burrave për në Tuz, ku Hodo Begut i ishin bashkuar gati tërë officerët e xhandarmërisë osmane. Pas veprimeve në mbrojtjen e bajrakëve të Malësisë së Madhe, Hodo Begu u gradua pashë mirliwa (gjeneral brigade)dhe nisi të punonte për mobilizim të përgjithshëm në të gjitha viset shqiptare,për punën e tij për autonomi nuk vonoi shumë dhe më 12 dhjetor 1880 Dervish Pasha i arrestoi dhe i nisi për në Stamboll. Pas takimeve në Babu-ser-asqeri (Ministria e Luftës), burimet e kohës tregojnë se Sulltani donte t'i internonte në Erzurum, por ndërhyrja e ambasadorëve të shumtë bënë që mos të merrej ky vendim dhe të qëndronin në Stamboll. Hodo Pasha refuzoi për arsye shëndetësore emërtimin mytesarif i Damaskut. Sipas Bushatit e internuan në Erzinxhan, ku disa burime thonë se nga dëshpërimi u hodh nga pallati apo kështjella, burime të tjera kumtojnë se ndërroi jetë nga kolera, ose u ekzekutua më 1883. Në krye të kortezhitishte banda muz-



BIBLIOGRAFI:

- 1- Agron Alibali. NJË INCIDENT DIPLOMATIK NË SHKODËR – MARS 1865. www.peizazhe.com. dt. 13 Korrik 2021
- 2- Andre Hammond, The uses of Balkanism: Representation and Power in British Travel Writing, 1850-1914, The Slavonic and East European Review, Vol.82, No.3 (Jul.,2004).
- 3- Afrim Q. Karagiozi, Eduard Liri, Botimet Enciklopedike, Tiranë, 1997
- 4- Barbara Jelavich, The British Traveller in the Balkans: the Abuses of Ottoman Administration in the Slavonic Provinces, The Slavonic and East Review, Vol.33, No. 81 (June.,1955)
- 5- Kristo Frashëri, Historia e Qytetërimit Shqiptar, Akademia e Shkencave: Tiranë, 2008.
- 6- Ymer Jaka. Bioibliografi. Pashko Vasa. Vepra I. Botimet Toena, Tiranë, 2009, fq 55-56.

ikore e qytetit dhe arqipeshkvi tetëdhjetëvjeçar. Kallja e trupit në dhë e Dr.Seminit u shoqëria me breshëri të shtënash. [ff. 105-106].

Afërsia familjare e Dr. Seminit me Pashko Vasën mund të ketë ndikuar në aktivizimin e tij politik në çështjen shqiptare në vitet e Lidhjes së Prizrenit.

Pashko Vasa në shkurt 1878 u emërua si këshilltar i valiut të Kosovës, Qamil Pashës. Pashko Vasa arriti në Kosovë në pranverë 1878. Ai ishte një nga organizatorët e Lidhjes së Prizrenit. Pandehe se është autor i memorandumëve të muajit mars të këtij viti drejtuar A.H Layard, ambasador i Britanisë së Madhe, pranë Portës së Lartë, dhe të memorandumit të datës 20 qershor, drejtuar përfaqësuesve të



olucionare të Dr.Seminit gjetën një ambjent pjellor në përpjekjet e shqiptarëve për të afirmuar kombësinë e tyre dhe betejave për të mbrojtur Plavën, Gucinë, Hotin dhe Grudën. Dr. Semini, sipas dorëshkrimit, u lidh aq shumë pas vendit që i shpëtoi jetën aq sa e mbështeti “gjithmonë” pavarësinë e

Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Madje, pas pavarësisë së Italisë, Simini nuk pranoi ofertat për poste qeveritare – sikurse përmendëm – ndërkohë që miku i tij, avokati Del Donno, u kthye në Itali dhe madje u zgjodh edhe deputet. Aq shumë u njësua Simini me atdheun e ri sa u përfshi edhe në lëvizjen kombëtare shqiptare pas Kongresit të Berlinit me 13 korrik 1878. Sipas dorëshkrimit, “Gennaro Simini ishte një ndër krerët e lëvizjes së Lidhjes së Prizrenit dhe punoi që Kongresi i Berlinit të njihte pavarësinë e Shqipërisë nga qeveria turke” [f. 104].

Ky pohim është paksa i egzageruar pasi në dokumentacionin e degës së Lidhjes së Prizrenit për Shkodrën nuk gjendet një e dhënë e tillë, por ai duhet marrë në formën e pohimeve romantike që karakterizojnë kujtimet dhe shënimet e shekullit të XIX përsa i përket idealeve të lirisë kombëtare të popujve. Shkodra si një nga qendrat më të mëdha administrative të popullsisë shqiptare në shekullin e XIX ishte kthyer dhe një qytet kozmopolit ku kishin gjetur strehë pikëpamjet e nacionalizmit romantik, shtetformimit, rilindjes italiane e revolucionit të vitit 1848.

Skicimi i galerisë së personazheve historikë shqiptarë që ndërvepruan me botën evropiane është i vështirë pasi duhen gjurmuar tekste dhe autorë të shekullit të XIX, ndonjëherë dhe në dorëshkrime. Gjithësesi tekste të tilla si të Lear apo Dr.Seminit na lejojnë që të kemi mundësinë për të hedhur dritë mbi disa nga këta personazhe të rëndësishëm që mbizotëruan në jetën publike të Shkodrës si familja Bonati, Pashko Vasa, Dr.Semini, Hodo Sokoli. Ndërveprimet e tyre shoqërore shpesh herë ndikuan dhe në farkëtimin e identitetit shqiptar që vinte si në të gjitha rastet në Evropën Lindore si një shumësi e identiteteve të ndryshëm kulturorë.

HODO BEJ

Ky ishte një nga aktivistët më të rëndësishëm të Lidhjes së Prizrenit në Shkodër. Ai ishte i biri i Mahmud beg Sokolit, në një familje me prejardhje nga viset e Sumës të vendosur në lagjen Dërgut në kohën e Pashallëkut të Shkodrës

Gjermanisë, Austro-Hungarisë dhe Francës në Kongresin e Berlinit për çështjen shqiptare. Në memorandumin e fundit, midis nënshkrimeve të tjera, gjendet dhe ai i Pashko Vasës. Si dihet Pashko Vasa është një nga formuluesit kryesorë të shqiptarizmit ideologjisë nacionaliste që kërkonte në fushën politike, të çlironte atdheun nga robëria e huaj shekullore dhe të formonte shtetin kombëtar shqiptar, të shtrirë në mbarë trojet shqiptare; në fushën shoqërore, të çlironte vendin nga marrëdhëniet e vjetëruara feudale dhe ta shkëpuste nga prapambetja politike, ekonomike dhe shoqërore duke vendosur rendin demokratik përparimtar, nën shembullin e vendeve të qytetëruara të kohës; në fushën kulturore, të çlironte masat nga prapambetja mendore dhe të shpejtonte zhvillimin e tyre arsimor, kulturor dhe shkencor me bazë gjuhën shqipe. Si e tillë ajo do ishte një lëvizje revolucionare kombëtare me karakter çlirimtar, demokratik dhe iluminist. Idealet e vjetra rev-



HISTORIA

E

GRUAS

SHQIPTARE

Gruaja shqiptare si pronare skllëvërisht në antikitet, në skllave e kanunit të Lek Dukagjinit! Në fillim të shekullit të XX doli dekreti për heqjen e perçeve, më vonë kërkoi të punësohej në shtet. Çfarë shkruan shtypi i kohës për vajzat e para të teatrove. Martesa përrallore në Durrës e vajzës së deputetit. Nga skenat e teatrove drejt luftës e më vonë, për herë të parë me votë në zgjedhjet e 1945 – një rrugëtim me emancipimin e grave shqiptare

NGA PERÇJA TE TEATRI, NGA MALET TEK VOTA

| Nga **ERGYS ALUSHI**

VLORE

Historia e Shqipërisë është e lidhur ngushtë me historinë e rolit të femrës shqiptare. Uljet e ngritjet e saj, hijet e shkëlqimet, shtypjen e mohimit të të drejtave, me pjesëmarrjen në luftë e në kuvende burrash e të tjera ngjarje.

Në kohë e epoka të ndryshme, shumë gra shqiptare kanë thyer Tabu edhe pse në kushtet e një varfërie paditurie të tejskajshme. Duke filluar nga Mbretëresha Teuta, Donika Kastrioti, Bubulina, Elena Gjika, motrat Qiriazi, Marigo Posion, Shote Galicën, Musine Kokalarin, Tefta Tashko Koçon e artiste të ndryshme amatore që u ngjitën për herë të parë në skenat teatrale të vendit, për të ardhur tek ato qindra femra partizane që luftuan maleve për lirinë e Atdheut gjatë LIIB. Roli i gruas në shoqërinë shqiptare ka ndryshuar ndër vite e dekada, ndikuar kjo nga faktorët historikë dhe ekonomikë në të cilat ka kaluar Shqipëria.

Shpallja e Pavarësisë e gjeti vendin në një prapambetje të madhe





në të gjitha fushat e jetës, përfshi këtu edhe gjendjen e gruas që konsiderohej si një qenie e dorës së dytë. Në pjesën më të madhe të vendit gruaja nuk kishte të drejtë as të zgjidhte e as të vendoste, duke filluar që nga vendimarrja në mbarëvajtjen e familjes apo dhe të zgjedhjes së burrit. Ajo shfrytëzohej për punët e shtëpisë, punët në ara dhe të tjera punë të vështira, duke i detyruar edhe vetë burra më të emancipuar që të shkruajnë vargjet:

*"Burrrat nën hije,
luajnë kuvendojnë,
pika që s'u bie,
se nga gratë rrojnë".*

Ajo nuk kishte të drejtë të shkonte në shkollë dhe në të tilla kushte ishte analfabete, me nivel të ulët arsimor, duke ndikuar kjo dhe në rritjen jo të mirë të femijëve.

FILLESAT E NJOHURA TË VENDIMARRJES

Në Butrint, mes mbishkrimeve të gjetura nga Ugolini, dy aktet e plota të lirimit të skllavëve flasin për vendimin e marrë nga një grua: në një rast Teimagora, bija e Nikolaosit; në rastin tjetër, Lisoja, liron katër skllavër nga të cilët të paktën tre janë gra. Në një tjetër mbishkrim gjenden 18 raste lirimi po nga një grua, në të cilat lirohen 40 skllavër. Janë shembuj që tregojnë se gruaje epirote në shekullin VI-I p.e.s. ka të drejtën e pronës dhe mundësinë t'a tjetërsojë atë. Gruaja epirote liron dhe po ashtu mund të shesë apo të blejë pa ndërhyrjen e ndonjë tutori. Shumë qartë flet për këtë një mbishkrim i Dodonës "Matidika i ribleu Damoksenën Poliksenosit për një kalem argjendi". Një grua që i blen një gruaje tjetër skllavin e saj, pa asnjë

ndërmjetës midis tyre. Foinikeja, qyteti më i madh i Koanisë, n'a ka dhënë një akt lirimi me shumë interes pasi përmend tri gra, Mnasareta, Pamfila e Ksenotina. Ato janë thirrur për të dëshmuar në një gjyq po ashtu si edhe burrat, me të drejta të barabarta. 224 nga 257 vendimet e lirimit bashkarisht që ndodhen në murin perëndimor të teatrit të Butrintit janë bërë nga grupe që përfshijnë të paktën një grua, gjë që do të thotë se në afro 90% të rasteve gratë janë të pranishme midis pronarëve lirues.

Rezultoni se nga 278 emra pronarësh skllavërisht, vetëm 94 janë emra grash që do të thotë rreth 33%.

PIESË NGA KANUNI I LEKË DUKAGJINIT

Nyje njimbëdhjetët - M'u martue me kanun do'me thanë m'u ba ship, me i a shtue shpis një rob ma tepër, sa për krah të punve, sa për të shtuem të fmive.

Nyje gjashtëmbëdhjetët - Nuse pa shkuesi s'bahet.

Nyje e njëzetetët - Me rrahë burri gruen, nuk bjen në faj kah kanuja, e as prindja s'mund t'a kërkojnë të rrahmen.

Nyje njizetenandët - Grueja njifet si çalike për me bajtë sa të jetë në derë të burrit, se prindja e s'hjeken dorë prej sojet, e ndalin për vedi e mbi vedi përgjigjemen për të, por edhe me lypë arsye, me ba me e gjetë gja.

Nyje e tridhjetëtretë - Burri ka tager me; a) me kshillue e me qortue gruen; b) me rrahë e me lidhë gruen e vet, kur të mbërrijë me ia përbuzë fjalën e urdhnin.

Nyje e tridhjetegjashtë - Kanuja njef për trashigues djaln e jo vajzën.

Karikaturë në gazetën Dielli. Viti 1929





www.newsbomb.al

Ndryshe ndodhi në Shqipërinë e sunduar prej shekujsh nga i njëjti mentalitet moral e fetar në raport me dalejn e gruas shqiptare në skenë. Vërtet, që shumë pak femra shqiptare guxuan të ngjiteshin në skena teatrale, por, në përgjithësi, ato u mirëpritën dhe ngjarje të tilla të rralla për kohën, kaluan pa incidente.

DY FEMRAT E PARA INTELKTUALE SHQIPTARE

“... Vetëm nga fundi i Rilindjes u dukën emrat e dy intelektualeve të para në jetën shqiptare. Këto janë motrat Qiriaz, Sevasti dhe Parashqevi, që ngritën shkollat shqipe, hartuan tekste shkollore, nxorën revistën “Ylli Mëngjesit” në SHBA. Prej tyre do kemi vargjet e para, siç qe himni i Kongresit të Manastirit... Ishin këto sprova premtuese, shkrime me nota didaktike e frymë patriotike, që i shërbyen shkollës shqipe në hapat e para. Siç do jetë dhe nisja e shkrimeve të vargjeve të para... Të thjeshta si krijime. Nga ana tjetër, kjo punë ndjehet në qytete me zhvillim ekonomik, si Korça, Shkodra, Elbasani, Gjirokastra, Vlora. Por kjo veprimtari bëhej në fshehtësi, jo vetëm nga fanatizmi e analfabetizmi, por mbi të gjitha nga prapambetja sociale”. Kështu shkruan Nasho Jorgaqi pas studimit për gruan shqiptare në gazetën e botuar pas viteve ‘90 “Tirana Observer”.

Në vitin 1919, Parashqevi Qiriaz mori pjesë në Konferencën e Paqes në Paris si përfaqësuese e delegacionit shqiptaro-amerikan dhe ishte e vetmja delegatë femër nga të gjitha vendet pjesëmarrëse.

“Në folklor, spikat adhurimi i bukurisë fizike, ashtu dhe i virtyeteve morale. E Bukura e dhëut, Tanusha, Motra, Zana, Rozafa. Edhe në letërsinë e lashtë të kultivuar me tematikë fetare, ka patur figura të bukura vajzash të shenjtëruara si, Sibilat, vajet e Shën Mërisë, etj, por dhe figura të shekullarizuara e emancipuara si, Zelihaja, Erveheja etj, ose Vojsava, Donika, që u aktivizuan e u ripërtërinë dhe në letërsinë shqipe, deri në vitet ‘30-të. Po kështu, në fillimet e letërsisë romantike, janë krijuar sërish figura të bukura mbresëlënëse vajzash si, Rina, Mara, Bardha e Temalit, Afërdita, Zoga etj. Në periudhën e Pavarësisë zuri vend figura e gruas në poezi dhe në prozë. Spikasin për bukurinë magjepsëse Vashat Lasgushiane, por dhe femrat në kushtet e një pabarazie sociale midis burrit dhe gruas në romanet, “Sikur të isha djalë” të H. Stërmillit, “Pse” të S. Spasses etj. Por Migjeni futi në temën e femrës ide dhe tema të reja”. (Alfred Uçi, Viti 2013)

Zgjedhjet e para parlamentare në Shqipëri në vitin 1921 hapin perspektiva të reja për

VITET 20-TË, SI GJENDET GRUAJA NË SHOQËRI

Vitet 20-të sollën një farë përmirësimi të rolit të gruas. Në Vlorë filloi botimin e para revistë për gra e vajza me emrin “Shpresa kombëtare”, me drejtore Marigo Posio. Gjithçka ndodhi nga 6 shkurti 1921. Gazeta ishte organ i shoqërisë me të njëjtin emër, dhe trajtonte tema si duhet të sillej gruaja në punët e shtëpisë, në në familje, në marrëdhënie me burrin, fëmijët e të tjera.

U hapën disa shkolla për femra si “Qiriaz” (1922), shkolla femërore në Korçë, instituti femëror ‘Nëna Mbretëreshë’, pa harruar edhe të parën shkollë fillore femërore të hapur në Gjirokastrë në vitin 1919 nga Urani Rumbo.

Deri në fund të viteve ‘20-të, gruaja ishte e ngjuar ngado, e shtypur nga mentaliteti patriarkal dhe konsiderohej thjesht dhe vetëm një riprodhuese djemsh, që duheshin për pushkë e për vazhdim të traditës burrërore shqiptare.

Një grua shqiptare ishte deri e mallkuar nëse do të sillte në jetë një vajzë dhe jo një djalë.

Në vitet 30-të gjendja e gruas në shoqërinë shqiptare ishte shumë e vështirë. Ajo gëzonte shumë pak të drejta, kryesisht në pak qendra qytetesh të mëdha për kohën, ndërsa në zonat e thella, nuk bëhej fjalë për të drejta. Shtypja shoqërore, morale e fetare ishte e madhe.

Paralelisht, e njëjta situatë paraqitej edhe në Turqi. Më 3 prill 1930, për herë të parë femrës turke iu dha e drejta për të votuar. Në këtë periudhë do të krijohet edhe akademia moderne e artit dramatik në Ankara. Aty, gruaja e parë muhamedane, me emrin Afife, kur doli për të parën herë në skenë, u sulmua prej publikut, u qëllua me revolver për imoralitet fetar dhe për çnderimet që i ka bërë gruas muhamedane.



Marigo Posio



Parashqevi Qiriaz

Gazeta Shpresa Kombëtare. Organ i femrave të Shoqërisë Shpresa Kombëtare

ndryshimin e gjendjes së rolit të gruas në shoqërinë shqiptare. Në numrin e 28 tetorit 1923, gazeta "Shqipëri e Re", në faqen e saj të parë shkruan ndër të tjera se: *"Jeta shoqërore sa po vete, po mirësohet dhe gruaja po fillon të mëkamet e të fitojë disa të drejta q'i ishin mohuar në kohën e tiranisë Turke"*.

NDALOHET POLIGAMIA

Në prill të vitit 1925, Kongresi i xhamive shqiptare shpalli Autoqefalinë e Xhamive. Bashkë me këtë vendim të rëndësishëm, Kongresi ndaloi rreptësisht poligaminë dhe vendosi që gratë shqiptare muhamedane, të dalin pa u mbuluar në fytyrë. Shtypi evropian i kohës i kushtoi rëndësi vendimeve të tilla, veçanërisht atë të ndalimit të poligamisë, gjë e cila sipas gazetave tregonte përparimdashjen, nderin e moralin e lartë të popullit. Gruaja shqiptare muhamedane, rënkonte nën sundimin e ideo dhe mentaliteteve të sjella nga Azia, të cilat nuk pajtoheshin me zakonet e shqiptarëve përpara pushtimit osman, në sjellje me femrën. Poligamia dhe haremi, këto dy turpe të njerëzimit, të shpikura prej burrave barbarë bënë që gruaja-njeri të kthehet në grua-lodër për të plotësuar dëshirat e shfrenuara të burrave. Me vendimet e marra dhe me vendimet që do të pasojnë në të ardhmen, synohej që gruaja të mos ishte më lodra e burrit, por shoku i tij, bashkëshortja dhe nëna e fëmijëve të tij, në të mirë e në të keq.

IKBALE ÇIKA - GAZETARJA E PARË SHQIPTARE

Një nga gratë e spikatura të viteve 20-të e në vazhdim ishte Ikbale Çika. Ajo u kthye në shembull e simbol për gratë e kohës. Ishte kryeredaktorja e parë e gazetës "Arbëria" dhe më pas punoi në arsim si mësuese. Ishte pjesë e revistës "Gruaja shqiptare", "Ylli i mëngjesit" e "Java". I kushtoi një rëndësi të madhe problemit të gruas në shoqëri, duke i nxitur ato të merreshin me sport dhe art. Te revista "Shqiptarja" vihet re një lajm që bën të ditur se këto zonja kishin organizuar disa gara noti, por ato kishin guxuar të organizonin në Korçë "një garë të madhe të automobilave". "Shqiptarja" ishte një revistë tjetër e përjavshme, organi i shoqërisë "Gruaja Shqiptare", ku Emine Toptani ishte nënkryetare e shoqatës dhe Parashqevi Qirjazi, sekretare. Pasi kishin bërë një udhëtim të gjatë nëpër të gjitha qytetet e Shqipërisë për të biseduar dhe propaganduar daljen nga errësira të gruas shqiptare, ishin plot optimizëm për fillimin

shqiptare", ku Emine Toptani ishte nënkryetare e shoqatës dhe Parashqevi Qirjazi, sekretare. Pasi kishin bërë një udhëtim të gjatë nëpër të gjitha qytetet e Shqipërisë për të biseduar dhe propaganduar daljen nga errësira të gruas shqiptare, ishin plot optimizëm për fillimin



Ikbale Çika



e mbarë të njëres prej punëve të shumta që kishin. Bashkë me bashkëshortin Nebil Çikën dhanë një kontribut shumë të çmuar në zhdukjen e analfabetizmit.

NJË GRUA KËRKON TË PUNËSOHET NË SHTET!

"Zonja Qemal Luli, e shoqja e drejtorit të postë-telegrafeve i ka paraqitur Drejtorisë së Përgjithshme të postë-telegrafeve lutje dhe ka kërkuar t'emërohet në një nënpunësi që gjendet vakante n"Elbasan."

Ky nuk ishte një lajm i zakonit në shtypin e vitit 1929. Eshtë botuar në faqet e "Gazeta e Re" në 24 prill të atij viti, e vendosur në ballinën e faqes së parë me titullin: "Një grua shqiptare kërkon nëpunësi Shteti". Artikulli nis me konstatimin se *"Shumë pakë janë mjerisht ato gra shqiptare që hidhen në jetë jashtë shtëpisë së tyre për të lehtësuar barrën e familjes duke shtuar t'ardhurat e saja"*. Kërkesa e gruas nga Elbasani ishte marrë në konsideratë nga Drejtoria e Përgjithshme e postë-telegrafeve dhe gruaja kishte filluar nga puna. Deri në atë kohë, edhe ato gra që punonin në shtet, punonin vetëm në arsim.

E PARA MARTESË CIVILE MADHËSHTORE NË DURRËS

Të dielën e datës 9 qershor 1929, në Durrës, u zhvillua martesa e parë sipas Kodit të ri Civil. Vasilika Goxhomani, e bija e ish-deputetit të Beratit, Llambi Goxhomani vuri kurorë me zotin Vangel Mima. Bashkia e Durrësit i dha rëndësi të madhe kësaj ceremonie. Thuajse gjithë populli i qytetit, pak nga kurioziteti i kësaj forme të re që hynte në zakonet e Shqipërisë dhe pak nga njoftimi për ceremoninë nga ana e bashkisë, ishte mbledhur në rrugët e qytetit deri te porta e bashkisë, nëpër shkallë e deri në dhomën ku do të kryhej ceremonia. Sapo u afrua vargu i makinave që shoqëronin nusen, dhëndërrin e krushqit, banda e Bashkisë filloi të luajë muzikë të gëzueshme.

"Midis një heshtjeje të thellë, Zv.Kryetari Bashkisë Z.Omer Strazimiri përmbush formalitetet ligjore dhe, pasi pyet me zë të lartë vullnetin e të dy palëve dhe nënshkruen regjistrat, zotëria e tij e deklaroi të bashkuar sipas ligjës dhe u uron fatbardhësi" ("Gazeta e Re", 11 qershor 1929).

HAPET PARFUMERI MODERNE NË TIRANË

Hapja e një parfumerie moderne, ishte një ngjarje e madhe për Tiranën e qershorit të vitit 1929. Kryeqyteti i vendit po rritej dita-ditës dhe gati 5 vjet pas emërimit si kryeqytet, zhvillimi dhe përparimi kishte nisur të jepte shenjat e para të modernizimit. Të ftuarit në ceremoninë e inaugurimit ishin pjesa më e madhe e parisë së Tiranës, pjesë e së cilës ishte edhe pronari i parfumerisë, Rexhep Berberi. Të gjithë artikujt ishin sjellë nga Parisi e Berlini, duke shënuar një hap cilësor në shërbimin e këtij lloji që ishte i rallë për vendin.

LARJA E PETKAVE NË MËNYRË SHKENCORE

Në korrik të vitit 1929 "Gazeta e Re" njoftonte se në Tiranë do të fillonte nga puna një dyqan për larjen dhe hekurosjen e petkave. Shoqëria me emrin "Pastrimi" ishte në gjendje të lante e hekuroste rreth 600 kg petka (veshje) dhe t'i shpërndante me kamionat e saj tek klientët. Shoqëria kishte ngritur në mjediset e saj edhe një sallon banje me kushte moderne duke u bërë konkurrencë qyteteve të Perëndimit. Veprimtaria e shoqërisë u konsiderua një ndihmesë e madhe për gratë e kryeqytetit që kishin mundësi financiare për t'i larë e hekorosur veshjet e tyre me lekë.

PËR HERË TË PARË NJË FEMËR NË SKENË

Shoqëria e artistit "Devolli", e krijuar në vitin 1927, ishte e para që nxorri një grua në skenë, me shfaqjen e madhe të 8 tetorit 1930 dhe në shfaqjet e vitit 1931.

"Nji tjetër e metë e cfaqjes së parëmbamëshme ishte edhe interpretimi i roleve femnore nga ana e meshkujve: derisa mos të plotësohet këjo e metë theatri i ynë gjithmon do të lajë të dishrojë, me gjithse amatori që përfytyronte Dadën, u mundue e deri diku pati sukses". Kështu shkruhej ndër të tjera në gazetën "Besa" të tetorit 1930, pas shfaqjes së dramës "Gjylmihali" nga grupi filodramatik i Tiranës.

Gazeta tërhoqte vëmendjen se në ndryshim nga grupi amator i Tiranës, ku nuk kishte aktore femra, grupi artistik "Devolli" i Bilishtit, në shfaqjen që do të jepte pas disa ditësh në Tiranë, kishte dy aktore femra në përbërje të tij. Që nga viti 1908 kur u proklamua konstitucioni turk, deri më 1912 kur u shpall pavarësia e vendit, katër vjet me radhë klubet dhe shkollat me karakter kombëtar, herë pas here, duke përdorur artistë amatorë, organizuan shfaqje teatrale në gjuhën amëtare për të zhvilluar dhe lartësuar ndjenjat kombëtare. Të tilla shfaqje vazhdojnë edhe pas më shumë se dy dekadash.

Bashkë me anët pozitive që përcillnin të tilla shfaqje, një nga problemet më të mëdha mbetej mungesa e aktoreve femra në to.

"Gruaja shqiptare, e trëmbur prej kritikës që do t'i bëhet prej gjith atyre

që ushqejnë një farë mentaliteti të gabuar për theatrin nuk ka marrë dot kurajin të dali në skenë. Aktorët t'anë amatorë, prej mungesës së artisteve, detyrohen të luajnë rolin e gruas, por edhe ata vet e dinë që, s'ka gjë në botë më të shëmtuar nga një rol i gruas i kryer prej burrit. Është e pamundur të iki njeriu me një impression të mirë prej një cfaqje teatrale, kur sheh një burrë të veshur si grua, dekolte dhe rroba të shkurtëra, me zë të trashë dhe me zheste burrnore të luajë rolin e një zonjushëje. Duhet njeriu të jetë krejt i shpëlarë prej gjithë ndjenjave delikate që të shikojë të këtilla sqena kundra natyrës" (Gazeta "Besa", dhjetor 1932)

Vendimi i Qeverisë për pranimin e grave në detyra zyrtare, u bë shkak për debate në shtypin dhe shoqërinë shqiptare të kohës.

Po cila ishte gjendja shoqërore e femrës shqiptare në fundin e vitit 1935 kur nisi të debatohet për rolin e saj në shoqëri e aq më tepër në kryerjen e detyrave zyrtare? Ja si e përshkruante situatën në të cilën ndodhej gruaja shqiptare një nga gazetatat e kohës, "Besa", në numrin e saj të 2 nëntorit 1935:

"Gruaja shqiptare, sidomos ndër katunde dhe në malësi, është shtylla e vatrës familjare. Kurse burri e shkon kohën në kafene duke pirë e duke luajtur bixhoz, gruaja punon arën, përgatit ushqimin e dimërit, sjell drutë e zjarrit, shet, ditën e tregut, në qytet pula e vezë për të blerë krypë".

Por, ndërsa e pasqyrore me këto rreshta gjendjen e femrës në vend, gazeta "Besa", vazhdonte duke shkruar se: *"Kur themi që gruaja ka të drejtë të emërohet nëpunëse dhe të marri pjesë në të gjitha konkurset që çelen për të tilla nëpunësira, natyrisht, flasim për gratë e qyteteve, për ato që kanë një kulturë të zhvilluar. Por në një vënd si ky i yni ku djem me kulturë të naltë dhe me diploma universiteti gjënden pa punë, nuk besojmë që t'i vijë radha gruas veç se në dëshirojmë që të bëjmë një reklamë".*

Ndërkohë, Ministria e Punëve të Brendshme në një qarkore drejtuar të gjitha Prefe-





kturave i urdhëron që të angazhohen më shumë për “Çdukjen e disa zakoneve t’ona të këqia”. Ndër zakonet e këqija cilësohej sjellja e burrave në malësi dhe krahina të tjera të vendit të cilët, kur udhëtojnë bashkë me gratë, “Burrrat shkojnë kaluar e gratë në këmbë”. Në shumicën e rasteve, jo vetëm që burri qëndronte mbi kalë dhe gruaja ecte në këmbë, por, shumë herë, gruaja ngarkohej si kalë dhe shkonte përpara burrit të saj, i cili, kaluar, pi duhan pa u menduar aspak që bashkëshortja e tij ka zbritur në rolin e kafshës. Dhe kur arrinin në shtëpi, gruaja me nxitim përgatit ujin e nxehtë për t’i larë këmbët burrit, i cili, i ulur në oxhak pi rakinë që e ka blerë në qytet. Në terrenin shqiptar vepronin shumë “zakone të këqija”, të cilat vepronin aty prej shekujsh duke u trashëguar breza pas brezi. Ato kishin formësuar shoqërinë shqiptare dhe ishte e vështirë që kjo shoqëri të ndahej prej tyre thjesht dhe vetëm nëpërmjet një qarkoreje të Ministrisë.

“Prandaj nuk kemi shumë shpresa për efektin e asaj qarkoreje që përmendëm më lart, por kjo nuk do me thënë që Qeveria, shkolla, intelektualët edhe shtypi të heshte dhe t’i bëjë sehir, me një apathy, ato zakone të këqia dhe të shëmtuara që nuk pajtohem me qytetërimin e sotmë edhe që na diskretitojnë në botën e huaj” – ishte një ndër dyshimet që shpreheshin në shtypin e kohës.

AKTORET FEMRA TË VITEVE ‘30

Në nëntor të vitit 1933 filloi të funksionojë një shkollë dramatike, e cila do të përgatiste aktorë. Midis të përzgjedhurve për të ndjekur këtë shkollë, kishte edhe vajza. Hapja e shkollës synonte që pas tre vitesh të përgatitjes së aktorëve, të hapte dhe një teatër kombëtar ku të jepej dhe shfaqja e parë, pikërisht me aktorët e shkollës dramatike. Por ashtu si çdo gjë e re që kishte nisur të lulëzonte në Shqipëri edhe një vendim i tillë shkaktoi debate të shumta. Pyetjet që bëheshin në opinionin publik ishin të shumta:

A ndjen populli nevojën e dramës?

A nuk kemi problemere më jetësore për të zgjidhur?

A nuk kemi nevojë të sigurojmë pikësëpari bukën?

A nuk duhet të çelim shkolla fillore në të gjithë vendin për të zhdukur analfabetizmin?

A duhet që një femër të ndjek shkollën për aktore?

Shqipëria ishte në kushtet kur për shkak të mungesës së fondeve, ministria e Arsimit nuk mund të dërgonte mësues në shumë zona të vendit, duke lënë pa shkollë me qindra e qindra fëmijë.

“Më në funt, pas shumë përpjekjesh dhe britmash të pareshtura dhe me plot të drejtë që kanë bërë fletoret dhe revistat t’ona për daljen e seksit të dobët në skenën e theatrit, një vajzë punëtore serioze dhe e nderçme prej këtij qyteti, mori kuximin dhe me plot kurajo dhe fuqi, këputi zinxhirat e fanatizmit dhe zakonet primitive të trashëguar prej kush e di sa vjetësh. Këtë e bëri me rastin e çfaqjes teatraleë që dha Shoqëria “Puna” për përvejtoren e saj më 6 gusht 1936 dhe kjo shoqëri ka të drejtë të mburret dhe të jetë kryelartë që pati fatin të nxjerë për të parën herë vajzë në skenë”.

Kështu fillonte artikulli me titullin “Vajza në skenë”, në gazetën “Arbënia” e datës 9 gusht 1936 në rubrikën “Arbënia në krahina”. Në Korçë ishte dhënë një shfaqje teatraleë edhe për herë të parë në skenë kishte luajtur një vajzë.

“Zonjusha Theodhora Sheri është për t’u lëvdur dhe admiruar prej kujtdo për kuximin që pati dhe mbësajmë se edhe shumë vajza të tjera si kjo, do të vazhdojnë të ndjekin këtë zhest kaq të bukur sa ishte turp për Korçën të zëvendësonte rolin e femrës me djem imitonjës të saj. E dimë se vajzat korçare pothuaj përgjithësisht kanë dëshirë të zjarrtë për këtë art kaq të bukur, për theatrin që qihet edhe Shkollë për popullin, por siç thamë nuk i linte zinxhiri i fanatizmit”.

Disa orë përpara fillimit të shfaqjes, në teatrin “Majestik” pati një interesim të jashtëzakonshëm të popullit për të parë shfaqjen. Salla ishte mbushur plot me të rinj, dhe shumë njerëz mbetën jashtë pa u mundur të gjejnë bileta.

Në komedinë e parë nuk pati edhe aq entuziazëm, sepse të gjithë ishin në pritje të komedisë së dytë, ku luante edhe aktorja femër.

Në komedinë “E mbesa e krahinarit” të Kristo Floqit, vajza luante rolin e Bajames. “Po presin me padurim dhe heshtja mbretëron në sallë: ja dhe Bajamja hyri në skenë kur përnjherësh britma dhe duartrokite të parreshtura mbuluan lokalit dhe “bravo-t” dëgjo-



heshin nga çdo anë. Kishin të drejtë të bërtisnin dhe të bënin gjith atë potere mbasi nga gëzimi i math që ndjenë s'kishin se si t'a falënderonin ndryshe atë zonjushë që fitoj simpatinë e të gjithëve. Në fillim u duk e turbulluar nga ato që shihte dhe dëgjonte bëheshin para saj, ndofta dhe u mallëngjye, por më pas e zotëroj vëhten dhe i dha fund rolit për mrekulli". Aktorja që performonte ishte Thimika Thimo, e bija e mësuesit patriot Gjini Thimi Naumi, i cili dha shembullin e parë për të lejuar vajzën të ngjitej në skenë. Ajo interpretoi gjallërisht dhe u duartrokoi për zemërisht. Në 6 shkurt 1937, dega teatrale e shoqërisë "Rinia korçare" shfaqti dramën "Armiku i popullit", të shkrimtarit norvegjez Henrik Ibsen. Në shfaqjen me regji të Sokrat Milos, luajnë 11 aktorë, midis të cilëve edhe dy aktore vajza. "Këto vajza meritojnë të përgëzohen për kuximin që kanë për të dalë në skenë" (Gazeta "Drita", janar 1937)

KOMUNITETI MUSLIMAN VENDIME TË RËNDËSISHME PËR GRATË MUHAMEDANE

Të gjitha dispozitat e shenjta kanë predikuar që pamja e fytyrës dhe e duarve të një gruaje pa qëllim të lig nuk është e ndaluar dhe nuk është harram. Atëherë, kur nuk ka dispozita ndaluese, si shpjegohet vallë fakti që në disa vise të vendit shihen edhe gra me fytyrë të mbuluar?

Kjo ishte pyetja që filloi të shtrohej në shtypin e kohës, vitit 1937, kur Komiteti Musliman shqiptar vendosi për zbulimin e fytyrës së grave.

Përgjigja e pyetjes gjendej tek një e shkruar shumë e largët historike, kur gruaje nuk ishte e sigurt për shkak të turbullirave dhe anomalive të shumta. Në këto kushte, disa juristë të botës muslimane e panë të nevojshme të merren masa mbrojtëse dhe kështu vendosën për mbulesën e gruas.

"Po, ma von, të tjerë juristë, duke u detyruar prej anomalive t'atyre kohëve, u-shtrënguan të vendosin dispozita më ndaluese, të cilat pa asnjë arësye, në disa vende të Mbretërisë s'onë, janë edhe sot në fuqi, kurse në shumë krahina të tjera, dhe sidomos në malësina, kanë vazhduar dispozitat e urdhënueme prej të Madhit Profetit t'onë, që përmëndëm më lartë: dhe për fat të bardhë nuk janë shkakëtuat që të ngjasin gjëra të pa-pëlqyeshme. Karakteri i lartë dhe burrnor i Kombit shqiptar

Statuja Vasha e Vlorës tregon veshjen e gruas ilire

nuk ka lejuar kurrë që të ndodhin t'atilla ngjarje të shëmtuara që i kishin drejtuar juristat e përmendur të merrnin masa më ndaluëse".

DEKRETI I EMANCIPIMIT: GRATË TË ZBULOJNË FYTYRËN (10 MARS 1937)

Zhvillimi dhe përparimi i vendit nuk mund të arrihej pa kontributin e gruas. Ishte një padrejtësi flagrante që gruaje të mbahej e mbyllur dhe e kufizuar mes katër mureve të shtëpisë. Për të përmbushur misionin e saj të lartë në raport me familjen e shoqërinë, gruaje shqiptare nuk duhet të ishte e mbuluar prej errësirës së perçes dhe të injorancës. Gruaja duhej nxjerrë në ditën e arsimit, të shoqërisë e të lirive të tjera të barabarta me burrin.

Ligji për zbulimin e fytyrës së gruas u shoqërua me një sërë masash të tjera, siç ishin çelja e kurseve të analfabetizmit dhe kurset për punimet e dorës. Ligji i votuar në Parlament dënonte të gjitha gratë që mbulonin fytyrën, por edhe ata që inkurajonin këtë veprim. Madje gjobot shkonin deri në 500 franga ari. Qeveria kishte kërkuar të hiqeshin ferehetet qysh shumë vite më parë, por nuk kishte patur sukses, ndaj edhe votoi ligjin me ndëshkimet përkatëse.



Motrat e mbretit Zog gjatë vizitës në Shkodër. Mars 1937

TRI MOTRAT E ZOGUT, AKTIVISTE TË ZBATIMIT TË LIGJIT!

Ndër vizitat e ndryshme që motrat e mbretit Zog zhvillonin në qytetet e vendit dhe shkolla kryesisht femërore, një nga porositi të shumta ishte sjellja e gruas shqiptare në raport me ferehtenë dhe zakonet që ndikonin në mbajtjen e saj për të mbuluar fytyrën. Ato këshillonin heqjen e perçes që mbulonin fytyrën ashtu si të gjitha qytetërimet e tjera. Në prag të miratimit të ligjit, tri Princeshat zgjedhën qytetin e Shkodrës për të realizuar misionin e tyre: për të treguar se një veshje ndryshe e një fytyrë e zbuluar nuk e cënonte moralin dhe integritetin e gruas shqiptare. Veshja që ato kishin zgjedhur gjatë vizitës një javore në Shkodër ishte një shembull i mirë për të

gjitha gratë. Funde të shkurtëra e xhaketa të ngushta pas trupit lanë mbresa ato ditë të para të marsit 1937.

Në një reportazh nga Vlora të botuar në një nga numrat e gazetës “Drita” të korrikut 1937, shkruhet ndër të tjera edhe për qytetërimin e Vlorës: *“Mjafton të përmendet se vellua e gruas këtu ka qenë hequr, pothua prej të gjithë gravet, mjaft kohë përpara reformës përparimtare të këtij viti, për t’u dhënë një përgënjeshttrim të plotë fjalëve të paraqitën Vlorën si të mbetur pas”*.

GRUAJA GJATË VITEVE TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Në një reportazh në gazetën “Tomori” me titullin “Në konviktin e Institutit “Nëna Skënderbeu”, mëson se deri në këtë periudhë nuk ka ende një studim serioz për gjendjen e rolin e gruas shqiptare në shoqërinë shqiptare. Gruaja shqiptare shikohej ende vetëm si një mobilje e bukur e lustruar, duke i besuar në shumicën e rasteve në marrëdhëniet me femrën provrebin “Flokë gjatë, mendje shkurtër”.

“Sot, gruas s’onë i dhamë tërë formën e jashtëme të qytetërimit oksidental, por a mund të themi se plotësuam detyrën t’onë, se janë tani në gjendje të qytetëruar, kur brëndësia e tyre, kur kultura e tyre nuk largohet nga ajo e vjetëra? Vazhdojmë të shikojmë femrën t’onë si një lule në saks, si një biju që nuk merr pjesë në jetën t’onë të përditëshme mendore, ose materiale, dhe nuk e përdorim veçse si të tillë, ose e kundërta ngjan këtu dhe kjo rrjedh nga dobësia e jonë, i japim kazmën në dorë dhe e dërgojmë në arë. Ç’ironi e ashpër dhe e vërtet!”

Por jo shumë vonë, në gusht 1944, grupi teatral i Radio Tiranës shfaqti dy komedi të Kristo Floqit, njëra prej të cilave ishte “Mbesa e krahinarit” që ishte shfaqur edhe më parë nga grupi i Bilishtit në vitin 1937. Në sallën e mbushur plot në kinema “Nacional”, para fillimit të shfaqjes, Mustafa Budini, kujdestar i grupit mbajti një fjalim të shkurtër ku tregoi përpjekjet që po bëheshin për formimin e Teatrit shqiptar. Për dy orë, salla ushtoi prej të qeshurave nga loja e bukur e aktorëve Mihal Popi, Liza Varfi, Behije Çela, Xhevat Serezi e Mustafa Budini.

Në 9 prill 1944, të dielën e Pashkëve, në sallën e kinoteatrit të famullisë katolike të Tiranës, u shfaq drama me tre akte “Jevga e Volgës”. Kureshtja e publikut për një dramë të luajtur vetëm prej vajzash ishte e jashtëzakonshme. “E me të vërtet këto amatore të hieshme të veprimit Katholik, - shkruante gazeta “Vullneti i Popullit”, - me çfaqjen e së dielës, ma bane me kuptue se femna shqiptare asht zgjue. Ndërsa breddhëshin nëpër skenë, nën farfurinë e dritave e të stolinave, tue u fal me mburrje syve të spektatorve, tanë hirin e lëvizjeve artistike”. U dalluan zonjushat Margarita Shala, Karmina Gurakuqi, Luçia Zymeri, Roza Shllaku, Ninia Vata. Shfaqjen e ndoqi edhe Padër Anton Harapi.

Bardhyle Nase dhe Evanthija Zoraqi, ishin dy vajzat shqiptare që luanin teatër në vitin



Mandolinata Labëria Vlorë.
Në mes edhe dy vajzat e Marigo Posios

1944. Ato bënë pjesë në Grupin Dramatik të Mikrofonit të Radio-Tiranës. Sipas shtypit të kohës “Bashkimi i kombit” e “Tomori” dy aktoret ishin të denja për të qenë pjesë e Tetatrit kombëtar, formimi i të cilit kishte nisur të diskutohet në rrethet artistike të kryeqytetit dhe institucionet e kulturës.

“Zonjusha Zoraqi ka një fizikë të përshatëshme për sgenë, një sjellje të këndëshme e veçanërisht një ton të kultivuar në shprehjet... Dy aktoret meritojnë urimet më të përzemërta, jo vetëm për mundimin që derdhën në sgenë, por për guximin që dëftuan si gra Shqiptare në favor të lartësimit të kulturës shqiptare, përsa i përket artit dramatik”.

NGA TEATRI NË MAL E MË VONË NË VOTIM

Më shumë se 5 mijë vajza u rreshtuan në formacionet partizane gjatë L.II.B, për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Shumë vajza të tjera u angazhuan në njësitet guerrile që vepronin nëpër qytete të ndryshme të vendit.

Gruaja partizane që drejtonte e urdhëronte, gruaja që luftonte njëloj si burrat dhe binte në vijën e parë të frontit, gruaja që duronte mizoritë e qelive fashiste e nuk tutej përpara torturave dhe vdekjes, që përballonte vështirësitë e marshimeve të gjata, rreziqet dhe privacionet e një jete në qiell të hapur, gruaja që edukonte, qytetëronte e mësonte masat analfabete të fshatit të prapambetur shqiptar: e gjitha kjo ishte një “mrekulli”, që ndodhte për herë të parë në Shqipëri. Ishte edhe shenja më domethënëse e një shoqërie që po ndryshonte. Përfshirja e femrës shqiptare në Luftën Antifashiste demaskoi e zhvleftësoi përfundimisht rendin e vjetër, të bazuar në injorancën, shtypjen dhe pabarazinë.

“Të gjithë shtetasit pa ndryshim seksi, kombësie, race, besimi shkalle kulturore ose banimi dhe që kanë mbushur moshën 18 vjeç, kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjitha organet e pushtetit shtetëror”, ishte neni që vendoste përfundimisht pjesëmarrjen e grave në votime. Në nenin 17 theksohet se *“Gruaja është njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike dhe shoqërore”*.

Deputetet e para femra në historinë e vendit, të zgjedhura në 2 dhjetor 1945 janë: Liri Gega, Liri Belishova, Eleni Terezi, Naxhije Dume, Nexhmije Hoxha, Ollga Plumbi, gjithsej 6%. “Gruaja forcë e madhe” u bë motoja komuniste e angazhimit të gruas në të gjitha fushat e jetës.

Nga SUADA DACI

Për këdo ndodh që kur një njeri i shtrenjtë largohet nga jeta të gjithë ne e kërkojmë atë tek kujtimet (madje ato i kemi të shenjta), kjo ndodhi dhe me Marjeta Ljarjan. Duke dashur t'i sistemonte edhe njëherë mirë shkrimet e ruajtura me kujdes të Rikardit, asaj ju rizgjuan edhe njëherë emocionet që ai kishte provuar. Pasi u konsultua me miq të tyre vendosën që ato shkrime të botohen. Me ndihmën e gazetarit Dashnor Kaloçi dhe dashamirësisë së shtëpisë botuese "Onufri" vjen për artdashësit botimi "Rikardi-Nuk kam asnjë peng". Një libër që do të ndihmojë të gjithë lexuesit e letrave për ta njohur Rikardin në një dimension tjetër.

"Është një libër memorie dhe ndoshta artdashësit e veçantë të tij duke lexuar këtë botim, do të njohin një tjetër dimension të Rikardit", thotë Marjeta Ljarja.

Për hir të së vërtetës nëse i hedh një sy shkrimeve të artistit ajo që të bie në sy është se në çdo artikull ka mendime të ndryshme dhe asnjë nuk është i ngjashëm me një tjetër. Rikard Ljarja nuk e quante veten shkrimtar. "Unë nuk jam shkrimtar, por shkruaj njësoj si miliona njerëz në këtë botë që kanë shkruar dje, shkruajnë sot e nesër do të vazhdojnë të shkruajnë", ka thënë Rikard Ljarja i cili për të gjithë ata që nuk e dinë është autor i gjashtë botimeve.

"Një humbëtitirë këtej rrotull", "Kohë qenshetj", "Tymi Kronikë bardhezi", "Josifpedia"

"9 shkurta", "Prill" që për fat të keq si gjejmë dot në asnjë librari.

"Arsyeja e parë është që Rikardi mjaftohej me botimin e librit, por nuk interesohej për promovime madje nuk shkonte as në panairë", thotë Marjeta Ljarja.

Keni ndonjë libër të preferuar të tij, e pyes unë "Kam disa si përshembull "Kohë qensh", "Tymi Kronikë bardhezi", "Josifopedia"...

MIQTË PËR LIBRIN E RIKARDIT

Ndihmesë të veçantë për të përballuar

Marjeta Ljarja:

RIKARDI

QË JU NUK NJIHNI!

"Rikardi- Nuk kam asnjë peng"

emocionet e bashkëshortes së Rikard Ljarja, Marjeta Ljarja ka dhënë gazetari Dashnor Kaloçi.

“Kam marrë mendime nga shumë miq përpara se ta botoja sepse thoja mos ndoshta më dominon emocioni i largimit të njeriut tim të shtrenjtë dhe kisha frikë mos dilte një botim sentimental”, tregon Marjeta.

Ajo i ruan me shumë kujdes dhe fanatizëm të gjitha dorëshkrimet e bashkëshortit të saj madje edhe skenarët e filmave tij.

“Ai arriti të bënte një seleksionim të veprave të tij dhe duke e respektuar këtë seleksionim besoj që ky do të jetë botimi i tij i fundit, por për nostalgji unë do të vazhdoj të ruaj çdo dorëshkrim të tij. Është shumë kënaqësi dhe madje shumë përgjegjësi të bësh libër i cili do kohën e vet. Prandaj unë do t'i ruaj të gjitha në bibliotekën tonë familjare”, thotë Marjeta Ljarja.

MARJETA DHE RIKARDI


Është e çuditshme por e vërtetë se si një çift kaq i dashur, kaq i njohur në Tiranën e viteve '80, kaq të adhuruar, të përfolur dhe duke përballuar çdo lloj sfide në jetën e tyre, zgjodhën që gjithçka ta mbanin larg vëmendjes mediatike. Ata kanë jetuar mbi 40 vjet në një nga rrugët më të famshme të Tiranës, gjithnjë të respektuar si nga kolegët por mbi të gjitha nga publiku i thjeshtë i kryeqytetit.

Ata u njohën në sheshxhirim. Ajo ishte 22 vjeç ai 34 (në kulmin e suksesit) ku i bëri bashkë filmi “Në pyjet me borë ka jetë”. Regjisori Rikard Ljarja asokohe ishte në kërkim të një aktoreje dhe mendja i shkoi larg Tiranës, në qytetin e bukur të Pogradecit. “Mu kujtua një vajzë që kisha patur në Institutin e arteve, fizionomi e mirë nga Pogradeci. Filluam xhirimet e filmit dhe mes nesh u krijua një marrëdhënie e ngrohtë. Ishte filmi që gjeta bashkëshorten”, ka thënë Rikard Ljarja në emisionin “Përballë” në Digitalb.

Në po të njëjtin emision Marjeta Ljarja i tregon më ëmbël fillimet e tyre të dashurisë. “Marrëdhënia jonë kishte avancuar por ne nuk kapeshim dorë për dore sepse unë isha shumë e ndrojtur. Isha dorëzuar përpara një ndjenje të singertë, por kur mbaruan xhirimet e filmit dhe ne u kthyem në Tiranë aty kuptova se me kë kisha të bëja dhe dashur pa dashur u kujtova që kisha thyer edhe betimin që “nuk do të martohesha kurrë me një aktor”, është shprehur Marjeta Ljarja.

R. L. RIKARDI

Nuk kam asnjë peng



Ditën e celebrimit me Marjetën



Dita e martesës,
28 tetor 1979



Nga Filmi "Në pyjet me dëborë"
me aktoren Marjeta Ilo

PAK RIKUJTESË PËR KARRIERËN E RIKARD LJARJAS

"Artisti i Merituar" Rikard Ljarja e ka nisur karrierën e tij në moshën 23 vjeçare me filmin "Komisari i dritës", prodhuar në vitin 1966 nga regjisori Dhimitër Anagnosti dhe Viktor Gjika. Personazhi i Dritan Shkabës u kthye menjëherë në idhullin e kohës dhe siç ka rrëfyer Rikard Ljarja emri "Dritan" u përhap masivisht asokohe në Shqipëri. Për këtë film pati aq shumë interes sa biletat e tij u shitën 100 lekë në treg të zi (një shaka). Më pas ai vijoi me të tjera prodhime të suksesshme kinematografike si "Duel i Heshtur" në vitin 1976, "Gadhnjim mbi vdekjen", "Plagë të vjetra", "Kur zbardhi një ditë", "Yje të netëve të gjata", filmi ikonë i tij "Rrugë të bardha" ku interpretoi dhe spikati me personazhin e Dedës.

Ndërsa si regjisor, Rikard Ljarja njihet për filmat "Fund i një gjakmarrjeje", "Dita e parë e emërimit", "Radiostacioni", "Skëterrë" me skenarist Bashkim Shehun, etj. Përpos regjisë ai ishte edhe skenarist i filmit autor "Pesha e kohës" dhe "Kur hapen dyert e jetës". Nga viti 1996 dhe deri kur doli në pension Rikard Ljarja punoi si drejtor artistik në Televizionin Publik Shqiptar...

**Rikard Ljarja
njihet për filmat
"Fund i një
gjakmarrjeje",
"Dita e parë
e emërimit",
"Radiostacioni",
"Skëterrë" me
skenarist Bashkim
Shehun, etj. Përpos
regjisë ai ishte
edhe skenarist i
filmit autor "Pesha e
kohës" dhe "Kur hapen
dyert e jetës". Nga viti
1996 dhe deri kur doli
në pension Rikard Ljarja
punoi si drejtor artistik
në Televizionin Publik
Shqiptar...**



HYGEIA HOSPITAL TIRANA

RADIOTERAPIA NË SPITALIN HYGEIA



**TEKNOLOGJIA E GJENERATËS SË FUNDIT & MË BASHKËKOHORE
NË TRAJTIMIN E KANCERIT, PËR HERË TË PARË, NË SHQIPËRI & RAJON,
VETËM NË SPITALIN HYGEIA**

- Kohë trajtimi e shkurtër & precizion shumë i lartë
- Kontroll në kohë reale e pozicionit të Tumorit
- Trajtim i Kancerit të Mushkrisë me Skaner 4D me precizion shumë të lartë
- Trajtim i Kancerit të gjirit me Skaner 4D pa prekur zemrën
- Radiokirurgji – Trajtimi me sukses i tumoreve të vogla të kokës & metastazave në 1 séancë të vetme, pa Kirurgji
- Trajtim i metastazave të Mëlçisë, apo edhe në çdo vend tjetër, për vetëm 3 ditë
- Mjekë Onkologë- Radioterapeut me eksperiencë ndërkombëtare



Tiranë Kashar Mëzez KM 01 i Rugës dytësore
të Autostradës Tiranë-Durrës, Fushë-Mëzez



+355 4 23 90 000



[https://web.facebook.com/
Hygeia.Hospital.Tirana.HHT/](https://web.facebook.com/Hygeia.Hospital.Tirana.HHT/)



www.hygeia.al



MARJETA LJARJA RIKTHIM PAS SHUMË VITESH NË SKENË


Marjeta Ljarjas i shkëlqejnë sytë si të një fëmije të lumtur sa herë që e pyesim për filmin.

“E di pse e adhuroj filmin sepse nuk ke ku

fshihesh. Te filmi je e vërtetë, ke mundësi të jesh e thellë, nuk kushtëzohesh si jam sot e si jam nesër, ke mundësi ta çosh deri në fund atë që ti do”, rrëfen artistja.

Marjeta Ljarja ka lindur në Pogradec, ka





qenë një nxënëse e shkëlqyer dhe dëshira e saj ishte që të bëhej një inxhinierë ndërtimi. Por jeta e saj mori një rrjedhë krejtësisht tjetër nga çfarë dëshironte. Me shumë role në kinema e teatër ku më të spikaturit kanë qenë “Vajzat

me kordele të kuqe”, në rolin e Jetës, “Fillim i Vështirë”, “Rrethi i kujtesës” për të cilat është vlerësuar me tre kupa për rolet e saj në kinema.

Por duke nënqeshur Marjeta thotë: “ unë di të tërhiqem, di të hesht... Por edhe këtë

herë më bëri të thyej heshtjen Rikardi me librin e tij dhe më bëri të kujtohem që jam aktore me largimin e tij”...

Ajo u rikthye për të rimarrë edhe njëherë duartrok- itjet e publikut shqiptar me shfaq- jen “Tre dimra”, e cila vjen nën reg- jinë e Rozi Kostanit në Teatrin e Met- ropolit. “Tre dim- ra është një pjesë shumë e bukur, e vënë me shumë dashuri në skenë nga regjisorja Rozi Kostani dhe shkruar me mjeshtëri nga autorja Tena Stivicic. Rozi ka ditur të zg- jedhë kastin e du- hur të aktorëve duke bërë një gërshetim të mirë mes brezave. Më

kishte marrë malli për kolegët, por u kënaqa edhe me të rinjtë e talentuar”, tregon ajo.

Por a ka marrë ndonjë ftesë për film Marjeta Ljarja?!

“Kam një ëndërr... por për film është shumë vështirë...”

A do të vazhdoni të aktivizoheni më shumë tani e tutje?

“Po. Rikardin se kam, mbesa dhe nipi që më kanë dhënë një kënaqësi të jashtëzankonshme si gjyshe mu larguan jashtë atdheut. Tani e vetmja gjë që di të bëjë mirë është aktore”...



KULTURË



“Unë di të tërhiqem, di të hesht... Por edhe këtë herë më bëri të thyej heshtjen Rikardi me librin e tij dhe më bëri të kujtohem që jam aktore me largimin e tij”...



SHKËLQIMI DHE RËNIA E DINAMOS

Nga RETIN TOKA

Zemra e tij rrihte fort. Gëzimi i kishte përshkruar gjithë qenien. Nuk mund ta fshihte. I dukej si “Deja Vu”. Para syve kishte momentet kur festonte dhe çonte peshë gjithë stadiumin me golat nga distanca. Ishte ai, i pamarkueshmi Sul Demollari. Dinamo, 18-herë kampionia e Shqipërisë kishte bërë realitet ëndrrën. Vendin tanimë e kishte në elitë, aty ku kishte thyer shtylla e çarë rrjeta. 9 vite plot stërmundim duke u strapacuar në kategoritë inferiore ishin një kujtim i shëmtuar që duheshin harruar sa më shpejt. Celulari i gëlonte nga mesazhet, të shumtë ishin dhe ata që e telefononin për të festuar së bashku.

Kur përmendet Sulejman Demollari, është njësoj si të thuash Dinamo. Është një nga njerëzit që ka kontribuar pafundësisht për këtë klub. Mbi 140 gola të shënuar, plot 11 vite të kaluara si futbollist me kryeqytetasit. Ngjitja e kësaj skuadre në Superiore, për të do të thoshte shumë. “*E mbaj mend kur miqtë më telefonuan dhe donin të ndanin me mua kujtime të ndryshme në ditën kur Dinamo siguroi matematikisht Superioren. Do të jetë diçka e paharrueshme për mua. Na mungonte shumë. Në rrethin tonë shoqëror ishte gjithmonë temë diskutimi*”, thotë fillimisht mes emocioneve 57-vjeçari.

Dinamo e Kategorisë së Parë kishte bërë mrekullisht mirë. Investimi i italianit Marco Pontrelli kishte vlejtur. Padyshim ka shënuar emrin e tij në historinë e klubit dinamovit. Duhet një i huaj për të sjellë mes më të mirëve një nga ekipet elitare të vendit tonë. “*Duhet falënderuar Marco Pontrelli. Investoi dhe pati strategji të mirë në ndërtimin e skuadrës. Kur ishte në krye të klubit, qëlloi saktë në veprimet e bëra*”, ndan mendimin e tij Demollari për ish-presidentin që kontribuoi për të sjellë mes më të mirave “Nëndetësen Blu”.

Megjithatë për Kategorinë Superiore duhej më shumë buxhet e mbi të gjitha një projekt i mirëmenduar. Optimizmi në kampin dinamovit ishte ulur këmbëkryq. Dozat u shtuan më shumë kur nisën ndryshimet në kupolën drejtuese.

**ADRIAN BARDHI,
PRESIDENT I DINAMOS**

Ngjitja në elitë e Dinamos dukej se kishte futur në shinat e duhura një klub që do të projektohej për në krye të kampionatit shqiptar. Pas përfundimit të sezonit futbollistik 2020-2021, punimet në klubin dinamovit nisën me ritme të frikshme. I pari që “preu shiritin” e transferimeve ishte Adrian Bardhi. Një emër mjaft i njohur në fushën e biznesit, por i kamufluar në botën e futbollit. Vinte pas një përvoje pozitive te Teuta. Kishte investuar te “Djemtë e Detit” si sponsor i këtij ekipi duke arritur titullin kampion në një garë të jashtëzakonshme me Vllazninë dhe Partizanin. 1 vit i kishte mjaftuar që të kuptonte se si mund të bëhej pjesë e rëndësishme e lojës më të ndjekur në botë. Kështu vendosi të zgjidhte Dinamon, që nuk është thjeshtë skuadër, por markë e rëndë e futbollit shqiptar. “*Afrimi i Adrian Bardhit në krye të Dinamos ishte lajm i mirë për dinamovitët. Financat ishin të shëndosha, pra buxheti ishte i sigurtë për Kategorinë Superiore*.”, shprehet Demollari.

BLEDI SHKËMBI, TRAJNER I DINAMOS

Mediet kishin nisur nga puna prej kohësh duke zbuluar emër pas emri lojtarët që do t'i bashkoheshin skuadrës së Dinamos. Presidenti Bardhi me bashkëpunëtorët e tij kishte nisur të piketonte futbollistët që do të afronte. Edhe pse Shkëmbi s'ishte i pari që u zyrtarizua në klubin kryeqytetas, marrëveshjet e arritura ishin të gjitha me miratimin e korçarit. Eksperiencia s'i mungonte si trajner, megjithatë të drejtosh Dinamon është përgjegjësi e madhe. Shumë të rinj ndoshta s'e mbajnë mend në kohët e arta të saj, por kur luante kjo skuadër, stadiumi ishte i njëjtë si në derbin mes Tiranës dhe Partizanit. Shkëmbi kishte provuar të drejtonte në Kosovë, ndërsa në Shqipëri ishte në krye të Teutës për disa muaj. Megjithatë Demollari përtypet kur pyetet nëse korçari ishte i duhuri për Dinamon. “*Personalisht unë e kam uruar sepse në karrierën e tij sportive është një emër i bukur. Por, jam me këtë që trajnerët ndahen të suksesshëm dhe jo të suksesshëm. Puna e tyre matet me rezultate. Kur e shikon që nuk shkon, edhe në vetvete, s'është as i pari, as i fundit, mbase duhet të ndërrojë ekip. Duhet të kenë parasysh të gjithë trajnerët që dorëheqja është qytetari. S'bëhet qameti i madh*.”



Presidenti i FSHF-së,
Armand Duka dhe
ish-lojtari i Dinamos,
Sulejman Demollari

“S”bëhet qameti i madh. Kur vjen një moment që nuk ke rezultate, lëvizja të bën mirë ty personalisht. Mua më ka bërë përshtypje se si ka mundësi që presidenti Bardhi lëvizi tre ndihmësa brenda një sezoni? Besoj se është koha që në futbollin shqiptar është fryma të futen njerëz profesionistë”

Kur vjen një moment që nuk ke rezultate, lëvizja të bën mirë ty personalisht. Mua më ka bërë përshtypje se si ka mundësi që presidenti Bardhi lëvizi tre ndihmësa brenda një sezoni? Besoj se është koha që në futbollin shqiptar është fryma të futen njerëz profesionistë”.

MERKATO, EMRA BOMBASTIKË PËR KRYEQYTETASIT

“Dinamo blinda mbrojtjen; Dinamo “rrëmben” yllin e Superiores; Dinamo përgatit super skuadër”, këto ishin disa nga titujt të medieve në vend në periudhën e merkatos së verës. E në fakt me të drejtë. Në letër, klubi kryeqytetas vlente shumë. Kishte gjetur dakordësinë me emra si Aleksandës Isaevski, Eni Imami, Siljanovski, Agim Ibraimi dhe disa talentë të Apolonisë duke fituar garën me Partizanin që ishte “dhëmbë për dhëmbë” për shërbimet e këtyre lojtarëve. Praktikisht jashtë fushe, Dinamo ishte projektuar për të luftuar në pjesën e sipërme të tabelës. Por, a duheshin bërë gjithë këto shpenzime në vitin e parë të ngjitjes në Superiore? Demollari i pëlqen idea e një skuadre të mirë, por duhet ndërthurje. “Kur Dinamo u ngjit në Superiore, presidenti Bardhi vuri në dispozicion gjithçka për të marrë lojtarët më të mirë. Emrat që u afruan ishin cilësorë. Duke parë fillimin, menduam se do të jetë një organizim i mirë. Kur kishim një takim me presidencën dhe lojtarët apo edhe ish-dinamovitet veteranë që prej vitesh kemi veshur, kemi prezantuar këtë skuadër. Faruk Sejdi, Mujo Targaj, Artur Çobani, Ermal Tahiri, Alego Bregu, mos të harrojmë edhe ndonjë tjetër, i uruam ekipit dhe stafit të ri një punë të mbarë dhe suksese në sezonin e ri. Por, me fillimin dhe në vazhdimësi, personalisht bashkë me grupin e

shokëve, të them të drejtën, ndihemi të zhgënjyer për paraqitjen e mbi të gjitha për lojën e Dinamos. Kemi pasur shpesh takime dhe kemi dhënë mendimet tona, qoftë edhe fillimisht Bledi Shkëmbit”, tregon mes notave të mërzi së Sul Demollari. Bashkëpunëtorë të futbollit shqiptar dhe të Dinamos tregojnë se në listën e përpiluar nga Shkëmbi kanë qenë edhe lojtarë të tjerë që për një shkak ose tjetër nuk u afruan. Bëhet fjalë për futbollistë si Sherif Kallaku, Bruno Dita apo edhe Gledi Mici, të cilët korçari i kishte kërkuar me ngulm. Me sa duket dëshira e tij mbeti vetëm në letër...

ELITA, BUXHETI MUJOR I DINAMOS

Me lojtarët e afruar, klubi i Dinamos rriti koston krahasimisht me një vit më parë. Siç mësohet rroga më e lartë të kryeqytetasit kapte vlerën e 5500 eurove, ndërsa më e ulëta 300 euro. Presidenti Bardhi ishte jashtëzakonisht korrekt me pagesat. Vlera totale e shpenzimeve mujore ishte afro 60 mijë euro, shifër kjo e kënaqshme për një klub të elitës që pretendon Europën. “Unë kam marrë vesh që

presidenti Bardhi është serioz në pagesat kundrejt futbollistëve. E për këtë duhet përshëndetur. Lojtarët i marrin rrogat datë më datë”, tregon Demollari, që edhe pse jashtë klubit, ka informacion me atë që ndodh të 18-herë kampionët e vendit. Megjithatë po ta krahasosh me Tiranën, ekipin që aktualisht është me një dorë të titulli, buxheti është mjaft i vogël. Dinamo në fillim sezoni kishte në sulm: Chinedu, Mihana, Bardhi, Skuka dhe Haxhiu. Të pestë lojtarët kishin së bashku një rrogë aq sa e ka aktualisht Michael Ngoo.

KOMPLEKSI GJIGANT, PROJEKTI I NJË KLUBI TË MADH SHQIPTAR

Krahas punimeve për ndërtimin e skuadrës që do të përfaqësonte Dinamon në sezonin e ri, drejtuesit po tentonin të kishin një klub dinjitoz për kampionatin shqiptar. Kësisoj presidenti Adrian Bardhi arriti marrëveshje me një kompleks sportiv dhe një hotel, ku do të qëndronte për gjatë gjithë vitit skuadra dinamovite. Krahas saj, ai kishte blerë truall në periferi të Tiranës për të ndërtuar gjithçka vetë nga fillimi. Investimi ishte kolosal dhe njëjtë me vlerën e një skuadre që lufton gjithmonë për titullin kampion. Falë seriozitetit të treguar menjëherë u afrua sponsori i parë në klub që kryeqytetasit do ta mbanin të

“Drejtori i Dinamos kishte prishur harmoninë në skuadër, merrte përsipër role që s’i takojnë dhe në dhomat e zhveshjes tentonte të bënte ligjin. Kur kërkohet një mendim nga Demollari për këtë situatë në të cilën ka mbërritur Dinamo”

stampuar në fanelë. Edhe në këtë rast zhurma ishte më e madhe se veprat. Trumbetimi i bërë rezultoi fatal për Dinamon pasi prishmëritë u rritën shumë. I të njëjtit mendim është edhe Demollari, që në intervistën e dhënë enkas për Newsbomb, thotë: *“Pati shumë premtime në fillim të sezonit. Ç’është e vërteta, edhe ne, “ish”-at dinamovite u bëmë optimistë sepse realisht klubi kishte lëvizur. Por, kur mendon për një Dinamo të madhe, duhet që të kesh 2-3 këshilltarë për çdo ndryshim që ndodh. Edhe staf i teknik të ketë një oponencë në çdo afrim që bëhet. Pra, të jenë njerëzit më të afërt të presidentit. Kush është ky Rexhinaldo? Ku ka luajtur? Këto duhet t’i pyeste presidenti Bardhi”.*

TIFOZËT, POLITIKA E GABUAR

Tifozët janë zemra e çdo ekipi anë e mbanë botës. Nëse s’do të ishin ata, padyshim që futbollit nuk do të kishte kuptim. Te Dinamo gabuan me politikën e ndjekur. Edhe besnikët që kishin mbetur, u larguan nga veprimat e pakuptimta të drejtuesve. U mbyllën disa tribuna që do të shërbenin për ata tifozë që duan të qëndrojnë larg zhurmës së ultrasve. Për të ulur kostot financiare, në fund u vendos që mos të hapej as tribuna e fanatikëve të fanelës blu. Logjika ishte e thjeshtë. Më pak tribuna, më pak stjuart. Tribunat kryesore u ulën nën çmimin minimal, duke rënduar në këtë mënyrë arkën e klubit. Ajo që gjithmonë shitet 1000 lekë, nga klubi dinamovit doli në treg me 300 lekë. U mendua se ishte strategjia e duhur për të afruar tifozët, por në fakt vetëm i larguan më shumë. Ata që ende kanë mbetur dhe bëjnë tifo për Dinamon u grumbulluan në një tribunë, pikërisht te ajo kryesore që drejtuesit e bënë me 300 lekë. Edhe për tifozët e paktë, Demollari e ka një shpjegim. *“Nuk mund të vijë njeri në stadium për të parë një skuadër që nuk premtton. Dakord, mund të humbësh, po të paktën vendosesh në fushë dhe tregon se do të kesh vazh-*

Drejtori Barushi në
aktivitete me tifozët
dynamovite





www.newsport.al



**AGJENCIA
MEDIATIKE
E DEDIKUAR
SPORTIT**

Bota sportive në një klikim

**LAJMET E FUNDIT
NGA VENDI DHE BOTA**

-  **NewsportAlbania**
-  **newsport_al**
-  **Newsport.al**
-  **Newsbomb Albania**
-  **0695537777**
-  **redaksianewsport@gmail.com**
-  **Adresa: Rruga "Emin Duraku", Hyrja 1, Ap.14, Tiranë**

dimësi. Por, Dinamo nuk të bind. Nuk luan futboll. Dhe me këtë lojë që bën shpresat unë e shoh që tani në Kategori të Parë. Në momentin kur s'ke shpresë, vetiu largohen edhe tifozët. Problemi nuk është tani në fund, por që në fillim që e nisën me përplasje”, thotë mes të tjerash, ish-lojtari i Dinamos dhe i kombëtares shqiptare.

TETOR 2021, PËRPLASJA E PARË MES DREJTUESVE DINAMOVITË

Teksa në letra gjithçka kishte shkuar “vaj”, në fushë Dinamo ishte me shumë oshilacione. Njëra ndeshje s'i ngjante tjetrës dhe ishte mjaft e vështirë të parashikoje se si do të ishte skuadra përballë një ekipi. Presidenti Adrian Bardhi kërkonte shumë nga të “tijtë” e me të drejtë. Ata ndaj paguheshin dhe në çdo datë 2 ose 5 të muajit gjenin rrogën në llogaritë e tyre. Sezoni nisi me këmbë të mbarë për blutë e kryeqytetit duke fituar në transfertë 2-0 me Kastriotin. Optimizmi u shtua me shumë dhe skuadra “karikohej” me shumë premiot e drejtuesve. Megjithatë duhej të vinte transfertat e parë me Vllazninë në tetor të vitit të shkuar që të nisnin krisjet e para brenda klubit. Ndeshja u karikua në maksimum dhe përmes një video spektakolare, blutë trgonin sa të motivuar ishin për të fituar këtë sfidë të veçantë. Ishte e tillë sepse në përbërjen e skuadrës dinamovite kishte lojtarë që kishin kontribuar dhe shkëlqyer një sezon me parë me Vllazninë. Por, ndeshja nuk shkoi siç duhej. Dinamo u mposht me rezultatin e thellë 6-3 në një sfidë që tregoi dobësi në të gjitha repartet. Në analizën e pas-ndeshjes, drejtori Ermal Barushi gjeti pretekst para-përgatitjet duke thënë: “Jemi fajtorë sepse e frymë shumë sfidën. Nuk duhej, me video me gjëra. Duhet ta merrnim më qetë”, mësohet të jetë shprehur një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Bardhit. Këtu nisën konfliktet e para të 18-herë kampionët e Shqipërisë. Ishte vetëm java e gjashtë e kampionatit. Profesori Demollari edhe këtu e jep një zgjidhje: “Në një skuadër që ka përplasje, mund të afrohet edhe një psikolog. I shërben pozitivisht edhe lojtarëve. Ndofta gjërat nuk do të kishin shkuar në këtë gjendje. Çdo gjë e ka një zgjidhje. Mjafton të jetë dëshira pozitive dhe siç e thashë është e rëndësishme opoenca në kupolën drejtuese”.

JANARI, PËRSËRITEN GABIMET E VERËS

Merkato e janarit u shërben gjithmonë skuadrave për të riparuar ato defekte që vërehen gjatë pjesës së parë të sezonit. Mundësitë janë minimale për të afruar futbollistë me vlera pasi shumë prej tyre janë nën kontrata me ekipet e tyre. Edhe në këtë periudhë, drejtuesit e Dinamos vepruan

Presidenti Adrian Bardhi kërkonte shumë nga të “tijtë” e me të drejtë. Ata ndaj paguheshin dhe në çdo datë 2 ose 5 të muajit gjenin rrogën në llogaritë e tyre. Sezoni nisi me këmbë të mbarë për blutë e kryeqytetit duke fituar në transfertë 2-0 me Kastriotin. Optimizmi u shtua me shumë dhe skuadra “karikohej” me shumë premiot e drejtuesve

gabim. Rasti konkret është Xhuliano Skuka. Sulmuesi tanimë i Partizanit po shkëlqen me të kuqtë dhe duket sikur ka një jetë që është pjesë e tyre. Te Dinamo e lanë të lirë për shkak të formës së tij dhe morën një sulmues i Rexhinaldo Faite. Këtë fakt e kritikon edhe Demollari duke thënë: “Merkato e janarit u shërben skuadrave për të riparuar pak defekte që shfaqin gjatë pjesës së parë të sezonit. Te Dinamo edhe në dimër u veprua gabim. Hoqën atë Skukën dhe morën Rexhinaldon. Si mund të marrësh një lojtar pa minuta në këmbë? Si e heq sulmuesin që kishte vetëm se pse nuk po kalonte formë të mirë? Politikat e klubit janë të gabuara”. Pra, edhe hyrje-daljet në dimër nuk korigjuan asgjë te kryeqytetasit.

LARGIMI I SHKËMBIT, SHERR I MADH ME DREJTORIN BARUSHI

Një trajner matet me rezultate. Pavarësisht dëshirës së madhe për të bërë më të mirën me Dinamon, në fund Bledi Shkëmbi dorëzohet dhe jep dorëheqjen. Vendin e tij e zë Bledar Devolli, i njohur për karakterin e rreptë në skuadër. Edhe pse punon me pasion të madh, nuk mund që të fusë në shina ekipin dinamovit. Por, si të mos mjaftonin rezultatet negative, përçarjet brenda ekipit ishin të mëdha. Shumë lojtarë ishin përplasur me drejtorin Ermal Barushi. Edhe drejtori sportiv Arbi Laçi, sikurse dhe menaxheri i klubit Mario Nikolli, të cilët u larguan kur panë nga afër çuditë në klubin dinamovit. Burime tregojnë për Newsport.al që përplasja me Devollin kishte precipituar në konfrontim fizik. Drejtori i Dinamos kishte prishur harmoninë në skuadër, merrte përsipër role që s'i takojnë dhe në dhomat e zhveshjes tentonte të bënte ligjin. Kur kërkohet një mendim nga Demollari për këtë situatë në të cilën ka mbërritur Dinamo, ai shprehet me një



Adrian BARDHI, presidenti i Dinamos dhe dy tifozë besnikë të Dinamos

fjalë duke i thënë të gjitha: “Përgjegjës kryesor për këtë gjendje është presidenti. Ai ka të drejtën ekskluzive për të caktuar politikën e klubit. Është ai që i vendos apo largon funksionarët të caktuar. Por, unë i qëndroj mendimit se kjo skuadër duhet të kishte në përbërje dinamovitë (në staf), që e duan me shpirt këtë ekip”.

ITALIANI, DËSHIMI I RADHËS PËR MBIJETESË

Pas Bledi Shkëmbit, nuk zgjati as largimi i Bledar Devollit. Tekniku gjirokastrit e pati të vështirë të punonte në një ambient të tillë. Dhe çudia sërish mban emrin “Dinamo”. Drejtuesit e saj marrin në krye të pankinës një italian, Rodolfo Vanoli. Vinte nga kampionati italian, por gjasat që të kishte info për futbollin shqiptar ishin të pakta. Jo vetëm që nuk arrin një fitore, por skuadra dinamovite nuk funksionon më as në fushë. Demollari kritikon ashpër drejtuesit dhe jep zgjidhjen e tij. “Mua më kanë habitur shumë me këtë zgjedhjen e fundit. Merr një italian, që nuk di asgjë për ekipin dhe vendose në krye të skuadrës. Si mund të marrësh një trajner kur je pranë rënies nga Kategoria? Kjo lëvizje ishte plotësisht e gabuar. Ai s’di asgjë as për kampionatin shqiptar, nuk njeh futbollistët. Kam parë në stol lojtarë të afirmuar në sezonin e shkuar, italianin i lë në pankinë. E di kush do të ishte zgjidhja? Më vjen një emër i afërt, Farruk Sejdiu. Profesori e do me shpirt dhe zemër këtë skuadër. E ka thënë dhe publikisht, që do të punonte pa lekë për të. Moshë ka ecur, por me 2-3 bashkëpunëtorë të mirë, ua garantoj që Dinamo s’do të ishte në këtë gjendje. Lëri këto çunat e ri ndihmësa dhe Farruku me autoritetin që ka në skuadër, do të krijonte një grup kompakt”.

SUPERLIGA, NJË ËNDËRR E HIDHUR PËR DINAMON

Shanset që Dinamo të qëndrojë në Superiore janë krejt të pakta. Kryeqytetasit nuk bindin në asgjë. Situata e nderë, atmosfera e zymtë ka ndikuar edhe te futbollistët në fushë. Ndoshta vetëm në një botë paralele ky ekip mund të qëndrojë mes më të mirëve. Profesor Demollari

është i bindur që Dinamo s’ka asnjë shans të jetë edhe sezonin e ardhshëm në elitë. Ndihet keq kur e thotë me gojën e vet, por dëshiron të jetë i drejtëpërdrejtë. “Ndihem keq, më vjen shumë keq kur e shoh këtë skuadër në këtë gjendje. Nuk është puna se humbin, por ata nuk bëjnë as lojë. Për mua faji është i gjithi në majë, konkretisht presidenti Adrian Bardhi. Duhet të bindet se çfarë personash, se çfarë profesionistash do të fusë në klub. Shiko Kastriotin. Nuk i kanë lojtarët më të mirë se Dinamo. Por, janë një grup çunash që janë impenjuar në maksimum dhe po bëjnë lojëra spektakolare”, thotë fillimisht ai. Një dinamovit duhet të japë gjithmonë mendimin e tij e sidomos në të tilla kushte, fjala e “veteranëve” është e artë. Por, siç duket kritikë s’i kanë përlqyer drejtuesve. “Këto 3 muajt e fundit nuk kam pasur asnjë kontakt për situatën aktuale me drejtuesit. Unë sa të kem frymën, do të jem i çiltër dhe do të them atë që mendoj. Edhe fenomenet e përplasjes kanë gjithmonë një zgjidhje”, përfundon mes mërzi një nga njerëzit që ka derdhur më shumë djersë e ka bërë mijëra njerëz të qeshin e të qajnë nga golat e tij.

Rikthimi i Dinamos që një lajm i bukur për futbollin shqiptar. “Fryrja” e bërë në fillim sezoni, rezultoi të ishte boshe. Qëndrimi në elitë është shndërruar në një mision të vështirë. Përplasjet brenda klubit, prishja e harmonisë mes lojtarëve solli këtë gjendje të 18-herë kampionëve të Shqipërisë të projektuar për pjesën e sipërme të tabelës. Prapaskenat janë të shumta dhe të turpshme për një klub elite. Kryeqyteti do të përfaqësohet sërish në elitë vetëm me Tiranën dhe Partizanin. Dinamo tanimë po zgjohet nga ëndrra e bukur “Superiore”. Përgjegjës ka disa, por faturën kryesore do ta marrë klubi dhe presidenti Adrian Bardhi, përgjegjësi kryesor për dështimin e madh. Çdo shtëpi ka një Zot dhe veprohet gjithmonë në momentin e kohës e duhur. Dinamo, një Nëndetëse që u zhyt dhe u venit për 9 muaj... 18 trofe kampioni të destinuar sërish për të qëndruar në vitrinë për shikuesit e Kategorisë së Parë.



Lule, lule

(jo të Flor Mumajesit)
te prillit

Shirat e prillit sjellin lulet e majin, kështu qarkullon një shprehje ose “quotes” (siç e thonë modernët e Instagramit) Baret, restorantet, teatrot do të gëlojnë më shumë tani në pranverë, ndaj dhe ja vlen që të keni një veshje ku të dukeni bukur, sensuale dhe pse jo me shumë vetbesim. Nëse nuk jeni fort të sigurt se nga t’ja filloni me veshjet tuaja, për këtë jemi ne prandaj këtë mini derën e “Fashion Bomb” e kemi lenë të hapur për t’ju ardhur në ndihmë sa herë që idetë tuaja mungojnë (Mos u shqetësoni se dollapi po na bie nga rrobat dhe prapë themi s’kemi çfarë të veshim)

Gjithsesi kini parasysh që fustanet janë kryefjala e prillit (njësoj si lulet që pritët të çelin), pak këmbët jashtë dhe mbi të gjitha xhaketat pranverore.



Lule, Lule

Zgjidh lulet, (trëndafila të mëdhenj me margaritat e vogla) duke i miksuar si dizeno në veshjet tuaja. Në këtë pikë do kemi look interesant që do të na lajmerojë ardhjen e pranverës në veshjen tuaj.



Mix to mix

Bëni bashkë ngjyrat e forta të dimrit me ngjyrat pastel të pranverës. Pantallonat e lëkurës me nuanca dimërore, do të duken fantastike me të kaltrën, rosën e ngrohtë apo edhe të verdhën. Provojeni!



Kokë e këmbë njësoj

Trendi i këtij viti janë kombinimet e njëjta, pra kostumet njëngjyrësh të kombinuara pse jo edhe me të njëjtën ngjyrë këpucësh. Bëni vetëm kujdes me aksesoret (sa më pak) sepse ngjyrat flasin vet, s'kanë nevojë për shoqërues.



FASHION BOMB



Shajet mos i nënvlerësoni

Shallin përdoreni patjetër. Ose lidhjeni në kokë ose rreth e rrotull çantës. Veshja juaj sado e thjeshtë të jetë me këtë aksesore do të marrë tjetër jetë.

Përdorni aksesore shkëlqyes

Nëse zgjidhni xhinse dhe një pardesy të zezë të thjeshtë, patjetër që aksesore tuaj duhet të jenë rezëllitës. Nëse i shtoni veshjes dhe një crop-top të shndritshëm ju sigurojmë që nuk vrisni askënd, përkundrazi...





Përdorni këmishat

Këmishat overzise në këtë periudhë mund të kryejnë fare mirë funksionin e xhaketave. Mund ti vishni me fustane, xhinse apo edhe me crop-top dhe strece. Si të ndiheni më komode!

Fundet e tenisit

Fundet e tenisit, bluzat me jaka (kryesisht Polo) trikot me jakë V dhe atletet janë trendet e kësaj pranvere. Nxirrni nga garderoba se do dukeni perfekt me to.



Jepini xhinseve një mini pushim

Ndërroni xhinsin tuaj të preferuar me diçka po aq të rehatshme, por pak më pak të pritshme, si përshembull një palë pantallona kadife. Do dukeshit super stil!



Vish çorape me shapka

Ajo që dikur mund të konsiderohej kombinim i çuditshëm tani është super "cool", shumë stil dhe tepër e zakonshme. Sigurohuni që shapkat dhe çorapet tuaja të jenë në gjendje të mirë (sepse askush s'do të shohë gishtat tuaj) dhe mos hezitoni t'i vishni.

PROVO NJË KOMBINIM TË PAPRITUR NGJYRASH

Kujt ja merrte mendja që e verdha mustardë do kombinohej kaq mirë me të kuqen, lejlanë apo edhe turquoisen. Prandaj duhet të guxoni!



Nxirni çantat e plazhit

Çantat kashtore që i përdorni për plazh bëni mirë t'i përdorni edhe tani në prill pasi veshjen tuaj e bëjnë të duket fantastike.



Përdore "neon-in" me lezet

E dimë që është shumë në modë por kur përdoret me lezet ngjyra neon veshja duket edhe më interesante. Si përshembull në një veshje minimaliste bardhezi, një palë atlete ngjyrë neon do të dukeshin fantastike dhe veshja do të merrte tjetër rëndësi.






© COPYRIGHT

Nga KADRI VOKOPOLA

KINOFJALËKRYQ



HORIZONTALE

1. Cotillard që qe aktore.
4. _Hot Chili Peppers.
5. Thirrej Caput Mundi.
9. Në krye të katedrës.
10. Janë paret e peshkut.
13. Gjoni që qe kompozitor.
14. Kufizojnë debatet.
16. _black, hit i Rolling Stones.
19. Kufizojnë rastet.
20. Mike i Austin Powers.
22. Një pjesë e berberëve.
23. Gjysma e garave.
24. Parashtesë për jetën.
25. Kompozoi *Bohero*.
29. Qendër mësimi.
31. Inicialet e Penn.
32. Aktorja në foto.
35. Reja trainer.
37. Aktori në foto.
38. Lemper këngëtare e aktore gjermane.
39. Kështu fillon leksioni.
40. Pop_ i Andy Warhol.
41. Katet pa zanore.
42. Diftong poetik.
43. Është tokë buke.


45. Kërcimi me stilin *fosbury*.

47. Panik pa ekstreme.
49. Sastre aktore.
50. Fundi i një fundi.
51. Jepet një me sirenë.
52. Sinatra e *These Boots Are Made for Walkin'*.
54. Ilion Lika.
55. Reitman që qe regjisor.
56. Umberto i *Baudolino*.
58. Qe lajmëtar dikur.
59. Mburraveci i Alphonse Daudet.

VERTIKALE

1. Në krye të masave.
2. Një britmë në corrida.
3. Në krye të nuseve.
4. Ka rivale Mediaset.
5. Një mund të jetë fetar.
6. Në mes të dhomës.
7. Berthe që qe piktoe.
8. Emri i de Saint-Exupéry.
9. U shkrua nga Vatsyayana.
11. Film i Sam Mendes.
12. Dani, mesfushor spanjoll.

13. Jep elarmin.
14. Kujt i bëhet... i del fytyra e vërtetë.
15. Janë binarë.
17. Si gjithmonë.
18. Është dheu në një specialitet kuzhine.
21. Një është edhe Brunei.
22. Një kriptovalutë.
26. Një pjesë e relacionit.
27. Atkinson, alias Mr. Bean.
28. Kufijtë e lëvizjes.
30. Gibson aktor.
31. Kishte një Polifemi.
33. Carlos Santana.
34. Kështu fillon sulmi.
36. Christian aktor.
37. Si tek-tuk.
40. Emri i Delon.
44. _Martin, markë makine.
46. Në krye të trupave.
48. Mouskouri këngëtare greke.
49. Zanore në Vichy.
53. Stevens i *Lady d'Arbanville*.
56. Të fundit në tender.
57. Të parat në cilësi.



MOJ E BUKURA SHQIPËRI!

HORIZONTALE

1. Mendes regjisor.
3. Një listë me sushi.
7. Në fund majtas.
9. Është planeti i kuq.
12. Ekstremit në hektar.
13. Paguhet për vonesë.
15. Një i parë në manastir.
18. Mbyllin një dyqan.
19. Në fund të fundit.
20. Pak analogji.
21. Nino Rota.
23. Pacino aktore.
24. Mbyllet me dorezë.
26. Qytet në Gjermani.
28. Foto 1.
30. Aktori protagonist i *The Abyss*.
33. Parashetë për dy.
34. Lewis Hamilton.
35. Foto 2.
39. Diftong në dietë.

41. Teze pa binjake.
42. Me to bëhet autor.
43. Flynn që qe aktor.
44. Foto 3.
49. Egoyan regjisor.
50. Fillojnë turnin.
51. Agjenci Sportive Rajonale.
53. Një i shtrembër prish gjithë stivën.
55. Nuk mësohet në tokë.
57. Është tokë buke.
59. Foto 4.
61. Fox aktor.
64. Përfundojnë pingul.
65. Kryeqyteti i Perusë.
66. I njohur edhe ai i Maastricht.
67. Moore aktore.

VERTIKALE

1. Hidhet me sy.
2. Kërkojnë talent të tilla.
3. Markë kamioni.
4. Andrea aktore.
5. Fillojnë nazet.
6. Në fund të krahut.
8. Në hyrje të sallës.
9. Mark Twain.
10. Është veshje indianesh.
11. Mund të nxirret me mllef.
13. Hidhet për t'u zgjedhur.
14. Nin që shkroi *Delta* e *Venerës*.
16. Janë odet e Carducci-t.
17. Emri i Delon.

22. Arbana aktor.
24. O'Riordan që këndonte me Cranberries.
25. Është e endur.
27. Monedha jonë.
28. Është prift.
29. Mund të jenë drite.
31. Kufijtë e Holandës.
32. Mbyllin një krah.
36. Mund të ikë nga anosmia.
37. Drejtohet nga një moderator.
38. Gjysmë totale.
40. Deus_machina.
45. Kishte të gjitha gratë e sulltanit një i tillë.
46. Kështu fillon mobilizimi.
47. Të fundit në takim.
48. Një rojë i haremit.
52. Ai i muzave ishte Helikona.
53. Një ishte edhe Amaltea.
54. Gjysma e bursës.
56. Institucione Autonome Tiranë.
58. Një pije piratësh.
59. Ekstremit në duel.
60. Në fund të vitit.
62. Fillojnë mirë.
63. Sheeran kantautor.





HARD SUDOKU

			5	7				9
	7				8			
4					3			6
2	3		7	8				
				5	9			
		7						4
6				1		7		
3						5		2
		1	2				4	

MESATAR SUDOKU

8	4			7				1
	5							
3					9	2		
4	7		9					
6	3		4		1	9		
							5	
				8				5
		1						7
				6	7		3	

I LEHTË SUDOKU

		5				2		
3				4				
		4		5	6			
1	6							3
	7	9	1			4		
					7			
		1		9				7
		2		6		5	3	9
	5							



KURIOZITETE

PSE NË MBRETËRINË E BASHKUAR VOTOHET GJITHMONË DITËN E ENJTE?

Në fakt, që prej më shumë se 85 vitesh, në Mbretërinë e Bashkuar, çdo lloj votimi, si për zgjedhjet parlamentare ashtu edhe për çdo zgjedhje tjetër apo referendum, votimi bëhet gjithmonë të enjten e jo të dielën siç ndodh në shumë vende. Arsyeja? Janë disa interpretime lidhur me këtë por dy janë ato më të besueshmet, që kanë lidhje edhe me njëra tjetrën. Së pari se dita e enjte ka qenë gjithmonë ditë tregu dhe duke qenë se banorët e provincave zbresin nëpër qytete për të shitur produktet e tyre, do të ishin më pranë qendrave të votimit. Arsyeja e dytë, që besohet edhe si më bindëse, lidhet me ditën e pagave, që në Britaninë e Madhe, tradicionalisht bëhej çdo të premte (pagë javore). Duke qenë

se të enjten është dita e fundit e pagës javore, njerëzit nuk do të kishin para në xhep, duke mos pasur kështu mundësi të mbushnin pub-et në fundjavë, e për pasojë nën efektin e alkoolit, të harronin të shkonin për të votuar të dielën. Kështu që mbeti dita e enjte si më e përshtatshme për të siguruar pjesëmarrjen më të madhe.



PSE XHEPI I BRENDSHËM I XHAKETAVE TË BURRAVE NDODHET NË KRAHUN E MAJTË?


E vërteta është se xhepi i brendshëm i xhaketa të burrave zakonisht është në krahun e majtë. Nuk është se ka ndonjë rregull të shkruar apo të caktuar për këtë, por kjo vjen thjesht ngaqë xhaketa e burrave e ka prejardhjen nga kapotat e ushtarëve. Ngaqë dikur ushtarët përveç pushkëve të gjata kishin edhe pishqolla, i mbanin këto të fundit në xhepin e brendshëm të kapotës, që ndodhej në krahun e majtë në mënyrë që ta nxirrnin sa më shpejt për ta përdorur me dorën e djathtë. Prandaj edhe stilistët e rrobaqepësit që e transformuan në xhakete kapotën ushtarake, xhepin e brendshëm e lanë aty ku ishte.

PËRGJIGJET

PËRGJIGJE KINOFJALËKRYQ



PËRGJIGJE MOJ E BUKURA SHQIPËRI!



PËRGJIGJE HARD SUDOKU

8	2	6	5	7	1	4	3	9
9	7	3	6	4	8	1	2	5
4	1	5	9	2	3	8	6	7
2	3	4	7	8	6	9	5	1
1	6	8	4	5	9	2	7	3
5	9	7	1	3	2	6	8	4
6	5	2	3	1	4	7	9	8
3	4	9	8	6	7	5	1	2
7	8	1	2	9	5	3	4	6

PËRGJIGJE MESATAR SUDOKU

8	4	2	6	7	3	5	1	9
9	5	6	8	1	2	7	4	3
3	1	7	5	4	9	2	8	6
4	7	8	9	5	6	3	2	1
6	3	5	4	2	1	9	7	8
1	2	9	7	3	8	6	5	4
7	6	3	2	8	4	1	9	5
2	8	1	3	9	5	4	6	7
5	9	4	1	6	7	8	3	2

PËRGJIGJE I LEHTË SUDOKU

6	9	5	8	1	3	2	7	4
3	1	7	2	4	9	8	6	5
8	2	4	7	5	6	3	9	1
1	6	8	9	2	4	7	5	3
2	7	9	1	3	5	4	8	6
5	4	3	6	8	7	9	1	2
4	3	1	5	9	8	6	2	7
7	8	2	4	6	1	5	3	9
9	5	6	3	7	2	1	4	8

DASHI



Dashi

Hëna në shenjë mund të shënojë një fillim të ri, por që gjithsesi duhet të tregoheni të matur pasi nxitimi mund të bëjë të merrni drejtimin e gabuar që në nisje. Më parë vendosni objektivat që duhet të arrini, pastaj hidhuni në veprim pasi parashikohet që të jeni ju protagonistë në planin ekonomik e profesional. Me afrimin e Afërditës në shenjë do të jeni më të priur për të rrafshuar problemet në raportet ndërpersonale, por duhet të jeni edhe pak më tolerantë.

BINJAKËT



Pas një periudhe qetësie, gjendjeje plogështie duket se situata me Hënë e re të Dashi do të ndryshojë rrënjësisht. Natyrisht, për të dalë nga një gjendje e tillë nuk mjafton vetëm mbështetja e yjeve. Mundohuni të kërkon mbështetjen e njerëzve që frymëzojnë, që kanë ide e fantazi. Nuk ju mungojnë ambiciet por zgjedhjet që bëni lënë për të dëshiruar. Do të keni mundësi konkrete në aspektin ekonomik, ndërsa kokëfortësia në raportet me partnerin acaron situatën.



PESHORJA

Hëna e re të Dashi pritet të sjellë një dinamikë të re në përditshmërinë tuaj, si në planin profesional, ku mund të keni një mundësi të mirë, ashtu edhe në atë sentimental. Me gjithë ndonjë mosmarrëveshje të vogël, në përgjithësi raportet tuaja me partnerët apo kolegët do të jenë përgjithësisht të kënaqshme. Marsi në shenjë ju bën këmbëngulës, luftarakë e në ndonjë rast edhe kapriçiozë, por jeni të vetëdijshëm kur është momenti për të bërë një hap pas. Kujdes me dietën.



BRICJAPI

Përgatituni për një periudhë relativisht të gjatë angazhimesh në planin profesional që do t'ju shohë protagonistë në një sipërmarrje të re, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë. Hëna tani të Dashi është përgjithësisht pozitive, ndonëse nervozizmi i herëpashershëm vjen pikërisht nga fluksi i satelitit natyral të Tokës. Jeni të tundur që bëni një ndryshim në ambientin ku jetoni apo punoni, por nuk jeni të bindur nëse është momenti i duhur. Shëndeti mirë, por merrni më shumë me aktivitet fizik.

PESHQIT



Do të jetë një periudhë shumë e ngjeshur në fushën ku operoni dhe duhet të përgatiteni mirë se peshën më të madhe do ta mbani ju. Gjithsesi shëndoshja e financave tuaja është lajmi më i mirë për ju e kjo ju mbush plot optimizëm. Marsi ekalton cilësitë tuaja luftarake, ndërsa nga ana tjetër Afërdita në shenjë ju frymëzon duke bërë që të kapërceni me lehtësi pengesat që mund t'ju dalin. Të jesh ambicioz nuk është diçka negative, prandaj mos kini drojë të shfaqni ambiciet tuaja.

GAFORRJA



Kuadri yjor është përgjithësisht favorizues për të gjithë ju të Gaforres edhe pse mund të keni edhe ndonjë përplasje apo konflikt në planin profesional. Në sajë të këmbënguljes tuaj karakteristike, do të mundni të kompensoni edhe mungesën e eksperiencës dhe do të arrini objektiva në dukje të vështira.

Hyrja e Afërditës të Peshqit do të ndikojë nga njëra anë shumë pozitivisht në raportet me partnerin dhe nga ana tjetër, stimulojnë dëshirën për të eksploruar rrugë e zgjedhje të reja.



LUANI

Edhe për ju të Luanit, pozicioni i Hënës të Dashi është mjaft pozitiv sepse stimulon dëshirën për të dhënë maksimumin për arritjen e objektivave, por ju bën të dhidni vështrimin drejt horizonteve të reja. Prandaj carpe diem, lerini mëdyshjet dhe hidhuni me guxim për të realizuar ëndërrën tuaj në sirtar. Nuk do të mungojë edhe ndonjë moment përplasjeje me dikë, por keni Marsin luftarak në anën tuaj gjithçka do të shkojë mirë. Shëndeti mirë, por kujdes nga sëmundjet e stinës apo alergjitë.



VIrgjëresha

Tashmë periudhën e paqëndrueshme, konfuze e me shumë oshilacione e keni lënë pas e tani duket se kuadri yjor, me Hënë në plan të parë, është shumë i favorshëm për të rivendosur ekuilibret e munguara. Një projekt i ri kërkon kohë, resurse e energji, por edhe mbështetje financiare. Nëse keni probleme në aspektin financiar, përfshirja në këtë projekt e një të afërm apo miku mund të jetë një zgjidhje mëse e pranueshme. Afërdita të Peshqit ju bën më të afrueshëm e më romantikë.

HOROSKOP BOMB

PRILL 2022



DEMI

Mëdyshjet e pasiguritë jua ndërlikojnë disi zgjedhjet që duhet të bëni, por me kalimin e kohës ndikimi pozitiv i Hënës do t'ju bëjë më të vendosur dhe më të fortë nga pikëpamja e karakterit. Nëse kërkon bashkëpunim apo partneritet duhet të jeni më të gatshëm për të pranuar edhe ç'ka ju ofrojnë të tjerët e jo të këmbëngulni pa ndonjë argument tek e juaja. Marsi është frymëzues për t'ju hedhur plot pasion në një aktivitet të ri, ndërsa Afërdita stimulon erosin.



AKREPI

Nëse deri para pak kohësh kenë qenë disi inidiferentë, të udhëhequr pak a shumë nga një lloj "ku rrafsha mos u vrafsha" tani kuadri yjor me Hënë e re të Dashi do të "shkundeni" nga një lloj apatie e do të mundoheni të vendosni rregull në jetën tuaj. Prania e Afërditës në shenjë nga njëra anë dhe ajo e Merkurit gjithashtu, do të ndikojnë që të jeni më mendjehapur, të pranonin një realitet të ri dhe të merrni më shumë përgjegjësi. Momenti i mirë për financat, por mos e teproni me shpenzimet.



UJORI

Dhjetëditëshi i parë do të karakterizohet nga një gjendje disi e paqëndrueshme, e paqartë dhe kjo do të bëjë të qëndroni në pozita pritëse derisa gjërat të kthellohen për të vendosur se ç'duhet të bëni. Ndërkohë, hyrja e Afërditës në shenjë do të ketë efekte pozitive që do të reflektohen sidomos në drejtim të raporteve ndërpersonale, që nuk janë atje ku duhet. Një investim i mëparshëm duket se do të sjellë frutet e dëshiruar, por duhet të tregoheni më të përmbytur në shpenzime. Mirë shëndeti.

SHIGJETARI

Pritet një periudhë në të cilën dëshira për të bërë mirë do të jetë e madhe e kjo do stimulojë shpirtin tuaj të sipërmarrjes, për të filluar një aventurë të re në planin profesional. Afërdita të Peshqit nga njëra anë dhe Jupiteri e Neptuni përbëjnë një trinom mjaft pozitiv për ju, sidomos në planin sentimental, duke shënuar një pikë kthesë në marrëdhëniet ndërpersonale. Rimëkëmbja e financave është me shumë rëndësi, por merrni pak edhe me veten tuaj, sepse sikur e keni lënë veten pas dore.

NEWS BOMB.al

ABONOHU TANI!



REVISTA E PËRMUAJSHME
POLITIKO-KULTURORE

PËR TË BËRË ABONIMIN KONTAKTONI:

POSTA SHQIPTARE:

+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbomb.al:

+355 69 67 32 020

abonime@newsbomb.al



newsbomb.al

198,047 FOLLOWERS



newsbomb.al

42.2k FOLLOWERS



NewsbombAl

2,909 FOLLOWERS